
edicion i botuar / viti i parë / nr: 19

botues: ALBISLAM

kryeredaktor: Ramadan Ramadani

redaksia: Bekir Halimi, Talha Kurtishi, Alajdin Idriz

redaktor teknik: Azem Zaimi

www.albislam.com

albislam@albislam.com

str: 386 no: 11 lokal: 44

1000 Shkup

fax: +389 2 3290 408

Rreziku i misionarizmit në Turqi

Kohëve të fundit kanë filluar misionarët të paraqiten haptazi vullshëm me veprimin e tyre në sheshin shoqëror të Turqisë, pas vitesh aktiviteti fshehurazi nga frika e tyre prej përndjekjes së autoriteteve turke.

Misionarët filluan ta shfrytzojnë neglizhencën e autoriteteve zyrtare ndaj aktiviteteve të tyre, gjë e cila i stimuloi ata që të hapin edhe faqe në internet e cila thërret në krishterizëm, duke ia shtuar kësaj edhe themelimin e disa firmave në qytetet më të mëdhaja turke në brendi të Stambollit, Izmirit dhe Ankarasë në të cilat i presin thirrjet telefonike nën emrin: “alo...dua (lutje)”.

Dhe në kohën përderisa qeveria turke gjatë tërë vitit të kaluar ishte e zënë me çështjen e antarësimit të saj në BE, organizatat krishtere e intensifikuan aktivitetin e tyre në Turqi edhe më shumë, dhe arrijtën që për një kohë të shkurtër të depërtojnë në vende të shumta për ta përhapur krishterizmin dhe të hapin kisha.

Në të njejtën kohë, Këshilli Turk Nacional i Sigurimit ka tërhequr vërejtjen në raportin e tij, i cili u botua nën titullin: “aktivitetet misionare brenda Turqisë dhe botës”, se misionarët protestantë kanë për qëllim në Turqi krishterizimin e 10% të muslimanëve turk.

Kështu pra, gazeta turke “Zaman” ka botuar atë që e ka pohuar raporti në fjalë se misionarët protestantë me veprimet e tyre të krishterizimit janë të përqëndruar në mënyrë

të veçantë ndaj kurdëve dhe alevijve turkë duke e shfrytëzuar gjendjen e zbraztirës shpirtërore të këtyre dy sekteve.

Raporti më pas e ka bërë vështrimin e lëvizjeve të misionarëve në kuadër të një strategjisë që bazohet mbi parimin e që është se Islami bën dallimin në mes të sunnitëve dhe alevijve, dhe sipas raportit në fjalë, në Turqi gjenden 69 vende adhurimi joligjore të 47 grupeve protestante dhe 9 grupeve behajjë dhe 12 grupeve nga dëshmitarët e jehovait.

Siç pohon raporti poashtu, se brenda tre viteve të kaluara afër 5000 muslimanë turq janë konvertuar nga feja në krishterizëm, behaizëm, dëshmitarë të jehovait dhe jehudizëm duke treguar se 185 qytetarë turk ia kanë mësyer sekretariateve të ministrisë për punë të brendshme që ta ndërrojnë përkatësinë e tyre fetare nëpër dokumentet personale të identifikimit nga Islami në krishterizëm dhe një person në jahudizëm.

Gjithashtu, siç pohon raporti, se varfëria, injoranca dhe sëmudjet janë treshi kryesor nga i cili startojnë organizatat e krishterizimit në botë, dhe se nën moton e ndarjes së “ndihmave ushqimore” dhe atyre “mjekësore”, misionarët e vërshuan vendin e Marmara-së të cilin e kaploi tërmeti i fuqishëm në Gushtin e vitit 1999, që t’ia arrijnë të krishterizojnë afër 2500 qytetarë, shtëpiat e të cilëve u shkatërruan tërësisht sepse, siç vazhdon raporti, këta misionarë

bëjnë aktivitet nëpër vendet të cilat dëmtohen më së shumti nga katastrofat natyrore duke u fshehur nën petkun e "organizatave humanitare" që t'i bindin të dëmtuarit se do t'u japin pasuri të shumtë nëse e përqafojnë krishterizmin!

Disa qytetarë turq në Ankara i kanë detyruar disa misionarë që ti lëshojnë rrugët nëpër të cilat ishin duke shpërndarë inxhilë (Ungjell) gratis.

Ndërsa disa misionarë – shumica prej të cilëve të huaj- kanë dalë në rrugët e Ankarasë të fortifikuar me policë që t'ua shpërndajnë gratis inxhilin kalimtarëve, duke pohuar se ata kanë marë leje zyrtare për shpërndarje nga prefekti i Ankarasë.

Edhe pse kjo shpërndarje gratis hasi në interesin e disa kalimtarëve, por ajo u ndesh edhe në indinjatën e disa kalimtarëve të tjerë e në veçanti të atyre fetarë, të cilët ashpër e akuzuan tolerancën e autoriteteve zyrtare për shpërndarjen e inxhilit dhe e cilësuan atë si rrespektim i dobët ndaj Islamit dhe muslimanëve dhe u pyetën: "a thua vallë autoritetet do të kishin tolerancë në shpërndarjen e Kur'anit fisnik apo do ta ngrentë dhe do ta përplaste gjithë dunjanë dhe do ti arrestonte shpërndarësit e tij me akuzë për fundamentalizëm dhe fanatizëm islamik" !?

Kurse në anën e kundërt, disa organizata dhe shoqata turke filluan organizimin e seminareve për njoftim me dinin islam dhe ua tërhoqën vërejtjen qytetarëve nga synimet e atyre grupeve krishterizuese.

Një shoqatë prej tyre më pas bëri ndarjen e disa ekzemplarëve të Kur'anit në sheshin qëndror të kryeqytetit të Ankarasë dhe gjithashtu edhe drejtorja e feve bëri të ditur se do të bënte shpërndarjen e disa ekzemplarëve tjerë të Kur'anit fisnik nëpër burgje .

Ideja e krishterizimit të Turqisë muslimane, e cila konsiderohet vendi i dytë pas Palestinës së okupuar të cilat vizitohen nga të krishterët, fillon me të ashtuquajturit "të etur për të parë gjurmët e tyre monumentale të humbura", përderisa ata në realitet bëjnë armiqësi ndaj Islamit në forma të ndryshme që ta nxjerrin muslimanin nga dini dhe besimi i tij përmes organizatave krishterizuese që veprojnë nën mbulesën e "humanitetit", të cilat i sheh se si e shfrytëzojnë situatën e varfërisë dhe të urisë për realizimin e programit të tyre nëpër vendet islame më shumë të goditura që bijtë e atyre vendeve t'i largojnë nga Islami dhe detyrimin e tyre në përqaftimin e krishterizimit !

Nisur nga ky aspekt, fillojnë veprimet dhe aktivitetet e krishterizimit, të cilat në vitet e fundit në Turqi janë shtuar në mënyrë të rrezikshme, dhe të cilat aktualisht në mënyrë serioze kërcënojnë unitetin kombëtar turk, ku misionarët e krishterizimit e shfrytëzojnë vakumin e krijuar në ligjet turke që ta mbushin atë (Turqinë) me krishterizëm, duke luajtur në "dallimi në komb" për formimin e një bërthame të pakicës së re krishtere brenda tokave turke.

Si rezultat të kësaj, brenda tre viteve të fundit është bërë ndarja e afër 8 milionë ekzemplarëve të Biblës, ndërsa kishat dhe godinat e ndryshme të cilat ndërtohen në mënyrë të paligjëshme (dmth.ato të cilat meren me qira ose apartementet që blehen dhe shëndrohen në kisha të improvizuara për të tërëhjekur në to të krishterizuarit) i kanë vërshtuar qytetet turke e në veçanti Stambollin, qytetin më të madh turk.

Misionarët e fushatës së krishterizimit, i përdorin metodat e ndryshme të cilat përkrijnë me traditat dhe karakteret e secilit vend.

Kështu p.sh. ata bëjnë shpërndarjen e inxhilit (Biblës), librave krishterë dhe CD-ve në gjuhët kurde në juglindje të Anadolit që të përshtaten me gjuhët e kurdëve atje e që të mund t'i kuptojnë më mirë, ndërsa në anën tjetër ata bëjnë finansimin e televizioneve lokale me para të majme për reklamimin e filmave kurdë që thirrin në krishterizim!

Ndërkaq, sa u përket vendeve që u nënshtrohen tërmeteve të ndryshme, atje ata përpiqen ta shfrytzojnë nevojën dhe pikëllimin e të goditurve të cilët kanë mbetur pa strehim, që t'u paraqesin pasuri dhe udhëtime jashtë vendit, për të cilat kohëve të fundit statistikisht kanë bërë të ditur se misionarët e krishterizimit që janë nën çadrën e Vatikanit, kanë arritur që të shtynë afër 3000 qytetarë turk të goditur nga tërmeti i Sakarjas, ta përqafojnë krishterizimin!

Dhe së fundi, hallet e muslimanëve të Turqisë janë plagë që rjedhin qysh prej dhjetra vitesh, ngaqë kongreset e krishterizimit e kanë favorizuar atë (Turqinë) në mesin e atyre vendeve islamike në të cilat krishterizmi përpiqet që ta futë thikën e saj, dhe kështu pra organizatat krishtere në format e saja të ndryshme vazhdojnë të qarkullojnë në të, duke e futur helmin në mjaltë dhe ua jep muslimanëve që ta pinë, dhe i thirrin muslimanët në krishterizëm nën mbulesën e "ndihmës" dhe "humanitetit".

E nëse kësaj ia shtojmë edhe neglizhencën e sistemeve zyrtare ndaj këtij rreziku kërcënues dhe të kësaj sëmundje vdekjeprurëse e cila ngadalë ka filluar të depërtojë nën themelin e muslimanëve të dobët nga imani, atëherë ne shohim se Islami sot me të vërtetë ballafaqohet me fushatën më trishtuese në historinë e tij!!

**Marrë nga:islamtoday.
Përktheu: Emin Limani
Vienë/Austri
14.1.2005**

Zgjedhjet në Irak

“Zgjedhjet nuk bëjnë demokraci. Demokracitë bëjnë zgjedhje”¹ - Edwin Black, autori i *Banking on Baghdad: Inside Iraq's 7,000-Years History of War, Profit, and Conflict* (Brenda 7000 vjetëve histori të luftës, profitit dhe konfliktit në Irak)

Zgjedhjet irakiane të caktuara për 30 janar, do të mbahen nën masa të rrepta të sigurisë dhe në një klimë politike jashtëzakonisht të polarizuar dhe emocionale. Zgjedhjet do të vendosin përbërjen e Parlamentit të ri irakian, që do të jetë përgjegjëse për formimin e një Kushtetute dhe një Qeverie që do të udhëheqë shtetin nën patronazh të qindëra mijëra ushtarëve të huaj. Situata e thyeshme politike dhe sigurie sugjeron se zgjedhjet nuk do të kalojnë si duhet. Pjesa më e madhe e analistëve dakordohen se zgjedhjet janë thjeshtë edhe një ngjarje e zmadhuar në seritë e ngjarjeve të propaganduara nga autoritetet okupuese si indikatorë të progresit irakian.

Okupimi fillestar i Irakut në prill të vitit 2003, priteshte të lansojë një proces të çlirimit, mirëpo vetëm pas pak ditëve të rëzimit të regjimit të Sadamit, filloi të zhvillohet një ngjallet një kryengritje. Vrasja e djemve të Sadamit, Uday dhe Qusay Hussein dhe më vonë kapjes së vetë Sadamit, nga shumë vendim-marrës në Washington, u lavdëruan si simbole të progresit. Mirëpo kryengritja vazhdoi dhe kundërshtimi politik ndaj autoriteteve që erdhën pas Sadamit morri hov.²

Përderisa dorëzimi i pushtetit regjimit të

Allawit në fund të muajit qershor, vitin e kaluar, priteshte të minojë kundërshtimin irakian, rezistenca irakiane me sukses filloi të godasë simbolët e qeverisë së re, si dhe okupimin, më një pakënaqësi të madhe. Zgjedhjet do të zhvillohen nën kushte jashtëzakonisht të papërshtatshme, fillimisht për shkak të okupacionit të jashtëm dhe polarizimeve sektare dhe etnike. Mirëpo, kërcënimi më serioz për procesin politik të filluar nga Sh.B.A.-të vjen nga kryengritja tejet e sofistikuar me një bazë fuqie në rritje. Shefi i kundërzbulimit irakian, Shahawani, vlersëson se fuqia e përgjithshme e kryengritjes është rreth 40 mijë pjesarë paramilitarë, të mbështetur nga 160 mijë përkrahës aktiv, të gatshëm të ofrojnë kundërzbulim, strehim dhe përkrahje logjistike, madje kohë pas kohe edhe inkuadrim në luftime.³ Kjo është në kundërshtim me vlerësimet Sh.B.A.-ve të muajit tetor të vitit 2004, ku flitet për 5-20 mijë kryengritës aktiv ose gjysmë-aktiv.⁴

Pavarësisht nga pohimet e vazhdueshme të kryeministrit Iyad Allawi se anulimi i zgjedhjeve do të nënkuptojë shpërblim të kryengritësve, ai ishte detyruar të pranojë se votimi do të jetë i pamundur nën “xhepat” e dhunës së kryengritësve, ndërsa Lejtnant Gjenerali Thomas Metz, komandanti i forcave amerikane tokësore në Irak, ka pranuar më herët se kushtet në katër provincat irakiane mbeten të papërshtatshme për të zhvilluar zgjedhje.⁵ Këto pranime u bartën nga një deklaratë e përbashkët e lëshuar paradokohe nga

Armata Ansar al-Sunnah, Armata Al-Mujahidin, dhe grupet islamike irakiane, duke e sulmuar legjitimitetin e zgjedhjeve, duke iu kërcënuar secilit që merr pjesë, dhe duke i deklaruar si caqe, të gjitha qendrat e votimit. 6

Përveç kësaj, kërkesat e vazhdueshme nga udhëheqësit sunni madje edhe nga disa udhëheqës kurdë, duke përfshirë edhe kryetarin e përkohshëm Ghazi al-Yawer, për shtyerje të zgjedhjeve, i kanë bërë shumë vëzhgues skeptik rreth validitetit të zgjedhjeve dhe legjitimitetit të rezultateve të tyre.⁷

Përderisa sulmi brutal amerikan ndaj Fallujas dhe ndaj pjesëve të tjera në të ashtuquajturin Trekëndësh Sunni, kishte për qëllim të mposhtë kryengritësit dhe të sigurojë për votime qytetet, të cilat dihehin se janë baza të kryengritësve, ajo vetëm shërbeu për t'i armiqësuar edhe më tej sunnit irakianë, të cilët po bëhen gjithnjë e më të mllefosur për marginalizimin e përfaqësuesve të tyre politik nga ana e forcave okupuese.

Me prezencën e vazhdueshme të forcave okupuese dhe rritjen e revoltës, zgjedhjet irakiane sipas të gjitha gjasave kanë për qëllim të adresojnë problemet e irakianëve. Në vend të kësaj, ato do të jenë vetëm një përpjekje nga autoritetet okupatore për të ofruar një përshtypje të mirë për kredibilitetin dhe legjitimitetin e qeverisë pro-amerikane që do të bashkëpunonte me prezencën e zgjatur amerikane në Irak. Zgjedhjet e paradokohshme në Palestinë dhe Afganistan, të qendisura për të përkrahur zgjedhjet e kandidatëve pro-amerikanë, janë shembuj të mirë rreth asaj se çka është duke u planifikuar për Irakun nën kërkesë (qëllim) të autoriteteve okupuese.

Fillimi i dobët

Zgjedhjet e 30 janarit do të jenë zgjedhjet e para direkte shumëpartiake në Irak prej vitit 1953. Pas marrjes së pushtetit politik nga Abdul Karim Kassem në vitin 1958 nuk ka pasur zgjedhje legjislative – deri sa Partia Baa'th krijoi një Parlament të kontrolluar ngushtë në vitin 1980.⁸

Pjesmarrja e irakianëve në këto zgjedhje do të konfrontohet nga një numër i grupeve dhe koalicioneve të ndryshme që kandidohen për zyrë. Duke pasur parasysh se Iraku nuk ka traditë të paradokohshme demokratike, pjesa më e madhe e këtyre koalicioneve ose grupeve janë formuar brenda vitit të kaluar dhe nuk njihen mirë nga shoqëria irakiane. Secilit votues do t'i dorëzohet një fletvotim konfuz që ka një listë prej 111 opcioneve të ndryshme për të cilat ai mund të votojë. Në listë gjenden 79 parti, 9 koalicione dhe 27 individë. Çdo fletëvotim do të ketë simbolin e partisë, emrin dhe numrin. Secili votues do të duhet të kalojë nëpër listën e madhe të më shumë se 100 simboleve.⁹

Sistemi konfuz i votimit definitivisht do të favozirojë ato pak parti që kanë lista të gjata, që kryesohen nga figura të njohura, ose mbajnë emra të njohura. Logjikisht shumë votues do të zgjedhin Aleancën e Bashkuar të Shijeve të Irakut (të favorizuar nga Sistani), Aleancën Kurde, Unionin Sekular Kombëtar irakian të kryeministrit Allawi, dhe Partinë Irakiane të kryetarit al-Yawer. Si rezultat i kësaj shumë kandidatë të pavarur legjitim si duket nuk do të përfshihen. Vota shije poashtu do të jetë një pengesë, duke pasur para sysh se shumë grupe sunni kanë bojkotuar zgjedhjet dhe nuk kanë ndonjë kandidat ose parti të njohur që kandidohet.

Në fjalë, një anketë e departamentit të shtetit amerikan e zhvilluar paradokohe, zbuloi se vetëm 12 për qind e sunnive besojnë se zgjedhjet do të jenë fer dhe legjitime.¹⁰

Spektri i konfliktit qytetar

Përderisa invazioni anglo-amerikan i Irakut rrëzoi regjimin e Sadamit, ajo shkatërroi institucionet irakiane dhe i shpërbëri të gjitha resurset e legjitimitetit dhe sovranitetit të shtetit. Përkrahësit e rendit të ri post-Sadamian, kundërshtarët e tyre vazhdimisht i quajnë “terroristë”, “ish Baa’thistë”, ose “lojalistë të Sadamit”, përderisa kundërshtimi plotësohet me sugjerimin se çdo zyrtarë ose institucion që bashkëpunon (që lidhet) me rendin e ri është “shërbetor i autoriteteve okupuese”, “hipokrit”, ose “agjentë i alenacës Kryqëzato-Cioniste”. Rezultati i këtyre qëndrimeve ka qenë mungesa e ndonjë burimit të legjitimitetit të pranuar gjërë dhe shpërbërja e identitetit të unifikuar kombëtar irakian, me armiçësi të jashtëzakonshme etnike, sektare, fetare ose fisnore.

Arabët sunni irakian, që historikisht kanë qëne komunitetit udhëheqës politik, vazhdimisht janë marginalizuar nga autoritetet okupatore, të cilat i shihnin sunnit si bazë kryesore të përkrahjes së regjimit të Sadamit. Gjendja aktuale e çështjeve është shkaku kryesor për rezistencën e fuqishme ndaj okupacionit që gjendet në rajonet sunni, për shkak se shumë sunni besojnë se kryengritja është mjeti më i mirë i tyre për të ndikuar në jetën politike të Irakut.¹¹

Mirëpo, ky marginalizim poashtu sqaron se pse Asociacioni i Dijetarëve Muslimanë (Association of Muslim Scholars [AMS]),

autoriteti më i lartë fetar sunni, vendosi të bojkotojë zgjedhjet, dhe pse Partia Islamike Irakiane (IIP), edhe një lojtar i madh sunni, vendosi të bojkotojë zgjedhjet, edhe pse më herët dëshironte të merr pjesë në pjesën më të madhe të marrëveshjeve tranzicionale post-Sadamiane.

Brenda komunitetit shije, pavarësisht nga uniteti i dukshëm, edhe më tej ka ndarje të mëdha që nuk mund të rregullohen lehtë. Përveç përpjekjeve për udhëheqësi, shijet janë të ndarë rreth çështjeve që kanë të bëjnë me metodat e ballafaqimit me okupacionin anglo-amerikan dhe refuzimit të pranimit të ndikimit iranian në Irak. Me muaj të tërë, komuniteti shije në Irak ishte i ndarë në autoritetin e Ayatollahut Ali al-Sistani të lindur në Iran, i cili fton për rezistencë paqësore të okupacionit, dhe kundërshtimit militant të Moqtada al-Sadrit. Më 14 prill, 2003, një grup i Moqtada al-Sadrit rrethoi shtëpinë e Al-Sistanit në Najaf dhe i urdhëroi atij të lëshojë shtetin për shkak të lidhjeve të tij me Iranin dhe për shkak se “ai nuk është arab”.¹²

Përveç kësaj, në gusht të vitit 2004, kur ushtria amerikane lansoi ofensivën e saj kundër forcave të Al-Sadrit në Najaf, Al-Sistani lëshoi qytetin për herë të parë pas disa viteve, për shkak të, siç thuhej, udhëtimit në Londër për trajtim mjekësor. Ai u kthye tre javë më vonë, pasi ushtria e Al-Sadrit ishte dobësuar tejmasë nga ushtria amerikane.

Në kontrast me militantët e Moqtadas, Këshilli i Përgjithshëm për Revolucion Islammik në Irak, i lidhur me Sistanin dhe Partia e Daves Islame në Irak ishin duke shpërndarë mesazh të durimit, duke u premtuar pasuesve të tyre se nëpërmjet zgjedhjeve do të arrijnë një qeveri të

pashmangshme të dominuar nga shijet. Nga mesi i nëntorit të vitit 2004, për të bashkuar zërin e shijeve irakianë, u njoftua një koalicion i forcave politike që u përcaktua të merr pjesë në zgjedhjet nën udhëheqjen e Sistanit. Thuhej se koalicioni, do të përfshinte të gjitha lëvizjet e mëdha politike shije, duke përfshirë edhe atë të Al-Sadrit. Si pasojë, më 7 dhjator të vitit 2004, u njoftua formimi Aleancës së Bashkuar e Shijeve të Irakut.

Befas, përderisa lista e anëtarësisë së koalicionit ishte e dominuar nga kandidatë të IDP-së dhe SCIRI-së, në të nuk gjendeshte asnjë pausë i Al-Sadrit. 13 Sqarimi zyrtar ishte se lëvizja Sadriste nuk ishte e përfshirë për shkak se nuk ishte e regjistruar si parti politike në komisionin elektoral irakian. Megjithatë, vetë Moqtada al-Sadr iu kthye çështjes, kur deklaroi se lëvizja e tij nuk do të merr pjesë në zgjedhjet irakiane, nëse udhëheqës të tjerë fetar nuk do të garantonin largim të menjëhershëm të forcave të huaja pas zgjedhjeve.¹⁴

Rezultati i pozitës së Al-Sadrit ishte ndërprerja e negociatave ndërmjet lëvizjes Sadriste dhe grupit fetar të udhëhequr nga Sistani, që sugjeron se një segment i madh i popullatës së Irakut nuk do të përfaqësohet. Përshembull, miliona njerëz që jetojnë në qytetin Sadr – lagja e Bagdadit e dominuar nga shijet – nuk do të kenë të drejtë zëri.¹⁵

Kurdët irakianë, të cilët kanë qenë më mikpritës ndaj prezencës amerikane në Irak kanë qenë të zëshëm për shtyerje të zgjedhjeve, që sipas analistëve, është një përpjekje për të konsoliduar edhe më tej strukturën e tyre të qeverisjes autonome dhe forcave ushtarake.¹⁶

Kurdët druajnë se “autonomia” e tyre e autorizuar nga amerikanët mund të minohet

nëse ndonjë qeveri e ardhshme e shtetit themelon një kushtetutë që nuk përfshin të njëjtat garanca që gjenden në “ligjin administrativ të përkohshëm” të sponsoruar nga Sh.B.A.-të.¹⁷

Ndryshimet e shpejta

Iraku po ballafaqohet me një situatë të pakrahueshme ku forcat okupuese flasin për “sovrانيت” dhe “transfer të pushtetit” mirëpo në të njëjtën kohë mbajnë më shumë se 150 mijë ushtarë në tokën irakiane. Vendim-marrësit amerikanë nuk po e shofin se prezenca e vazhdueshme e trupave të huaja në Irak, është një shkak i madh për jostabilitetin në Irak.

Gati dy vjet pas rrëzimit të Sadamit, Iraku nuk është as afër lirisë, e as afër demokracisë. Forcat okupuese nuk kanë bërë shumë për të zbutur mllëfin e irakianëve, dhe kanë dështuar të krijojnë një klimë politike që do të jetë shkaktare për formimin e një qeverie stabile në Irak. Shumë irakianë janë të pashpresë në pjesmarrjen në një sistem politik të krijuar nga forcat okupuese. Irakianët e zakonshëm gjenden në një situatë ku duhet të zgjedhin ndërmjet kandidatëve të panjohur dhe në të njëjtën kohë nuk kanë të drejtë të votojnë në referendum për atë se a dëshirojnë fund të prezencës së trupave të huaja në shtetin e tyre.

Zhvillimi i zgjedhjeve nën kushte të tilla në Irak, kërcënon të keqësorë tensionet tashmë mjaft të këqija ndërmjet grupeve të ndryshme etnike dhe sektare në Irak, dhe të shtrojë terrenin për një konflikt qytetar. Kjo ka shtyrë ministrin e brendshëm irakian Falah Naqib të tërheq vëmendjen për mundësinë e “një lufte qytetare dhe ndarje të shtetit”.¹⁸

[1] Edwin Black, "The Projected winner in Iraq: Failure," Jihad Unspun January 15th, 2005

[2] Paul Rogers, "Towards the Third Year of war," Oxford Research Group – International Security Monthly Briefing December 2004

[3] Paul Rogers, "Towards the Third Year of war," Oxford Research Group – International Security Monthly Briefing December 2004

[4] Ibid.

[5] Tony Karon, "Iraq's Imperfect Elections," Time.com January 12th, 2004

[6] Anthony Cordesman, "Praying for Luck: The 'Real' Meaning of Iraq's Coming Elections," Center for Strategic and International Studies January 2nd, 2005

[7] Tony Karon, "Iraq's Imperfect Elections," Time.com January 12th, 2004

[8] Anthony Cordesman, "Praying for

Luck: The 'Real' Meaning of Iraq's Coming Elections," Center for Strategic and International Studies January 2nd, 2005

[9] Ibid.

[10] Tony Karon, "Iraq's Imperfect Elections," Time.com January 12th, 2005

[11] Gareth Stansfield, "The Reshaping of Sunni Politics in Iraq," Al-Jazeera (English) March 15th, 2004

[12] Zaid al-Ali, "Iraq's Dangerous Elections," Open Democracy December 23rd, 2004

[13] Ibid.

[14] Ibid.

[15] Ibid.

[16] Phyllis Bennis, "Iraqi Elections," Znet December 20th, 2004

[17] Ibid.

[18] "Iraq Risks Sliding Into Civil war: Interior Minister," IslamOnline.net January 18th, 2005

Kareem M. Kamel

Autori është analist egjiptian që jeton në Cairo, Egjipt.

30.1.2005

Xhamia e madhe në Banda Aceh dëshmon për ditën e vdekjes

Banda Aceh, ndodhet në veri të ishullit Sumatra, Indonezi. Ishte ora tetë e mëngjezit, të dielën më 26, dhjetor 2004 kur Aceh u godit nga një tragjedi e paparamenduar, e cila deri tani ka marrë jetët e një çerek milioni njerëz, 100.000 njerëz të pastrehë dhe mbi njëmilion të papunë.

Vala e fuqishme e dallgëve shokuese, dalgët e trishtimit, goditnin Aceh një pas

një dhe vetëm pas një çerek ore, të gjitha duke lëvizur me një shpejtësi 800 kilometra në orë kishin arritur 10 kilometra të ishullit, duke përmytur rreth 200 qytete të vogla dhe fshatra duke përfshirë këtu edhe Aceh, e gjitha në 190 kilometra të gjërë të brigjeve bregdetare bashkë me fshatrat e tyre dhe banorët e tyre. Ishte nje tsunami shumë i fuqishëm i shkatuar nga një tërmet oqeanik. Xhamia

e madhe në Banda Aceh 8 kilometra në thellësi nga bregdeti, qëndroi dëshmitare e prurjeve të shumta me makina të shkatërruara, kamionë, mobilje, drunjë, rrjeta peshkimi, barka, gjarpërinj, pemë dhe përmbi të gjitha mijëra vetë, të gjithë të zbarkuar në kopshtin e Xhamisë së Madhe, ndërsa përta i përket Xhamisë dhe minareve të saja të padëmtuara dhe të pa cënuara dallgët ishin ndalur tek hyrja kryesore, sikurse dallgët dëshironin të dëshmonin mbi çfarëdo që kishte ndodhur dhe për pse-në?

A do të ndaleshin dallgët aty dhe të lëshonin ngarkesën e tyre të trishtueshme?

Trupat janë duke u grumbulluar në kopshtin e Xhamisë së madhe në Banda Aceh, Indonezi. Një Aceh që dikur ishte i

bukur sot është plot mbeturina dhe i mbushur plot më të vdekur. I shkatërruar totalisht me të gjitha sistemet primitive, duke ndotur ujin e pishëm, duke përhapur sëmundje si malarja.

Pas një muaji tani, njerëzit janë ende duke kërkuar për një shenjë nga të dashurit e tyre (të afërmit) nën rrënojat e shtëpive dhe xhamitë ende kryejnë faljen e xhenazeve. Shumë njerëz këtu thonë: “që Aceh ka zemëruar Allahun dhe për këtë marrë këtë fatkeqësi të tillë”. Unë them që vetëm Allahu i madhëruar e di për këtë, dhe unë këtu dëshmoj se sa i fuqishëm është Allahu, subhanehu ve teala.

Ebu Ahmed

dëshmitar okular në Banda Aceh, i angazhuar në aktivitete humanitare

Përktheu: Ammar Ardit Kraja

4.2.2005

Aceh: Duke pritur, lutur dhe shpresuar

“E kërkojmë M. Nizar Zainun, gruan e tij Setiawati dhe vajzën e tyre Aisyah. Ju lutemi të luteni për sigurinë e tyre... nëse keni ndonjë informatë se ku gjenden ata, kontaktoni këto numra...”

Këto fjalë ishin shkruar në një copë letre që ishte e vendosur në një dërrasë njoftimi në zyren provinciale të Ministrisë së Çështjeve Shoqërore në Banda Aceh, që tani është shndërruar në një kamp refugjatësh pas termeteve dhe tsunamit nga të cilat humbën jetën rreth 170 mijë persona.

Një fotografi të çiftit të zhdukur dhe fëmijës së tyre e shoqëruar me një njoftim. Mirëpo, përderisa nuk ka shumë njoftime të tilla në këtë dërrasë të njoftimeve, me mijëra të tjera mund të gjenden çdokund kryeqytetit të Acehut. Njerëz të dëshpruar që dëshirojnë të mësojnë ndonjë gjë për fatin e të afërmeve të tyre të zhdukur, kanë vendosur njoftime të tilla në vende të ndryshme – nëpër mure të dyqaneve dhe zyreve dhe nëpër ato pak shtylla të mbetura pasi termeti dhe valët e fuqishme shkatërruan më shumë se 50 për qind të

infrastrukturës së provincës.

Ato njoftime flasin për shpresë se, në ndonjë mënyrë, dikush do të ketë mundësi t'ju tregojë atyre që i kanë shkruar ato njoftime, se të afërmit e tyre janë gjallë, ose madje edhe të vdekur – vetëm nëse trupat do të mund të gjenden midis mijëra e mijëra trupave të tjerë të shpërndarë përreth rrugëve – në mënyrë që ata më në fund t'i varrosin të vdekurit, frikën e tyre dhe t'i kenë pyetjet e përgjigjura.

Për disa ditë pas shkatërrimit më 26 dhjetor të vitit të kaluar, një numër i madh i banorëve të Banda Acehut shëtiteshin rrotull si të hutuar, duke u përpjekur të gjejnë të afërmit e tyre nga nën gërmadhat e ndërtesave dhe në baltën dhe mbeturinat e qytetit që njëherë ishte mjaft i bukur.

Me sy të skuqura nga e lotët e shumta, të mbijetuarit mblidhnin mbulesa, veshje ose çfarëdo gjëje që mund të gjenin për t'i mbuluar trupat e aq shumë të vdekurve, që mushkonjat dhe mizat e ndryshme të mbahen larg, pasi trupat tanimë kishin filluar të shpërbëhen. Në përpjekje për të njohur ndonjë fytyrë midis aq shumë trupave të vdekura, duke shpresuar kundër shpresës, ata shpesh janë dëshpëruar.

Pastaj ata do të vazhdonin ecjen – dhe do të mbulonin edhe një trup tjetër të pajetë.

Ka tregime të lumtura, siç është ajo e Teungku Raihan Iskandar, aktivist lokal i Partisë së Drejtësisë dhe Prosperitetit (PKS), i cili kishte humbur një nga fëmijët e tij disa ditë pas katastrofës. Ishin momente të tmerrshme, por ai vazhdoi të ndihmojë të lënduarit dhe të pastrehët, dhe madje edhe është përgjigjur,

nëpërmjet intervistave në radio-stacionin Alshinta të Jakartas, kërkesave të panumërta për informata rreth personave të zhdukur. Ai ka vazhduar të lutet për kthim të shëndoshë të fëmijës së tij, dhe më në fund është ribashkuar me të.

Ka tregime të pikëlluara. Sayed Muhammad, edhe një aktivist tjetër musliman, mban mend ta ketë përqaftuar gruan e tij tre muaj shtatëzëne, e cila e kishte sjellur në zyren provinciale në mbledhje me Asociacionin e Intelktualëve Muslimanë të Indonezisë. “Mos u brengos për termetin; çdo gjë do të jetë në rregull”, i ka thënë Sayed duke u përshëndetur me të.

Ajo kishte shkuar. Disa minuta më vonë, Sayed ka menduar se ka dëgjuar bubullimë – që në fjalë kishte qenë zëri i valëve gjigante duke u përplasur në Banda Aceh dhe në pjesën më të madhe të bregut perëndimor. Ai ishte në vend të sigurtë aty ku ishte, mirëpo gruaja dhe dy fëmijët e tij, nuk u gjetën më.

Si shumë njerëz të tjerë, ai është përpjekur të mposhtë dëshprimin dhe ka kaluar shumë kilometra në kërkim për familjen e tij të humbur. Ai ka vazhduar kërkimet në lagjen e dikurshme të tij, deri sa më në fund ka filluar të pranojë se familja e tij nuk ekzistonte më.

Ai iu është përmbajtur lotëve, duke i thënë vetes se nëse Allahu ia ka marrë atë që Ai ia kishte dhënë, ai do të luteshte që një ditë – në këtë botë dhe në Ahiret – të ribashkohet me gruan dhe fëmijët e tij. Pastaj ai filloi të angazhojë veten: hapi një shkollë të përkohshme për rreth 350 fëmijë në një kamp refugjatësh në rajonin e Darussalamit – afër xhamisë së Baitul Rahman – në Banda Aceh.

Ai ka filluar të qajë vetëm në një

moment: kur ka parë poshtërimin e madh që krijesat njerëzore mund të pësojnë – për shkak se trupat e tyre ngarkoheshin me paisje të rënda, gjuheshin në kamion dhe hidheshin në varreza massive.

“Pse njerëzit po trajtohen si kafshë? Të gjuhesh ashtu, të shkosh pa lutje mbi trup, pa çefin?”, pyeste ai duke iu dridhur zëri dhe duke i rrjedhur lotët nëpër faqe.

Raihan kishte fat që nuk kishte nevojë të vendosë njoftim. Syyed nuk e ndjeu të nevojshme ta bëjë atë. Mirëpo, me mijëra të tjerë mundoheshin të kapen për çfarëdo fije shprese që mund ta gjenin. Ata edhe më tej mundoheshin të komunikojnë disi me të afërmit e tyre. Ata prisnin, luteshin dhe shpresonin.

Sandti Soekanto
(gazetare e lirë në Aceh-Indonezi)
përktheu: xh.a.
4.2.2005

Drejt Shtëpisë së Lashtë

Shejhu dhe haxhiu Othman Dabu, rahimehull-llah, nga republika e Gambisë, vend që gjindet në perendimin më të largët të Afrikës, i kishte kaluar të tetëdhjetat. E vizitova këtë njeri në shtëpinë e tij modeste në një fshat të vogël afër kryeqytetit. Më tregoi për udhëtimin e tij të gjatë para pesëdhjet viteve drejt Shtëpisë së Lashtë. Këtë udhëtim e kishte bërë duke ecur në këmbë, ai dhe katër shokë të tij nga Bangoli e deri në Mekë, kështu duke kaluar mbarë kontinentin afrikan nga perendimi në lindje. Tërë këtë rrugë e kanë bërë në këmbë, vetëm disa herë të rralla kanë hypur mbi kafshë. Kështu kanë udhëtuar derisa arritën në detin e kuq, ku i kanë hypur anijes për në limanin e Xhides.

Udhëtim përplot çudira dhe situata të habitshme, të cilat po të ishin shënuar do të ishte libri më interesant i cili përshkruan ndonjë udhëtim. Ky udhëtim ka zgjatur më shumë se dy vjet. Disa herë janë ndalur në qytete për të fituar ndonjë dinar, për të pushuar dhe për të marrë me vete ndonjë nozull për udhëtimin e ardhshëm, e pastaj vazhdonin udhëtimin.

E pyeta: a nuk është haxhi obligim për muslimanët që kanë mundësi, kurse ju në atë kohë nuk keni patur mundësi?!

Tha: po, ashtu është, mirëpo një ditë e përmendëm tregimin e Ibrahimit, alejhisselam, kur shkoi me familjen e tij në një luginë ku s'kishte aspak të mbjellura, tek shtëpia e shenjtë e All-llahut, e njëri prej

nesh tha: ne tani jemi të fuqishëm dhe të shëndetshëm, çfarë arsytimi kemi para All-llahut nëse nuk udhëtojmë për në Shtëpinë e Shenjtë, sidomos kur e dimë se me kalimin e kohës vetëm do të dobësohemi edhe ma shumë, andaj pse të vonohemi?! Na stimuloi dhe nga nxiti për udhëtim, duke u ndihmuar me All-llahun, subhanehu ve teala.

Dolën pesë persona nga shtëpitë e tyre, me vete kishin vetëm ushqimin që u mjaftonte vetëm për një javë, për asnjë ditë më shumë, kurse shtytësi kryesor në këtë udhëtim ishte realizimi i urdhërit të All-llahut, subhanehu ve teala, për të kryer haxhin në Shtëpinë e Lashtë.

Gjatë rrugës përballuan vështirësi, ngushticë, brenga të cilat vetëm All-llahu i di.

Sa netë kanë rënë në gjumë të uritur, madje do të vdisnin për pak nga uria?!

Sa netë i kanë sulmuar bishat e egra dhe ua kanë prishur gjumin e lezetshëm?!

Sa netë i ka kapluar frika nga çdo anë, sepse hajnat e rrugës i sulmonin udhëtarët nga çdo anë?!

Shejh Othman thotë: më kafshoi një gjarpër në një natë gjatë udhëimit, pastaj më kapluan ethe dhe dhimbje të mëdha që më la zgjuar, në këto momente e nuhata aromën e vdekjes.

Shokët shkolin të punonin, kurse unë ndoja në hijen e drunjve derisa të vinin ata në mbrëmje, kurse shejtani më bënte vesvese: a nuk kishte qenë ma mirë të kishe qëndruar në vendin tënd?! Pse e angazhon

veten sa nuk mundesh?! A nuk ia ka bërë All-llahu obligim haxhin vetëm atij që ka mundësi?!

Mu rëndua vetja dhe përpak u dobësova. Kur erdhën shokët dhe më panë fytyrën, njëri prej tyre më pyeti për gjendjen time: e ktheva kokën dhe e fshiva lotin që më doli. E ai sikur e kuptoi gjendjen time e tha: ngritu mer abdest dhe falu, do të bëhet mirë, me lejen e All-llahut.

"Kërkoni ndihmë (në të gjitha çështjet) me durim dhe me namaz, vërtet, ajo është e madhe (vështirë), por jo edhe për ata që kanë frikë (Zotin). Të cilët janë të bindur se do ta takojnë Zotin e vet dhe se ata do t'i kthehen Atij". (El-Bekare: 45- 46).

Mu zgjërua gjoksi dhe ma largoi All-llahu mërzinë, elhamdulillah.

Mallëgjimi për të arritur në dy haremet e ndershme i përcjellte gjat tërë rrugës, ua pakësonte dhimbjet e udhëtimit dhe barën e rrugës dhe reziqet e saja.

Tre prej tyre vdiqën rrugës. I fundit vdiq në mes të detit. Është interesant se porosia e tij e fundit ishte: kur të arrini në Mesxhidul-Haram, tregoni All-llahut mallëgjimin tim për tu takuar me Te dhe kërkoni prej Tij që të më bashkojë mua dhe nënën time me Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, në xhennet.

Shejh Othmani thotë: kur vdiq edhe shoku ynë i tretë më erdhi një brengë dhe mërzi e madhe. Kjo ishte gjëja më e vështirë që kam përjetuar gjatë këtij udhëtimit, sepse ai ishte më durimtari dhe më i fuqishme prej nesh, fillova të frikohem mos po vdes para se të përjetoj begatinë e arritjes në Mesxhidul-Haram. Andaj i llogaritja ditët dhe orët sikurse isha duke qëndruar në gjëra më të nxehta se sa gacat.

Kur arritëm në Xhide më kaploi një smundje e madhe dhe u frikova se do të

vdes para se të arrijë në Mekën e Nderuar. E porosita shokun tim që nëse vdes të më qefinos me ihramin tim dhe të më afrojë sa ka mundësi më afër Mekës, ndoshta All-llahu ma shumfishon shpërblimin dhe më pranon në mesin e burrave të devotshëm.

Qëndruam në Xhide disa ditë e pastaj e vazhduam udhëtimin tonë për në Mekë. Frymëmarjet u shpejtuan kurse gëzimi e përshkoi fytyrën time, e mallëgjimi më dridhke dhe më shtrëngonte, derisa arritëm në Mesxhidul-Haram.

Shejhu heshti pak dhe filloi ti dridhet buza e tha: pasha All-llahun nuk kam përjetuar kënaqësi sikur kënaqësia që ma kaploi zemrën në momentin që pash Kaben e ndershme! Pastaj tha: kur e pash Qaben bëna sexhde falënderimi për All-llahun dhe fillova të qaj nga frikërespekti dhe nderimi i madh që kisha ndaj Qabes ashtu sikur qanë fëmija. Sa shtëpi e ndershme dhe sa vend madhështor!

Pastaj mu kujtuan shokët që nuk arritën të vijnë deri në Mesxhidul-Haram, dhe e falënderova All-llahun që ma dha këtë begati dhe dhunti, e pastaj u luta që ti regjistron hapat e tyre dhe mos ti privon nga shpërblimi dhe të na bashkoje me ta në kolltukën e vërtetësisë tek Mbreti i Gjithmundshëm.

Dola nga shtëpia e shejhut duke i përsëritur fjalët e All-llahut, subhanehu ve teala:

"Dhe ngutuni (me punë që meritoni) në falje mëkatesh nga Zoti juaj dhe për një xhennet, gjerësia e të cilit është si gjerësia e qiejve dhe e tokës, i përgatitur për të devotshmit". (Ali Imran: 133).

Vendoshmëri serioze drejt adhurimeve, vendoshmëri të cilën nuk e kaplon përtesa e as prolongimi, vendoshmëri para së cilës bijnë pengesat, vendoshmëri me ambicje të

vërteta dhe vullnet të lartë, i cili buron nga zemra që është ndërlidhur me dashurinë e All-llahut dhe zbatimin e urdhërit të Tij.

Dola duke përsëritur fjalën e All-llahut, subhanehu ve teala:

"Dhe thirr ndër njerëz për haxhin, se të vijnë ty këmbësorë e edhe kalorës me deve të rraskapitura që vijnë prej rrugëve të largëta". (El-Haxh: 27).

Pastaj fillova të mendoj mbi gjendjen e shumë muslimanëve të këtij shekulli, të cilët i

plotësojnë kushtet që ua obligojnë haxhin, mirëpo ata prolongojnë dhe përtojnë të shkojnë në haxh...! Ata le ta kujtojnë hadithin e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem:

"Kush dëshiron të shkojë në haxh le të nxitojë, sepse ndoshta sëmuret, ose i humb mjeti bartës ose i del ndonjë nevojë". (Hasen, Ahmedi).

Marrë nga Libri: "Në ndërtesën e thirrjes".

Ahmed Suvejan
Përkthet: Bekir Halimi
14.1.2005

Emri "Haman"?

Informacionet e dhëna në Kur'an rreth skriptave egjiptiane tregojnë për shumë dëshmi historike që kanë mbetur të pazbuluara deri paradokohe. Këto fakte poashtu na tregojnë se çdo fjalë në Kur'an është shpallur nga ana e një burimi të sigurt.

Haman është një person, emri i të cilit është përmendur në Kur'an së bashku me emrin e faraonit. Ai është shënuar në gjashtë vende të ndryshme në Kur'an, si një nga personat më të afërm të Faraonit.

Për çudi, emri i Hamanit nuk është përmendur asnjëherë në Tevrat, si pjesë e jetës së Musait, alejhis-selam.

Megjithatë, përmendja e Hamanit mund të gjendet në kaptinat e fundit të Dhjatës së vjetër, si ndihmës i mbretit Babilonas, i cili kishte kryer shumë vrazhdësi ndaj izraelitëve rreth 1.100 vjet pas Musait, alejhis-selam.

Disa jo-muslimanë, të cilët thonë se (hasha!) i Dërguari Muhamedi, alejhis-selam,

e ka shkruar Kur'anin duke e kopjuar atë nga Tevrat dhe Bibla, poashtu thonë se gjatë procesit, ai ka transferuar disa nga temat e ngjashme në këto libra në Kur'an në mënyrë jo-korrekte. Absurditeti i këtyre pohimeve ishte demonstruar edhe një herë pasi alfabeti hieroglifik egjiptian është deshifruar, para rreth 200 vjetëve, dhe emrin "Haman" të zbuluar në skriptat e lashta. Para këtyre zbulimeve, shkrimet e Egjiptit të lashtë nuk kanë mundur të kuptohen.

Gjuha e Egjiptit të lashtë ishin hieroglifet, e cila kishte mbijetuar nëpër kohëra. Mirëpo, me shpërndarjen e krishterimit dhe ndikimeve tjera kulturore në shekujt 2 dhe 3 pas epokës së re, Egjipti la besimet e lashta si dhe shkrimin hieroglifik.

Shembulli i fundit i njohur për përdorimin e shkrimit hieroglifik është një mbishkrim nga viti 394 p.e.s. Pastaj ajo gjuhë është harruar, duke mos lënë asnjë (person) që

din ta lexojë dhe ta kuptojë atë. Dhe e njëjta situatë vazhdoi deri para rreth 200 vjetëve.

Misteri i hieroglifëve të lashta egjiptiane ishte zgjidhur në vitin 1799, me zbulimin e një pllake të gurit të quajtur “Rosetta Sone”, që daton që nga viti 196 para epokës së re.

Rëndësia e këtij mbishkrimi është se ajo ishte shkruar në tri forma të ndryshme të të shkruarit: hieroglifëve, demotike (formë më e thjeshtësuar e shkrimit të lashtë hieratik egjiptian) dhe greke. Me ndihmën e skriptave greke u dekoduan shkrimet antike egjiptiane.

Përkthimi i mbishkrimit është kompletuar nga një francez me emrin Jean-Francoise Champollion. Prej atëhetë, dolën në dritë gjuha e harruar dhe ngjarjet që lidhen me të. Në këtë mënyrë, një pjesë e madhe e diturisë për civilizimin, religjionin dhe jetën shoqërore të Egjiptit të lashtë u bë e kapshme dhe në dispozicion.

Nëpërmjet dekodimit të hieroglifëve, është zbuluar një pjesë e rëndësishme e diturisë: emri “Haman” në të vërtetë ishte përmendur në shkrimet egjiptiane. Ky emër përmendet në një përmendore në muzeun “Hof” në Vjenë. (Walter Wreszinski, Aegyptische Inschriften aus dem K.K. Hof Museum in Wien, 1906. J.C. Hinrichs' sche Buchhandlung)

Në fjalorin “People in the New Kingdom” (Njerëzit në mbretërinë e re), që është përgatitur në bazë të një koleksioni të tërë të shkrimeve (egjiptiane), Hamani thuhet se

ka qenë “shefi i punëtorëve të përpunimit të gurit” (Hermann Ranke, Die Ägyptischen Personennamen, Verzeichnis der Namen, Verlag Von J.J.Autustin in Glückstadt, Band I, 1935, Band II, 1952)

Rezultati ka shpallur një të vërtetë shumë të rëndësishme. Ndryshe nga pohimet e kundërshtarëve të Kur’anit, Hamani ka qenë një person që ka jetuar në Egjipt në kohën e Musait, alejhis-selam, i cili ka qenë i afërt me faraonin dhe ka qenë i involvuar në punë ndërtimore, njëjtë siç është bërë e ditur në Kur’an.

Përveç kësaj, ajeti në Kur’an që përshkruan ngjarjen ku Faraoni ka kërkuar nga Hamani të ndërtojë një kullë, është në një përputhshmëri të përsosur me zbulimet arkeologjike: “E faraoni u tha: “O ju pari, unë nuk njoh nodnjë zot tjetër për ju pos meje, andaj ti o Haman, m’i pjek (tullat) nga dheu e më ndërto një kullë të lartë ndoshta do të arrijë ta shoh zotin e Musait, sepse unë mendoj se vërtetë ai është gënjeshtar”. (El Kasas: 38)

Si përfundim, ekzistimi i emrit të Hamanit në shkrimet e lashta egjiptiane jo vetëm që i hedh poshtë pohimet e fabrikuara të kundërshtuesve të Kur’anit si të kota, por poashtu konfirmon edhe njëherë faktin se Kur’ani vjen nga Allahu, xhel-le shanuhu.

Në një mënyrë të mrekullueshme, Kur’ani na jep të dhëna historike që nuk kanë mundur të posedohen në kohën e Muhamedit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem.

Haryn Yahya
përktheu: xh.a.
28.1.2005

Nuk është ar çdo gjë që shkëlqen

Në kundërshtim me besimin e disa njerëzve, arritja e një shkalle më të lartë të aspektit shpirtëror nuk duhet patjetër të jetë nëpërmjet mbledhjes së pasurisë materiale. Është një bekim që një person të jetë i pasur. Por është me rëndësi të theksohet se ky bekim dyfishohet kur pasuria materiale përdoret në një mënyrë që e bën personin të rritet në aspektin shpirtëror. Ja çka na mëson Islami;

Allahu i Plotfuqishëm thotë: “Dhe me atë që të ka dhënë All-llahu, kërko (ta fitosh) botën tjetër, e mos le mangu atë që të takon nga kjo botë, dhe bën mirë ashtu siç të ka bërë All-llahu ty, e mos bën të këqija në tokë, se All-llahu nuk i do çrregulluesit.” (El-Kasas: 77)

Sipas këtij ajeti, njeriu nëpërmjet bekimit të pasurisë e cila i është dhuruar, arrin bekimin e pakufishëm në Botën tjetër, me karakteristikat unike të mrrekullisë, pakufisë, pastërtisë dhe përsosshmërisë. Shumë njerëz nuk arrijnë ta shofin këtë për shkak se ata nuk e kuptojnë qëllimin e vërtetë të pasurisë.

Nëse njeriu, i cili është i mbuluar me pasuri, e pyet veten vetëm një pyetje – përse e gjithë kjo pasuri? – ndoshta nëpërmjet diturisë së tij nga lindja, rreth të drejtës dhe të shtrembëtës (nëse ia ka arritur të dëgjojë vetëdijen e tij) ai do të kuptonte se një pasuri aq e madhe është disejnuar me qëllim nga Allahu, subhanehu ve te'ala, që njeriu t'i drejtohet varfërisë së madhe që i ka mbuluar të tjerët. Kjo është kuptimi i pasurisë në Islam.

Njerëzimi nënçmon domethënien e bekimeve. Nëse bëjmë një vështrim gjithëpërfshirës të bekimeve, asnjëherë nuk do të pyesim për ato, sepse përfitimi material ka pasojat negative dhe pozitive.

Para se të bëjmë dua (lutje) për pasurinë duhet të mendojmë seriozisht për shumë njerëz besimtarë që e njoftin Allahun, subhanehu ve te'ala dhe që nuk kërkojnë gjëra materiale. Ata nuk kërkojnë pasuri për shkak se fokusi i tyre kryesor në jetë është lidhja me Allahun, subhanehu ve te'ala dhe druajnë se pasuria mund t'i largojë ata nga Allahu, subhanehu ve te'ala, dhe kështu ata pranojnë çka do që kanë dhe janë mirënjohës.

Masat e popujve zakonisht janë të mahnitur nga mënyra e jetës të të pasurve dhe si ata kanë aeroplanët e tyre dhe aq shumë gjëra. Njerëzit shpesh janë xhelozë, duke dëshiruar të ishin ata në vend të tyre dhe t'i kishin gjithë ato gjëra. Mirëpo, para se të kërkojmë bekim, ne duhet t'i lutemi Allahut, subhanehu ve te'ala që të na udhëzojë se si do të jetonim nëse do të kishim atë bekim. Pak njerëz mund të jenë të pasur dhe të drejtë – shumica e njerëzve në Xhennet janë të varfër për shkak se shumë vetë-disiplinë është e nevojshme për të përdorë parusinë në shërbim të njerëzve të tjerë, në shërbim të Allahut, subhanehu ve te'ala.

Pasuria mund të jetë shpatë me dy teha. Një person mund të jetë i pasur dhe pastaj, gjatë keqpërdorimit asaj pasurie, pa qëllim mund t'ia blejë vetes një biletë eksprese për në Xhehenem.

Ka shumë mësim të mira që duhet të mësohen nga tregimi i Qarunit (Karun) (Sureja El-Kasas: 76-82). Njerëzit në atë kohë mahniteshin me mënyrën elegante të jetesës së tij. Ata ishin xhelozë ndaj tij dhe e konsideronin të jetë jashtëzakonisht i bekuar. Ata nuk e kuptonin lidhjen e tij me Allahun, subhanehu ve te'ala – se a ishte e mirë

apo e keqe. Ata e vështronin atë dhe gjendjen e tij nga një aspekt i përciptë. Ata e konsideronin Qarunin një njeri fatbardhë.

Allahu, subhanehu ve te'ala në Kur'an na tregon për natyrën e pasurisë së Qarunit. Vetëm çelësat (e dyerve / pasurisë së tij) kanë qenë aq shumë sa një grup i njerëzve të fuqishëm mezi i kanë bartur ato. Allahu, subhanehu ve te'ala na sqaron se edhe pse pasuria e Qarunit ka qenë jashtëzakonisht e madhe, ajo nuk kishte ndonjë rëndësi për Allahun, subhanehu ve te'ala. Allahu, subhanehu ve te'ala e shikon relacionin e individit me Të. Qaruni dhe pasuria e tij u zhdukën. Pasuria nuk i solli asgjë atij.

Të njëjtit njerëz që mahniteshin me të, një ditë më parë janë penduar dhe kanë qenë të lumtur që lutjet e tyre nuk ishin realizuar, për shkak se Qaruni dhe pasuria e tij ishin zhdukur. Nuk duhet të ndikohemi nga njerëzit që kanë pasuri, fëmijë dhe dituri për shkak se nëse i kishim këto gjëra dhe nuk kishim mundur t'ua japim vëmendjen e duhur, ata do të mbanin pasoja të këqija për ne. Ku jepet shumë, kërkohet shumë. Rreziku më i madh është se pasuria jonë mund të na largojë nga Allahu, subhanehu ve te'ala...

Jeta e besimtarit është mjaft e jashtëzakonshme. Besimtari nuk kërkon pasuri me qëllim që të bëhet i pasur, sepse ai e din se pasuria mund të ndikojë në lidhjet e tij me Allahun, subhanehu ve te'ala. Në këtë mënyrë, ai preferon të harrojë pasurinë.

Pa marrjen e ndonjë pozite të caktuar në punë, një person mund të ketë kohë të falet në kohë, të lexojë Kur'anin çdo ditë dhe të bëjë më shumë punë të mira;

mirëpo nëse një bëhet menaxhues, ai ka një post më të lartë dhe koha i ngushtohet. Personi që është menaxhues sot, nuk është personi i njëjtë që ishte dje. Ndoshta ai ka më pak kohë për t'u falur, më pak kohë për të kaluar me familjen e tij dhe padyshim më pak kohe për t'i konsideruar mrrekullitë e jetës.

Duhet ta analizojmë veten dhe të shohim nëse jemi mbuluar nga bota materiale. Këto janë pasojat negative që një musliman duhet t'i ketë parasysh kur të bëjë duanë (lutjen). Çka do që kemi, e hap derën sprovave.

Ndonjëherë i shohim njerëzit e Gjirit (Persik) se sa të pasur janë. Disa prej tyre harxhojnë shumë para për fëmijët e tyre, të cilët bëhen të lazdruar dhe të papërgjegjshëm. Disa prej tyre nuk mund të flejnë të qetë. Disa nuk janë të shëndoshë. Shumica prej tyre qajnë në brendi të tyre, mirëpo për këtë askush nuk di gjë përveç Allahut, subhanehu ve te'ala. Ne i shofim vetëm gjërat që ata i bëjnë që të jenë të lumtur.

Si besimtarë ne duhet të shofim atë që kemi si bekim nga Allahu, subhanehu ve te'ala. Kjo varet se si i perceptojmë bekimet e Allahut, subhanehu ve te'ala – falenderimin tonë për bekimet që i kemi.

Kur e shohim veten në dritë, kur jemi të njohur, nuk mendojmë të kthehemi prapa tek të dikurshmit ne, por garojmë përpara drejt vdekjes sonë. Kjo është dobësi në natyrën e njeriut; kërkimi i gjërave materiale në jetë si një qëllim në vete, në vend që ato të jenë mjete drejt fundit.

“Dhe me atë që të ka dhënë All-llahu, kërko (ta fitosh) botën tjetër” (El-Kasas: 77)

Në jetën e kësaj bote, ndarja e një gjëje me tjetrin, poashtu luan një rol të

rëndësishëm në përforcimin e paqes dhe solidaritetit në shoqëri, pasi që kjo shtron rrugën që të varfërit të përfitojnë nga të pasurit, duke e shuar zjarrin e xhelozisë që ndoshta ka ngrënë zemrën e tij dhe ofrimit të një ndjenje të sigurisë të të pasurit. Ky është Islami.

Jeta nuk është gjithë ajo që e ke në xhep. Jeta është sa je i kënaqur me atë që e ke. Si student mund të jesh i varfër, mirëpo ke kohë të falesh në kohë; më

vonë mund të gjesh punë të mirë dhe të kesh para, por të kesh edhe më pak kohë. Në raste të tilla, një pjesë e jote do të ndjehet e lumtur, ndërsa pjesa tjetër do të ndjejë dhimbje.

Jeta nuk është si e shofim. Njerëzimi është çdoherë në ngutje dhe nuk mund t'i shfajtojë pasojat e të pasurit gjëra materiale. Çdo gjë në jetë që nuk ka perspektivë të pakufishme zhduket.

Kamal Badr
Kryeredaktor i Islamonline.net
Përktheu: xh.a.
4.2.2005

Jeni ndihmëtarët e Zotit

All-llahu, subhanehu ve teala, në Kur'an thotë: "O ju që besuat, bëhuni ndihmëtarë të All-llahut, si Isai, biri i Merjemes, havarijijunëve (besimtarëve të vet të sinqertë) u pat thënë: "Kush është ndihmëtar imi për në rrugën e All-llahut?" Havarijijunët i thanë: "Ne jemi ndihmëtarë të rrugës së All-llahut!". (Es-Saff: 14).

Ku është ndihmesa që ia kanë dhënë ata Isaut, alejhisselam, kurse Isau, alejhisselam, me askend nuk ka hyrë në luftë?

Kjo ndihmesë ka qenë ndihmesë imanore:

"... E një grup prej beni israilëve besoi, e një grup refuzoi, e Ne ata që besuan i përkrahëm kundër armikut të tyre dhe ashtu u bënë ngadhënjyes". (Es-Saff: 14).

Ky rast është një mësim fisnik për rininë islame.

Le të mëson secili që dëshiron ta ndihmojë fenë e All-llahu se ai duhet ta realizojë adhurimin e sinqertë ndaj All-llahut, ta angazhon zemrën më respektive ndaj All-llahut.

Me këto pak fjalë do të tentojnë të bashketojmë me zemrat tona me ata ensarë, qoftë All-llahu i kënaqur me ata dhe muhaxhirët, të cilët kanë flijuar çdo gjë të shtrenjtë për ta ndihmuar fenë e All-llahut.

Vëllau im i dashur!

Udhëzimi është dhunti hyjnore, të cilën e fut All-llahu në zemrën e Atij që dëshiron.

Kurejshitët që jetuan me Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, që e njohën vërtetësinë dhe besnikërinë e tij, ata nuk

besuan në shpalljen e tij, madje organizuan komplete për ta vrarë ate... kurse ensarët që e panë Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dëgjuan prej tij Kur'anin për herë të parë, ata hynë me zemër dhe gjymtyrë në islam dhe dhanë shembullin e rrallë për flijim, sakrificë, vetmohim dhe kontribut.

Shenjat e ndihmesës të Ensarët janë të shumta, kurse në do të mjaftohemi duke i përmendur vetëm disa prej tyre: dashurinë, bindjen, kontributin dhe flijimin.

1- Dashuria.

Sa i përket dashurisë, mjafton se ata ishin të gatshëm të flijojnë veten, pasurinë dhe fëmijët e tyre për Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Në këtë drejtim shërben edhe ky rast:

Transmeton Hakimi me sened të vërtetë se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, në betejën e Uhudit e dërgoi Zejd ibën Thabitin për ta kërkuar Sad ibën Rebiun, radijall-llahu anhumā. E gjeti në frymëmarjet e fundit. Ky i tha: Sad, Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, pyet: si je? Tha: dërgoi selam Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe thuaj: jam duke nuhatur aromën e xhennetit, kurse popullit tim ensarit thuaju: nuk keni arsye para All-llahut nëse dëmtohen Pejgamberi i juaj, kurse në mesin tuaj ka sy të hapur".

A ka dashuri më të madhe se kjo?!

Vëllau im i nderuar riktheju edhe një herë tregimeve të betejës së Uhudit që të shohish se si ata e kanë mbrojtur Pejgamberin, sal-

lall-llahu alejhi ve sel-lem, deri në vdekje.

2- Bindja.

Bindja ata i shoqëronte që nga çasti i parë i hyrjes së tyre në fenë e madhe, ata ishin të bindur se All-llahu do ta ndihmon Pejgamberin e Tij, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

Këtë e gjen të qartë në rastin e besatimit të dytë në Akaba, kur kërkoi Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, prej tyre që të ofrojnë çdo gjë për ta ndihmuar fenë e All-llahut, kurse çmimi i kësaj ishte xhenneti. Ata ia dhanë besën edhe pse nuk e kishin parë xhennetin, mirëpo ishin të bindur në vërtetësinë e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ishin të bindur se All-llahu do tu jep shpërblime në dy botërat, për shkak të besimit, sinqeritetit dhe ndihmesës që ia bëjnë fesë së All-llahut.

3- Kontribut.

Në këtë drejtim mund të flasim sa të duash. Çka mund të themi pas fjalës së All-llahut, azze ve xhel-le:

"Edhe ata që përgatitën vendin (Medinen) dhe besimin para tyre, i duan ata që shpërnguleshin tek ata dhe nuk ndiejnë në gjoksat e tyre ndonjë nevojë (për zili a tjetër) nga ajo që u jepej atyre (muhaxhirëve), madje edhe sikur të kishin vetë nevojë për te, ata u jepnin përparësi atyre para vetvetes. Kush është i ruajtur prej lakmisë së vet, të tillët janë të shpëtuar". (El-Hashr: 9).

Sigurisht se e dini rastin që ndodhi mes Abdur-Rahman ibën Afit, i cili ishte muhaxhir dhe Sad ibën Rebiut, i cili ishte ensarët, radijall-llahu anhum, kur i vëllezëroi

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe kur ia ofroi Sadi gjysmën e pasurisë dhe njëren prej dy grave të tija, Abdur-Rahman ibën afit, ia ktheu: All-llahu të dhashtë bereqet në pasurinë dhe familjen tënde, unë nuk kam nevojë për këto gjëra..

Ky nuk ka qenë qëndrim individual i Sadit, por ka qenë qëndrim kolektiv i mbarë ensarëve kundrejt vëllezërve të tyre muhaxhir.

4- Flijimi.

Ne e dimë shumë mirë se sa kanë flijuar ensarët për ta ndihmuar këtë fe.

Mjafton ta përmendim rastin e Sad ibën Muadhrit në betejën e Bedrit, kur Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, tha: o ju njerëz, më jepni mendimet e juaja. E kuptoi qëllimin e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, Sadi e tha: si duket kërkon mendimin tonë? Tha: po. Atëherë Sadi, radijall-llahu anhu, tha: "Kemi besuar në ty dhe të kemi pranuar, ...deri në fund të fjalimit të tij historik.

Si rezultat i drejtë i kësaj ishte se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e bëri dashurinë ndaj Ensarëve shenjë e besimit, duke thënë:

"Shenjë e besimit është dashuria ndaj Ensarëve, kurse shenjë e dytë është urrejtja e Ensarëve". (Buhariu dhe Muslimi).

ensarët, ate e do All-llahu dhe ai që i urren Ensarët, ate e urren All-llahu". ("Sahihul-Xhami", nr. 5953).

Vallë, a do të gjemi në mesin e juaj ndihmëtar të All-llahut...?!

Mbane mend çdo herë këtë ajet: "... bëshuni ndihmëtarë të All-llahut...".

Shkroi: Mahmud El-Misri

Përshtati: Bekir Halimi

14.1.2005

Pozitiviteti dhe mjeshtria e jetës

Ska dyshim se në situatat e vështira ekonomike dhe politike në të cilat jetojnë muslimanët ka nevojë për të inicuar pozitivitetin në mesin e muslimanëve. Nuk ka rrugëdalje tjetër nga kjo gjendje në të cilën gjinden muslimanët përpos se duke përhapur shpirtin pozitiv në mesin e muslimanëve, përndryshe ummetin islam e kaplon dembelia dhe përtesë, cilësia të cilat nuk përkojnë ummetit islam.

Është e vërtetë se pozitiviteti sjell mirësi edhe për individin edhe për shoqërinë muslimane.

Pozitiviteti mes individit dhe shoqërisë

Pozitiviteti ka dy aspekte:

a) Pozitiviteti i individit kundrejt vetes, që domethënë zhvillim dhe përmirësim të vetvetes.

b) Bashkveprimi i individit me individët tjerë dhe me çështjet e shoqërisë së tij dhe pjesmarrja e tij në krijimin e ndodhive.

Në të dy këto gjëra ka mirësi.

Ska dyshim se shpirti iniciues është udhëheqës dhe udhërrëfyes drejt suksesit dhe epërsisë.

Jeta është përplot mundësi për mirësi dhe sferat e përparimit janë të shumta, mirëpo të pakët janë ata që dëshirojnë të jenë të parët.

Ne dallojmë përballë këtyre mundësive, dikush prej nesh është aq dembel saqë nuk e lëvizin këto mundësi.

Shumë njerëz kanë ide dhe kanë ambient të përshtatshëm për rezultate dhe përparim, mirëpo pengesat psikologjike e pengojnë në këtë drejtim dhe e largojnë nga nisja dhe nxitimi, kurse këtë e fiton ai që është trim dhe

aktiv.

Iniciativa është titulli i suksesit, rruga e përparimit, arma e shfrytëzimit të mundësive situatave.

Individi iniciues dhe pozitiv është ai që ka të arritura dhe fitore.

Më herët kanë thënë: "I fiton kënaqësit ai që rezikon".

E njehta vlen edhe për atë shoqëri që i posedon këto cilësi, kjo shoqëri është e gjallë dhe vazhdimisht e zhvillon realitetin e tij drejt më të mirës.

Pozitiviteti është kërkesë islame

Kur'ani Fisnik është përplot me ajete që udhëzojnë drejt kapjes dhe stolisjes me këtë sjellje dhe me këtë vlerë. Kur'ani Fisnik ka folur për këtë cilësi për shkak të rëndësisë që ka në jetën e individit dhe shoqërisë.

Në disa raste Kur'ani flet për këtë cilësi me shprehjen "nxitim":

"...nxitojnë për punë të dobishme, edhe ata janë prej të mirëve". (Ali Imran: 114).

"... Ata nxitonin për punë të mira, ...". (El-Enbija: 90).

"Dhe ngutuni (me punë që meritoni) në falje mëkatesh nga Zoti juaj dhe për një xhennet, gjerësia e të cilit është si gjerësia e qiejve dhe e tokës, i përgatitur për të devotshmit".

Ajo që është për tu vërejtur në këto ajete është fakti se këto ajete u janë drejtuar të gjithëve e jo vetëm një individit, sepse kërkohet që kjo të jetë cilësi për mbarë shoqërinë, në ecurinë dhe qëndrimet e saja dhe të jetë cilësi dominante e shoqërive që synojnë ngritjen dhe ngjalljen.

Është fakt se nuk janë të barabartë ata që marin inicijativa me ata që nuk e bëjnë këtë gjë.

Të jesh i pari dhe i hershmi është nderë të cilin nuk e fiton secili.

Kur'ani Fisnik flet për ata njerëz që i kanë bërë disa vepra, të cilat nuk i ka bërë askush para tyre dhe ka treguar se shpërblimi i tyre është i dyfishtë dhe nuk janë barazuar me ata që më vonë i kanë bërë mu ato vepra. Ata kanë mbetur të parët dhe të hershmit, andaj edhe e meritojnë çdo respekt dhe nder.

Kur'ani e vlerëson shumë secilin që ka qenë i pari në vepra të mira dhe në shërbim të muslimanëve duke thënë:

"All-llahu është i kënaqur me të hershmit e parë prej muhaxhirëve (migruesve) dhe prej ensarëve (vendasve-ndihmëtarë) ...". (Et-Teube: 100).

Ky ajet nuk kufizohet vetëm në vlerën e atyreve që të parët e kanë bërë hixhretin, por vlen për secilin që ka qenë i pari në ndonjë vepër të mirë.

Shumë ajete stimulojnë për të qenë të parë dhe për të nxituar në vepra të mira, prej tyre është edhe ky ajet:

"...Nuk janë të barabartë prej jush ata që dhanë nga pasuria e tyre dhe luftuan para çlirimit, sepse të tillët kanë vlerë më të madhe nga ata që dhanë dhe luftuan pas. Por të gjithëve All-llahu u premtoi të mirat; All-llahu di çka punoni". (El-Hadid: 10).

"...Thuaj: "Unë jam i urdhëruar të jem i pari që bindem dhe (urdhërohem): të mos bëhem kurrsesi nga idhujtarët...". (El-enam: 15).

Në këtë drejtim e kemi shembull dhe yrnec Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Ai që mëson jetëpërshkrimin e tij

prej para pejgamberllëkut e deri në vdekje, do të vëren se jeta e tij ishte përplot me qëndrime që tregojnë pozitivitetin dhe bashkëveprimin me ndodhitë që ndodhnin përreth tij.

Prej shembujve në këtë drejtim është rasti kur i pa njerëzit duke u kacafytur se kush do ta vëndojë gurin e zi në vendin e vet në Qabe, e tha mendimin e tij dhe kontriboj për ta larguar këtë zënkë. E nuk tha: çka më lidh mua me këtë vepër?!

Kurse pas pejgamberisë, edhe pse armiqësia e Ebu Xhehlit ndaj Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ishte e qartë, kur i erdhi një bediun që ti ankohe se Ebu Xhehli ja ka marrë pasurinë dhe nuk dëshiron tia kthen, shkoi te ai Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, pa mëdyshje dhe pa frikë dhe kërkoi nga Ebu Xhehli që tia kthen hakun këtij njeriu. Ebu Xhehli ia ktheu pasurinë këtij njeriu dhe kur e pyetën pse ia ktheu pasurinë, ai u përgjigj: "mu duk se një luan dëshiron të më gëlltitë kur hyri Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem".

Edhe hadithet e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, na nxisin në këtë vlerë të madhe.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Nëse ndodh Kijameti dhe ndokush në dorën e tij ka ndonjë filiz, le ta mbjell". (Buhariu).

Qëfshin salavatet dhe selamet për ty, o i Dërguar i All-llahut! A ka pozitivitet më të madh se ky?!

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë:

"Shembulli i atij që i respekton kufinjtë e All-llahu dhe atij që ka rënë në mëkate është sikur shembulli i disa njerëzve që kanë hypur në një anije. Disa kanë hipur

lartë dhe disa janë poshtë. Ata që ishin poshtë kur kishin nevojë për ujë kalonin përreth atyreve që ishin lartë, e thanë: pse nuk e shpojme anijen dhe mos ti pengojmë ata që janë lartë! Nëse do ti lenin të bëjnë çka synuan do të shkatërroheshin edhe ata edhe të gjithë, e nëse do ti ndalonin nga kjo vepër, do të shpëtonin të gjithë". (Buhariu).

Rruga deri te pozitiviteti

Ka shumë komponente që ndihmojnë në kultivimin e pozitivitetit dhe shpirtit inicues dhe ndihmojnë me përmasa të mëdha në krijimin e moralit të personalitetit pozitiv dhe trim.

Këto komponente janë:

1- Vetëdija dhe njohja.

Hulumtimi dhe përcjellja e vazhdueshme e hapësirave të ndryshme e ndihmon njëriun në zbulimin e dimensioneve të shumta, të cilat ka mundur të mos i ketë ditur, pa dyshim se kjo vetëdije i ndihmon për të zbuluar mundësitë e reja dhe rrugëdalje që në shumë raste kanë qenë të panjohura për te dhe natyrisht se i ndihmon për tu vërsulur në to.

2- Vetbesimi.

Shumë prej nesh vet ia humbin vetës mundësitë për pikënisje dhe bërje të veprave të mira, qoftë kjo e mirë për vete ose për tjetrin, për shkak të dyshimeve në aftësitë dhe mosvlerësimit të vetes. Ky lloj i njeriut vazhdimisht parashtron pyetjen: po të kishte qenë kjo ide e shëndoshë, do t'i kujtoheshte atij dhe atij?! kurse njeriu pozitiv vepron në kundërshtim me këtë lloj të njerëzve. Vetbesimi që ka e shtyn vazhdimisht që t'i tejkalon pengesat dhe t'i eliminon vështirësitë.

3- Gatishmëria për rezikim dhe depërtim.

Mirëpo jo si reagime dhe nxitime të pamatura, por duke i vlerësuar gjërat si duhet.

Kjo gatishmëri e shtun njeriun për të zbuluar horizonte të reja të jetës dhe kontribon për kultivimin e zgjidhjeve të tija, andaj ai edhe nuk ndalet i hidhëruar para asnjë pengese, por posedon zgjidhje alternative, për shkak të përplasjes së vazhdueshme me problemet dhe futjes në shumë reziqe që i kanë krijuar një përvojë të madhe.

Ashtu sikur dallojnë individët në pozitivitetin e tyre drejt ndodhive që ndodhin përreth, ashtu dallojnë edhe shoqëritë.

Shoqëritë që individët e saja dallohen me pozitivitet dhe me shpirt inicues janë më të zhvilluara dhe të përparuara se simotrat e saja që u mungon kjo cilësi.

Pra, pozitiviteti, sikur që tham, qenka rruga e kultivimit dhe progresit.

Nëse analizojmë jetën e shumë personaliteteve të sukseshme do të vërejmë se shpirti inicues ka luajtur rol të madh në arritjen e këtyre gradave dhe fitoreve. Para tyre nuk ka mbetur asnjë pengesë që ka penguar hapërimin e tyre drejt synimeve që ia kanë caktuar vetes.

Kurse mes nesh ka të atillë që vet i ngrisin pengesat dhe ndërtojnë muret dhe e rrethekon veten me një sasi të madhe të termeve dhe nocioneve të gabuara që kontribuojnë për tu qëlluar me dembeli dhe përtesë.

Në vijim do tu ofrojmë disa terme dhe alternativat e tyre, të cilat duke i përdorur shpesh kanë krijuar brenda nesh disa cilësi negative që e pengojnë nisjen, ecjen dhe depërtimin në horizontet e suksesit dhe superioritetit:

Në vend se të themi= më mirë të themi

Kjo është punë ose detyrë e rëndë – kjo detyrë nuk është e lehtë, mirëpo mund ta bëj.

Mos u hidhëro- qetësohu

Sa e rëndë ishte kjo ditë – sa e mbushur është kjo ditë me aktivitete dhe punë

Nuk mundem – do të mundohem dhe do të tentoj

Supozoj se do të arrij sukses – me lejen e All-llahut do të arrij sukses

Nuk besoj se realizohet – shpresoj të realizohet

Ndihem dembel – kam nevojë për lëvizje dhe aktivitet

Nuk frikohem – jam trim

Ndihem i dobët – duhet të forcohem

Je i dobët – ke nevojë për trajnim

Shumë prej nesh i shfrytëzojnë këto terme ose disa prej tyre, të cilat krijojnë ndjenja të brendshme dhe nocione negative, sikur:

Nënshtrimi, dyshimi në aftësitë subjektive, dëshpërimi, paaftësia për rezultate dhe punë.

Notimi i bretkosave

Në këtë drejtim më kujtohen disa fjalë të një specialisti të etikës, Bari Igan, ku mes tjerash thotë:

"Sigurisht se keni dëgjuar fjalën e urtë "Nuk të troket dy herë në derë shansi". Mos i besoni kësaj fjale. Sepse shansi shumë herë i troket njeriut në derë, mirëpo krejt çështja është se na vjen në befasi dhe papritmas.. të kanë ofruar punë të re, ke refuzuar, të kanë thirrur për të ligjëruar, ke menduar se nuk mundesh, shtëpinë që dëshirove të blesh, nuk e bleve, e shumë shanse tjera. Vallë a të kujtohen të gjitha këto? Pranoni detyrat dhe përgjegjësitë më të rënda më dëshirë të flakët dhe jeni të bindur se nuk

do të dështoni, madje do ti kryeni përgjegjësitë e reja dhe do të mësoheni në to pas një kohe. Në përjashtim të rasteve ku jeni të bindur se ato janë qindpërqind mbi mundësitë dhe jashta aftësive dhe përvojës tënde.

Nëse dikush të pyet: a mendon se mundësh të marrish detyrë të re? Ti pa mëdyshje duhet të përgjigjesh: "po, bindshëm".

Mund që të kesh tremë pa arsye, e ti thuash vetes: realisht unë nuk mund të kem sukses në këtë punë? Si ka mundësi t'i mësoj të gjitha këto gjëra që duhet t'i mësoj? E ndiej se detyrat e mia janë të rënda.

Këto ndjenja janë normale kur njerëzit marrin përsipër detyra të reja, mirëpo nëse keni mundësi të notoni, futuni në ujë me dy këmbët dhe lëvizni me duart e juaja nëse ka nevojë, sepse dal nga dal, do të mësoheni, madje edhe notin e bretkosave".

Kjo domethënë përgaditje dhe aftësim psikik dhe praktik për shfrytëzimin e mundësive, përndryshe nëse njeriu prolongon, vonon dhe nuk nxiton, shtoja kësaj edhe ikjen e shansave, ai mund të humb aftësinë dhe mundësinë dhe dembelia dhe përtesë të bëhen cilësi e tij.

Vazhdimi i jetës nuk është në dorën e tij dhe nuk mund të garanton shëndetin, nivelin e aktivitetit, vazhdimin e ekzistimit të mjeteve dhe mekanizmeve të lëvizjes.

Andaj Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Shfrytëzo pes gjëra para pesë tjerave". Mes tyre ka përmendur edhe: "shfrytëzo rininë para pleqërisë".

Andaj nuk duhet ta privojmë veten nga shumë shpërblime, sepse ka shumë hapësira që e privojmë veten nga

depërtimi në to, për shkak të turpit, ose mosbesimit në veteve dhe në aftësitë personale.

Hapësirat janë të hapura për të gjithë, qofshin ato shoqata humanitare, aktivitetet rinore dhe studentore, aktivitetet sociale, përkujdesi për jetimë, aktivitetet vullnetare, akcione për pastrim të ambientit, akcione për grumbullim të

librave të vjetër, etj.

Mbarë mirësi qështë në personin që bashkëvepron me ambjentin që e rrethekon, sepse ummeti islam është sikur një trup, andaj duhet të jemi pozitiv me vetveten dhe me shoqërinë tonë të afërt....

Muhammed Mustafa

Solli në shqip dhe përshtati: Bekir Halimi

21, 01, 2005

Me moral të mirë ngritemi lart

Transmeton Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, nga Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i cili ka thënë: "Jam dërguar që të plotësoj virtytet (e mira) morale". (sahih, shiko: "sahihul-Xhami" nr. 2349 dhe "Vargun e haditheve të vërteta", nr. 45).

Munaviu, rahimehull-llah, duke e komentuar këtë hadith thotë:

"Jam dërguar për të plotësuar virtytet morale, pasi që ato ishin të mangëta dhe ti bashkoj ato pasi që ishin të shpërndara. ("Fejdul-Kadir", 2/710).

Transmeton Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Besimtari me besim më të plotë është ai që ka moral më të mirë, kurse më i miri nga ju është ai që është më i mirë në sjellje me gratë e tija". (Sahih, "sahihu suneni tirmidhi", nr. 1162).

Mubarekfurui, duke e komentuar këtë hadith në librin e tij ku ka komentuar të gjithë sunenin e Tirmidhiut, thotë:

"Besimi i plotë detyrimisht shkakton moralin e mirë dhe bamirësinë ndaj mbarë njerëzve. Kurse mirësia e njerëzve del nga mirësia e tyre ndaj grave të veta, sepse ato kanë nevojë për mëshirë, pasi që janë të dobta. (shiko: "Tuhfetul-Ahvedhi", 4/25).

Gabon shumë ai që bën ndarjen mes adhurimeve në Islam dhe sjelljes, sepse Kur'ani dhe Suneti vazhdimisht i përmendin së bashku.

Nga hadithi i sipërpërmendur e shohim se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, mundohet të plotëson virtytet morale, pasi që qëllimi i dërgesës së tij ka qenë pastrimi i shpirtit dhe arritja në grada të larta të përparimit dhe zhvillimit, që ti lejojë ta adhuron All-llahun si duhet.

Mirëpo vazhdimisht gjejmë devijime të mëdha nga kjo shpallje përfundimtare. Edhe pse kanë kaluar katërbëdhjetë shekujsh, kanë ndodhur deformimesh dhe devijimesh të llojlojshme dhe të ndryshme nga qëllimi origjinal, për plotësimin etë

cilit ka ardhur Islami, e ajo është ngulitja e principit të moralit të mirë mes njerëzve.

Sot, fatkeqësisht, shumë njerëz, qëllim të vetin e kanë etëm adhurimin, duke mos i dhënë rëndësi edhe arritjes së fryteve të adhurimit, e ajo është pastrimi i shpirtit.

Rëndësia e moralit të mirë

Ai që analizon ajetet Kur'anore do të vëren se pastrimi i shpirtit ka përparësi para mësimit të shkencave fetare. Analizo ajetin Kur'anor:

"(Sikurse plotësova mirësinë Time ndaj jush) Ashtu siç dërguam nga gjiu i juaj të dërguar t'u lexojë ajetet Tona, t'ju pastrojë, e t'ju mësojë librin dhe traditën, e edhe t'ju mësojë atë që nuk e dinit". (El-Bekare: 151).

"Është e vërtetë se All-llahu u dha dhuratë të madhe besimtarëve, kur ndër ta nga mesi i tyre dërgoi të dërguar që atyre t'u lexojë shpalljen e Tij, t'i pastrojë ata, t'ua mësojë Kur'anin dhe sheriatin, edhe pse, më parë ata ishin krejtësisht të humbur". (Ali Imran: 164).

"Ai është që arabëve të pashkolluar u dërgoi Pejgamberin nga mesi i tyre që t'ua lexojë ajetet e Tij, t'i pastrojë ata, t'ua mësojë librin dhe sheriatin, edhe pse më parë ata ishin në një humbje të dukshme". (El-Xhumua: 2).

Nga këto ajete shohim se kur flet All-llahu, subhanehu ve teala, mbi dërgimin e pejgamberit përfundimtar, Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, si ia ka caktuar detyrën, e ajo është pastrimi i shpirtit, e pastaj mësimi i Kur'anit dhe Sunnetit.

Pastrimi i shpirtit fillon dhe përfundon me tevhidin. Këtu hyn edhe pastrimi i shpirtit nga sëmundjet dhe arritja e

plotësisë, largimi nga haramet dhe zbatimi i adhurimeve. Kurse pastrimi i ummetit ndodh duke e aplikuar sherijatin në jetë.

Pastrimi i shpirtit (tezkije) është diç më shumë se dija, sepse dija ti jep rregullat dhe sqarimet për çdo gjë, kurse tezkija (pastrimi i shpirtit) është aplikim i kësaj dije në shpirtin e njeriut, sëmundjet, synimet, njohja e rrugës dhe mënyrës së shërimit, njohja e plotësisë dhe si të kalojmë në te, mjetet në këtë drejtim dhe vizion i veçantë për secilin njeri që i ndihmon për ta kaluar nga një gjendje në tjetrën. Këtu ka hise edhe përvoja, edhe pse dhurata e All-llahut është bazë në këtë drejtim:

"..., e kujt i është dhënë urtësia, atij pra i është dhuruar mirësi e madhe, ...". (El-Bekare: 269). (shiko: "El-Esasu fit-Tefsir", Seid Hava, 1/322-323).

Islami adhurimet e ndryshme që i ka përcaktuar nuk i ka bërë vetëm rituale të çveshura nga çdo domethënie dhe përmbajtje, por secili adhurim bart në vete vlera morale, të cilat duhet të reflektohen në jeën e muslimanit që i zbaton këto adhurime, të dalin në shesh qartë në sjelljen e tij me tjerët dhe në përcaktimin e kornizave për vetveten.

Adhurimi është raporti i njeriut me Zotin e vet, kurse sjellja është raporti i tij me njerëzit. Patjetër duhet të reflektohet raporti i njeriut me All-llahun në raportet e tija me shoqërinë, andaj duhet ti përmirëson këto raporte dhe ta edukon veten, përndryshe si ka mundësi ta ndërldhim namazin me ndalimin e imoralitetit dhe gjërave të shëmtuara, siç i ka ndërldhur All-llahu në Kur'an:

"...vërtet namazi largon nga të shëmtuarat dhe të irituarat, ...". (El-

Ankebut: 45).

E shmëtuara dhe e irituara e përmbledhin çdo të keqe dhe të poshtër, kurse këto gjëra dalin në shesh gjatë sjelljes tonë me njerëzit në shoqëri.

Adhurimi edhe pse ka të bëjë me raportin e njeriut me All-llahun, mirëpo edhe aspektet e sjelljes janë të pranishme në to. Për shembull, ti je i urdhëruar ta kryejsh namazin me xhemat, me qëllim që të kesh kontakte me njerëzit dhe të bashkëveprosh me ta. Gruaja është urdhëruar që mos të del në xhami e parfymosur dhe e stolisur, me qëllim që mos të joshë burrat. Gjat dhënies së zekatit, nëse i jep dikujt nga zekati, e pastaj mburresh para tij, kjo ta asgjëson këtë lëmoshë. Gjatë haxhit, duhet të jesh i sjellshëm gjatë kallaballëkut. E kështu me radhë.

Pra, në secilin adhurim del në shesh sjellja, të cilën duhet ta posedosh dhe të stolisesh me te.

Islami ka ardhur që të ngulitë vlerat fisnike tek individ, i cili e përbën shoqërinë. Prej vlerave të para që kujdesej islami ti thëllon në ndërgjegjën e individit është vlera e vëllezërimit. Kjo edhe ka qenë edhe vepra e parë që e ka bërë Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, pas shpërnguljes në Medinë. Ashtu që lidhjen vëllezërore nga përkatësia e bëri më të fuqishme se sa lidhjen e vëllezërisë bga gjaku. Ky ka qenë elementi që e ka ruajtur shoqërinë muslimane nga kurthet e shumta që i janë bërë, mirëpo fatkeqësisht kjo vlerë nuk ekziston aq sa duhet në msin e msulimanëve. A nuk është tradhtia shkaku që disa shtete jobesimtare kanë arritur të okupojnë disa shtete muslimane. Këtyre tradhtarëve nuk ju intereson as vëllau, e

as nderi, duke vrapuar që të fitojnë pak pasuri.

Kjo tregon se në shoqëritë muslimane dominon egoizmi dhe vetjakësia, principet e huaja, saqë është bërë moto e tyre në jetë: "unë, e pas meje le të bëhet tufan". Nuk ka mbetur vend për vlerat e altruizmit, vetfljimit për hirë të vëllezërisë dhe shoqërisë. Pa dyshim se ky është defekti i madh dhe alarmi për shkatërrim të shoqërive ku dominojnë këto ide dhe mendime.

Sjellja e muslimanëve në kohën e sodit

Nga kjo që tham deri tani përfundojmë se pastrimi i shpirtit është prej gjërave esenciale dhe sipas rëndësisë barazohet me zbatimin e adhurimeve. Mirëpo çka ndodh në realitetin e sotshëm?

Është përhapur mes njerëzve shprehja: në vendet muslimane ka musliman, mirëpo ska islam, kurse në perendim ska musliman, mirëpo ka islam! Kjo thënie është argument se muslimanët nuk janë të cilësuar me moralin islam, kurse perendimorët edhe pse nuk janë musliman i kanë përvetësuar shumë cilësi të muslimanëve!

Shembujt në këtë drejtim, fatkeqësisht janë të shumta.

- Ishim duke e falur namazin e teravisë, kurse njerëzit shtyhen për të zënë vend në safin e parë. Ky gjest i hidhëron shumë namazli. Në vend se të dominon shpirti vëllezëror dhe dashuria mes tyre, ata hidhërohen dhe urrehen. Vallë a është kjo sjellje islame e shëndoshë?

- Më kanë treguar disa shokë se kishin hyrë në itikaf bashk. Pasi që i kanë kaluar disa ditë bashk në itikaf janë shndëruar në njerëz të urrejtur mes tyre, kurse më

herët kanë qenë vëllezër të dashuruar mes tyre. Kjo ka ndodhur për shkak se ndeja e gjatë bash dhe kontakti mes tyre i ka nxjerur në shesh sjelljet e këqija dhe moralin negativ të njëri tjetrit.

- Më kanë treguar për një plak me mjekër, i cili me vete merrte nipin në xhami. Kurse gjat faljes së namazit nipi, si fëmijë, lozte dhe vraponte në xhami. Pas namazit, ky pal me mjekër ia flakaresh një shuplakë fëmiut, vepër të cilën askush në xhami nuk e pëlqen.

- Dikush nuk i ndalet gjuha nga dhikri dhe duaja gjatë rrugës, mirëpo nëse ndodh ndonjë zënke e vogël mes tij dhe tjetrit që afër tij është me veturë, ndërrohet krejtësisht e fillojnë sharjet dhe ofendimet.

- Në Mekë, gjatë kryerjes së Haxhit ose Umres, sa zënka dhe shtyrje ndodhin mes njerëzve për të arritur te guri i zi. Prekja e gurit të zi është sunnet kurse zënka dhe dëmtimi i muslimanëve është mëkat. Disa madje e ndërpresin namazin para imamit me qëllim që ti afrohen sa ma shpejtë gurit të zi.

Këto shembuj tregojnë dallimin e madh mes fesë dhe moralit dhe mes adhurimeve dhe sjelljes.

Prej shembujve tjera në këtë drejtim është edhe njeriu që fal namaz, agjëron dhe jep lëmoshë, mirëpo aspak nuk e kontrollon shtëpinë e vet, gruaja e tij del e çveshur, nuk kujdeset për vajzën e tij, nuk ia njuh shoqët, etj.

Dikush mundohet ti zbaton edhe imtësitat më të mëdha në adhurime, kurse sa i përket sjelljes, ai aspak nuk kujdeset për te.

Secili civilizim ngritet mbi dy parime: atë shkencor dhe atë moral.

Kjo na e potencon afërsinë e rënies së

civilizimit shtazarak i cili dominon dhe sundon botën, mirëpo në të njëjtën kohë nuk na përgëzon se Ummeti Islam do ta trashëgojë këtë pozitë, sepse morali i ummetit islam akoma është shumë larg nivelit për ta udhëhequr botën. Rënia e ummetit në njërën prej tyre, do të shkakton edhe rënien në tjetrën.

Le të shikojmë se si është përhapur Islami anë e mbanë botës. Atë e kanë përhapur tregtarët musliman me sjelljen e tyre dhe moralin që kanë poseduar.

Vlera e moralit të mirë

Shumë tekste flasin për vlerën e moralit të mirë dhe nxisin në pajisje dhe posedim të tyre.

■ Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, thotë: Erdhi një njeri dhe i tha Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: filaneja shumë fal namaz, agjëron dhe jep lëmoshë, mirëpo u pengon fqinjëve me gojën e saj. Tha: ajo është në zjar. I tha: o i dërguar i All-llahut, filaneja nuk ka shumë namaz, agjërim dhe sadaka, e nëse jep sadaka jep një copë të vogël të qumshtit të tharë, mirëpo nuk u pengon fqinjëve me gojën e saj. Tha: ajo është në xhennet". (sahih, Ahmedi).

Pra, shikoni në këtë hadith, nuk ka bërë dobi adhurimi i madh përskej sjelljes së keqe, kurse shikoni se çka ka bërë sjellja e mirë edhe pse adhurimi ka qenë i pakët!

■ Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, tregon se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Një njeri s'kishte bërë asnjë vepër të mirë, mirëpo u jepte borxh njerëzve dhe i thoshte nëpunësve të vet: merrne borxhin nga ata që e kanë gjendjen e lehtë dhe

leri ata që e kanë gjendjen e vështirë, falja njerëzve e ndoshta All-llahu na e fal neve mëkatin. Kur vdiq, All-llahu, azze ve xhel-le, i tha: a ke bërë ndonjë të mirë? Tha: jo! Mirëpo kisha një nëpunës dhe u jepja borxh njerëzve, e kur e dërgoja ta merr borxhin i thoja: merre borxhin nga ata që kanë dhe falja atyreve që nuk kanë, falja njerëzve e ndoshta All-llahu na e fal neve. All-llahu, azze ve xhel-le, i thotë: edhe unë ta fala ty". (sahih, Nesai).

■ Aisheja, radijall-llahu anha, thotë: Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: hyra në xhennet dhe dëgjova lexim të Kur'anit. Thash: kush po lexon? Më thanë: Harithe ibën Numan. Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, tha: këtu të sjell bamirësia. Këtu të sjell bamirësia". (sahih, Nesai).

Harithe ibën Numan ishte njeri që kishte marrë pjesë në betejën e Bedrit dhe ishte njeri shumë bamirës ndaj nënës së vet. Sikurse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dëshiron tua tërheq vëmendjen sahabeve për shkakun që e ka sjellur këtë njeri deri në këtë gradë. Domethënë Harithen e ka sjellur në këtë gradë bamirësia ndaj nënës së vet. (Shiko: "Fejdu-l-Kadir", 3/637-638).

Sjellja e mirë nuk kufizohet vetëm ndaj njerëzve, madje duhet të sillemi mirë edhe ndaj kafshëve, sepse edhe kjo sjellje e mirë bëhet shkak për tu na u falur mëkatin dhe për të hyrë në xhennet.

■ Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, thotë se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Një grua lavire e pa një qen në një ditë të nxehtë rrotullohej përreth bunarit dhe i kishte dalur gjuha nga etja. Nxori ujë nga

bunari me këpucën e vet dhe i dha ujë. Kjo vepër shkaktoi ti falen mëkatin". (Muslimi).

■ Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, tregon se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Një njeri kishte parë një qen duke ngrënë dhe nga etja. Mori këpucën e tij, e mbushi me ujë dhe i dha ujë derisa u ngop. All-llahu e falënderoi për këtë vepër dhe e shtyri në xhennet". (Buhariu).

"Domethënë e lavdëroi dhe e shpërbleu duke ia pranuar veprën dhe duke e shtyri në xhennet". (Shiko: "Fet'hul-Bari", 1/334).

■ Ebu Derda, radijall-llahu anhu, tregon se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Nuk ka gjë që vëndohet në peshojë më të rëndë se sa sjellja e mirë. Njeriu me sjellje të mirë arrin gradën e agjëruesit dhe namazliut". (sahih, Tirmidhiu).

■ Ebu Dherrri, radijall-llahu anhu, thotë: Më ka thënë Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem:

"Mos nënçmoni asnjë vepër të mirë, së paku të takohesh me vëllaun tënd me fytyrë të buzëqeshur". (Muslimi).

Imam Nevevi, rahimehull-llah, thotë: Ky hadith na stimulon për ta kuptuar vlerën e mirësisë dhe të bëjmë atë që kemi mundësi edhe nëse është pak, madje buzëqeshja në fytyrën e vëllaut tonë. ("Sherhu Sahihi Muslimi", 8/426)

Kurse Mubarekfuri, rahimehull-llah, duke e komentuar këtë hadith thotë:

"Ky hadith tregon se sadakaja nuk është vetëm me gjëra konkrete dhe nuk veçohen me këtë vepër vetëm të pasurit, por secili ka mundësi ta bëjë dhe në shumë raste pa rëndësi". ("Tuhfetul-

Ahvedhi", 5/383).

Shikoni të gjithë këta njerëz që i përmendi Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, në këto hadithe, ata nuk kanë bërë shumë namaz, agjërim ose sadaka, mirëpo vepra e mira kryesore e tyre paska qenë sjellja e mire dhe ishte bërë shkak për tua falur All-llahu atyreve mëkatet dhe pastaj për të hyrë në xhennet. E kundërta ndodh me ata që kanë moral të keq.

■ Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, tregon se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Ka hyrë një grua në zjar për shkak të maces: as nuk e ka ushqyer e as nuk e ka lërrë të han insektet e tokës, derisa ka vdekur". (Buhariu dhe Muslimi).

■ Xheriri, radijall-llahu anhu, tregon se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Ai që privohet nga butësia privohet nga mirësia". (Muslimi). Në transmetimin tjetër qëndron: "All-llahu është i butë dhe e do butësinë. I jep butësisë atë që nuk ia jep dhunnës dhe atë që nuk ia jep asgjë tjetër". Në transmetimin tjetër qëndron: "Çdo kund ku gjindet butësia, ajo gjë është e stolisur dhe çdo kund ku mungon butësia ajo shëmtohet". Në transmetimin tjetër qëndron: "Je i butë".

Dhuna është kundër butësisë. Këto hadithe e tregojnë vlerën e butësisë dhe stimulojnë drejtë saj dhe e qortojnë dhunën. Tregojnë se butësia është shkak i çdo të mire. Kadi Ijadi thotë: butësia ti realizon qëllimet dhe ti lehtëson detyrat". (Sherhu Sahihi Muslimi", 8/391).

Disa qëndrime nga jeta e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem

Argumentet e lartpërmendura nuk do të kenë edhe aq ndikim nëse nuk kemi dikend që i ka zbatuar në praktikë këto vlera. Do të mundohemi të shikojmë jetën e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, që ti shohim këto vlera në praksën e Pejgamberit, alejhisselam.

■ E kanë pyetur Aishen radijall-llahu anha, për moralin e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kurse ajo u është përgjigjur duke thënë: "Moralin e tij ishte Kur'an". (Muslimi).

Domethënë se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, të gjitha urdhërat e Kur'anit i ka zbatuar dhe është larguar nga të gjitha ndalesat e tija. Kështu moralin e tij bëhet moral i Kur'anit.

■ Transmeton Buhariu dhe Muslimi se një bediun e tërhoqi për petku Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, aq e fortë ishte kjo tërhjekje sa që la gjurmë në qafën e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, pastaj tha: O Muhammed, me jep nga pasuria e Allahut që e ke. U kthye nga ai Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e pastaj qeshi dhe i urdhëroi që ti japin diçka".

■ Kur e dëmtonte populli i vet luteshte duke thënë:

"All-llahu im falja popullit tim, se ata nuk e dinë". (Buhariu dhe Muslimi).

■ Qëndrimi i Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ndaj Omerit, radijall-llahu anhu, në ditën e marëveshjes së Hudejbisë, ishte qëndrim i komandantit që e mëson ushtarin e vet. Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, me zemërgjërësi e pranoi debatin e ashpër të Omerit, radijall-llahu anhu. Duke dhënë kështu shembullin më të madh të

butësisë. Këtë e mësoi shumë mirë Omeri, radijall-lahu anhu, edhe kur u bë Halife sillej me njerëzit nga kjo pikënisje. (shiko detajet e këtij tregimi në sahihun e Buhariut).

■ Ebu Seid el-Hudriu, radijall-lahu anhu, tregon:

Erdhi një bediun te Pejgamberi, sal-lall-lahu alejhi ve sel-lem, për ta kërkuar borxhin e tij dhe u soll ashpër, gjersa i tha: do të ngushtoj derisa nuk ma lan borxhin. E qortuan shokët e Pejgamberit, sal-lall-lahu alejhi ve sel-lem, e i thanë: vaj për ty! A e din me kënd flet? Tha: jam duke e kërkuar hakun tim. Pejgamberi, sal-lall-lahu alejhi ve sel-lem, tha: pse nuk jeni në anën e atij që ka hak? Pastaj kërkoj nga Haule bintu Kajs hurma duke i thënë: nëse ke hurma na jep borxhë derisa të na vijnë hurmat tona e ta lajmë borxhin? I tha: po, flijofsha babë e nënë për ty! Mori borxh nga Heuleja dhe ia lau borxhin beduinit dhe i dha ushqim. Kurse beduini i tha: e lajte borxhin, All-lahu ta laftë ty. Pejgamberi, sal-lall-lahu alejhi ve sel-lem, tha: këta janë njerëzit më të mirë. Mos u shenjtëroftë një popull ku i dobt nuk e mer hakun pa u lodhë". (sahih, Ibën Maxheja).

■ Enesi, radijall-lahu anhu, tregon: çdo gjë që kanë lypur nga Pejgamberi, sal-lall-lahu alejhi ve sel-lem, për Islam ai e ka dhënë. I erdhi një njeri dhe i dha dele sa mund të ketë mes dy kodrave. Kur u kthye te populli i vet u tha: bëhuni musliman se Muhammedi po jep aq shumë sikur njeri që nuk i frikohet varfërisë". (Muslimi)

Të gjitha këto raste na lajmërojnë mbi moralin e Pejgamberit, sal-lall-lahu alejhi ve sel-lem, dhe sjelljen e tij me njerëzit.

Këtë e kanë kuptuar shumë mirë sahabet e Pejgamberit, sal-lall-lahu alejhi ve sel-lem, dhe kanë vazhduar në rrugën e tij, andaj ngritën një civilizim i cili sundoi botën shekuj me rradhë.

Disa qëndrime të sahabeve dhe tabiinëve

Ky shpirt dhe ky moral mbeti në ummetin islam, andaj vërejmë qëndrime të tillë edhe te tabiinët.

Bisedën time rreth qëndrimeve të tilla do ti përmbyll me dy raste:

Rejahu thotë: Ma përmendën një grua dhe u martova me te. Ajo kur e falte namazin e jacistë, parfymosej dhe veshej mirë pastaj më vinte dhe më thoshte: a ke nevojë për mua? Nëse i thoja: po, ajo rrinte me mua, e nëse i thoja jo, ajo ngritej dhe nuk ndalej duke u falur deri në mëngjes. (shiko: "Ruhbanul-Lejli", 2/34).

Doli Ibrahim ibën Ed'hemi në një vend. Iu drejtua një ushtar dhe e pyeti: ku është imrani? Ai tregoi me dorë drejt varrit. E goditi në kokë dhe e lëndoi. Kur i treguan se ky njeri është Ibrahim ibën Ed'hemi, filloi tia puth këmbët dhe duart. Ky atëherë tha: kur më goditi në kokë e luta All-lahun tia dhuron xhennetin, pasi që e dija se unë shpërblehem për shkak të kësaj goditje që ma dha, andaj nuk dëshirova që unë të fitoj prej tij e ai të humbë prej meje". ("Muhtesar Minhaxhul-Kasidin", fq. 170).

Mënyrat e shërimit

Veorat e mira burojnë nga morali i mirë, andaj secili prej nesh le të kontrollojë cilësitë dhe moralin e tij dhe le të fillon ti shëron një pas një. Ji i vendosur

në këtë rrugë, sepse pas një kohë do të vjen mirë kjo gjë.

Ai që e di se ymri i tij është shumë i shkurtë në krahasim me ahiretin do të duron disa ditë vështirësitë e udhëtimit për të jetuar në begati përgjithmonë, sepse në mëngjes lavdërohet ai që natën ka ecur.

Duhet ta dimë me bindje se ne nuk do të mund të jemi të dobishëm për Islamin dhe thirrjen nëse nuk pajsemi më virtyte morale.

Një ditë isha duke e thirrur një kolegë në punë për të qenë i rregullt në faljen e namazit, mirëpo nuk më përgjigj. Unë kur fillova të jem më i vrazhdë, atij edhe më shumë iu shtua inati. Pastaj kur e ndryshova metodën dhe fillova të jem i butë dhe buzëqeshur, kërkova falje për sjelljen time të gabuar, edhe ai u zbut dhe u ngrit për tu falur me mua.

Tregon hoxha Muhamed Hasani një përvojë të tij në këtë drejtim. Ai thotë: isha duke shkuar për të mbajtur një ligjeratë në një vend. Ma tërhoqi vëmendjen një radhë e madhe të të rinjve para një sporteli të biletave të një kinemaje. U futa edhe unë në rradhë dhe pastaj fillova me fjalë të buta dhe të ëmbëla të flas me ta. Pas një kohe më shumë se dhjetë të rinjë e lanë blerjen e biletave për kinema dhe u nisën me mua për në ligjeratë.

Dëshirojmë që t'i shfaqim frytet e adhurimeve tona në moralin dhe sjelljet tona dhe të jetë muslimani i dalluar në sjelljen dhe gjestet e tija.

Ndoshta prej shkaqeve më të

rëndësishme për shërimin e kësaj dukurie janë këto:

■ Shoqërimi me njerëz të moralshëm, sepse natyra është hajne dhe e vjedh edhe të mirën edhe të keqen. Këtë e ndihmon hadithi i Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem:

"Njeriu është në fenë e shokut të tij, andaj le të shikon se cilin e bën shok". (hasen, Tirmidhiu).

■ Kërko ndihmë te All-llahu dhe lutu, sepse Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, është lutur që All-llahu ti dhuron sjellje të mirë duke thënë:

"Më udhëzo në sjelljen më të mirë, sepse vetëm ti udhëzon drejt saj dhe largom nga sjellja e keqe, sepse vetëm Ti largon nga ajo". (Muslimi).

■ Vendosmëria për ta ndryshuar sjelljen e keqe dhe durimi në këtë drejtim.

■ Kundërshtimi i epshit, sepse pasimi i sjelljes së keqe është në përputhje me pasionet e njeriut dhe epshet e tija, kurse stolisja me vlera morale ka nevojë për luftë dhe qëndresë.

■ Besimi i shëndoshë, sepse besimet e shtrembëruara që e ndajnë besimin nga vepra dhe veprat nga kërkesat e fjalës la ilahe il-lallah kanë krijuar opinion se mjafton të besosh edhe nëse sillesh keq ose edhe nëse nuk vepron asnjë vepër të mirë. Këtu ka luajtur rol edhe sufizmi i cili i jep rëndësi vetëm raporteve me Zotin duke anashkaluar raportin me njerëzit dhe me këtë është humbur barazpesha islame.

Muhamed Hasen Jusuf
Përshtati: Bekir Halimi
28.1.2005

O Zot, na bë prijës të të devotshmive!

Transmeton Imam Muslimi nga Enes ibën Maliku, radijall-llahu anhu, i cili thotë: "Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ishte njeriu më i mirë, më bujari dhe më trimi. Një ditë u trishtuan banorët e Medinës dhe u nisën njerëzit drejt vendit nga vinte zëri. I takoi Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duke u kthyer nga vendndodhja, i hupur në kalin e Ebu Talhës, kurse në qafë kishte shpatën dhe thoshte: "Mos u trishtoni, mos u trishtoni".

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ua kishte kaluar shokëve të tij dhe kishte qenë i pari te vendi nga erdhi zëri, e pastaj u kthye që ti qetësojë dhe tua pakësoj trishtimin, duke u thënë: "mos u trishtoni". Të këtyrë janë shembëlltyrat.

Kriza e ummetit në këto ditë është krizë për shembëlltyra.

Ummeti islam është sprovuar me emra që skanë përmbajtje dhe tituj që nuk kanë brendësi, andaj janë shtuar biseduesit dhe janë pakësuar ndikuesit, stolisen shprehjet, mirëpo janë shëmtuar të vërtetat.

Sa e bukur është thënia e Imam aliut, radijall-llahu anhu, të cilën e transmeton Maverdiu, ku mes tjerash ka thënë:

"Njerëzit janë asket në kërkim të dijes pasi që shohin se pak janë ata që përfitojnë nga ajo që kanë msuar. Më herët kanë thënë: "Më i mirë se biseda është ai që e praktikon, kurse më i mirë se e sakta është ai që e ka thënë dhe ma i mirë se dija është ai që e bartë ate".

Këtë e pasoi Malik ibën Dinari dhe e lëshoi fjalën e tij si vetëtimë:

"Nëse dijetari nuk vepron sipas dijes së

tij, rëshqet këshilla nga zemra, sikur rosa nga gjethi".

E vërteta të cilën duhet ta kuptojnë thirrësit dhe njerëzit e thirrjes islame është se nga momenti i kapjes së tyre për fenë, kërkimit për qeverisje me Islam dhe konsiderimit të tij metodë jete, njerëzit i shikojnë me një shikim shumë preciz dhe i vëndojnë nën kontroll mikroskopik. Ndoshta ndonjë vepër të cilën e bën një musliman fetar pa vëmendje, kjo vepër në llogarinë e masës së gjërë është prej mëkateve të mëdha, sepse ata ate e shikonjë si shembëlltyrë.

Andaj, jeta dhe sjellja e thirrësit, natyra e lëvizjeve dhe preokupimeve të tija, nuk janë pronë vetëm e atij, ai nuk është i lirë të bëjë çka të dëshirojë, por duhet të peshojë secilën lëvizje dhe pushim dhe të kupton ndikimin e tyre te njerëzit.

Andaj një dijetar i selefit ka thënë: "Loznin dhe bënim shaka, mirëpo kur e vërejtëm se neve na pasojnë, atëherë u larguam nga ato vepra".

Një ditë hyri Marvezii te Imam Ahmed ibën Hanbeli e i tha: "O mësues, All-llahu, subhanehu ve teala, thotë: "mos e vritni vetveten". Imam Ahmedi i tha: Mervezi, dil dhe shiko se çka do të shohish. Merveziu thotë: dola në oborrin e halifit, pash shumë njerëz me fleta, lapsa dhe ngjyrë në dorë. I pyeti Marvezii: ç'janë duke bërë? Thanë: presim se çka do të thojë Imam Ahmedi e ta shënojmë. Merveziu u tha: rrini ku jeni. Hyri te Imam Ahmedi dhe i tha: pash njerëz me fleta dhe lapsa në dorë presin se çka do të thuash për ta shënuar. Imam Ahmedi tha: a ti çoj në devijim të gjithë ata? Më mirë vritem se sa

ti devijoj të gjith ata".

Kemi nevojë të kujdesemi për shembëlltyra, madje në secilin grup të kemi nga një grup të shembëlltyrave, të cilët do ta luajnë rolin e udhërrëfyesit dhe stimuluesit për vëllezërit e tij thirrës, kështu t'i krijojmë daves islame shembëlltyra edukative dhe tjera thirrëse, e të tretat imanore, e të katërtat shoqërore, etj.

Mbeti të themi: përgjegjësia e krijimit të këtyre shembëlltyrave është e përbashkët. Thirrja islame duhet të selekton shembëlltyrat dhe ti zhvillojë ato, ti orientojë dhe t'i stimulojë, të kujdeset për to dhe tu sigurojë gjërat për të cilat kanë nevojë shembëlltyrat, siç ëshë dja, njohja, shtoja kësaj edhe mjetet që i ndihmojnë shembëlltyrës që të kujdeset për devotshmërinë dhe kontaktin e tij me All-llahun, azze ve xhel-le.

Në anën tjetër individi e bartë një pjesë të madhe të përgjegjësisë, andaj nuk është e pranuar që shembëlltyra të mbetet e paaftë, mos të ketë asnjë brengë tjetër përpos se ta hapë gojën për të gëlltitur gjërat që i duhen shembëlltyrës, sepse kjo është e rëndë për thirrjen islame. Andaj, shembëlltyra ose ai që dëshiron të jetë shembëlltyrë,

duhet të mer vetiniciativë dhe t'i zhvillon aftësitë dhe dituritë e tija, të kujdeset për besimin dhe zemrën e tij.

Njerëzit me ambicje të larta refuzojnë të jenë njerëz pa ndikim, andaj prej lutjes së besimtarëve është: "O All-llah, na bë prijës të njerëzve të devotshëm". (El-Furkan: 74).

Katadeja duke e komentuar këtë ajet ka thënë: "Prijës në të mirë, thirrës në udhëzim, të bëhemi shembëlltyrë në të mirë".

Është mejdan garash, andaj All-llahu e mëshiroftë ate që i përvjel krahët për të qenë i pari dhe All-llahu e shpërbleftë me të mira ate që e detyron veten të jetë serioz dhe aktiv, sepse sot, nuk ka vend për të dobëtit.

Kujtoje fjalën e poetit kur thotë:

Të hershmit kaluan dhe nuk i mashtruan njerëzit

Më llafe boshe, sepse janë besnikë

Ata të mëvonshmit ecën sipas epshit të tyre

Kurse e dini mirë se çka na bën epshi

Epshi i shtyri për të grumbulluar pasuri dhe dhurata

Kurse ajo që grumbulluan u shkoi huç

Kjo është qortim për dijetarët

Nëse në mesin tonë ka dijetarë

Dr. Ali El-Hamadi

Përshtati: Bekir Halimi

4.2.2005

Hixhreti

Të nderuar besimtar, gjindemi në prag të vitit të ri të muslimanëve. Ky vit fillon me muajin Muharem, i cili është muaji i parë në kalendarin islamik. Kalendarin islamik ka filluar të llogaritet nga data e shpërnguljes së muslimanëve nga Mekeja për në Medinë.

Andaj ne do të flasim pak për hixhretin, si një ndodhi vendimtare për ecurinë e ummetit islam.

Definicioni i hixhretit

Hixhreti — shpërngulja, në gjuhën arabe do të thotë lërja e një vendit dhe shkuarja në një vend tjetër, ose ikja nga një tokë në tokë tjetër. (Shiko: “Lisanul-Arab”, 8/ 4616; “Muxhemu Mekajisul-Luga”, 6/ 34)

Hixhreti mund të jetë me zemër, gjuhë dhe trup. (Shiko: “Et-Tekif ala Muhimatit-ta’rif”, fq. 738).

Hixhreti me trup përmendet në Kur'an: “...madje largohuni nga shtrati ...”. (En-Nisa: 34).

Hixhreti me gjuhë përmendet në fjalën e Aishes, radijall-llahu anha, kur i thotë Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: “Unë e di kur je e kënaqur me mua dhe kur je e hidhëruar. Kur je e kënaqur me mua thua: jo, pasha Zotin e Muhamedit, kurse kur je e hidhëruar me mua thua: jo, pasha Zotin e Ibrahimit”. Tha: po ashtu është. Pasha All-llahun, o i dërguar i Zotit vetëm emrin tënd e largoj”. (Buhariu).

Këto gjëra mund të mblidhen të gjitha në një njeri dhe të jenë një nga një.

Kurse në gjuhën e sherijatit hixhreti ka domethënie të caktuar. Sipas shumë dijetarëve hixhret në gjuhën e sherijatit domethënë lëria e shtëpisë së Kufrit dhe ikja në shtëpinë e Islamit. (Shiko: “Et-Tarifati”, Xhurxhani, fq. 256, “Mufredat”, Ragib, fq. 537 dhe “Xhamiul-Ulumi vel-Hikem”, lbën Rexheb, 1/ 72- 73).

Kurse më e përgjithshme se kjo është ajo që ka thënë lbën Haxheri, rahimehull-llah: “Hixhreti në gjuhën e sherijatit domethënë: lëria e asaj që ka ndaluar All-llahu”. (shiko: “Fet’hul-Bari”, 1/ 16).

Duke u mbështetur në hadithin që e transmeton Imam Buhariu:

“Muhaxhir është ai që largohet nga ajo që ia ka ndaluar All-llahu”.

Kjo ngërthen hixhretin e brendshëm dhe të jashtëm. Hixhreti i brendshëm domethënë lëria e gjërave në të cilat të thërret shpirti që urdhëron në të keqe dhe në atë që ia zbukuron shejtani, kurse e dukshme domethënë ikje me fe nga telashet. E para është baza e të dytës. (shiko: “Fet’hul-Bari”, 1/ 54).

Pasi që e dyta është shenja më e madhe dhe më e plotë e të parës, disa dijetar ashtu edhe e sqarojnë. Pastaj pasi që hixhreti i Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ishte hixhreti më i ndershëm dhe më i njohuri, vazhdimisht kjo nënkuptohet kur flasim për hixhretin.

Kur hasim në libra dy hixhretet është qëllimi hixhreti në Etiopi dhe hixhreti në Medinë. (shiko: "Lisanul-Arab", 8/ 4617).

Vlera e hixhretit

Për vlerën e hixhretit flasin shumë ajete dhe shumë hadithe të Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem.

A) Prej ajeteve janë këto:

1- "Ata të cilët besuan, ata që u shpërngulën dhe luftuan në rrugën e All-llahut, ata meritojnë të shpresojnë në mëshirën e Tij. All-llahu falë shumë dhe është mëshirues". (El-Bekare: 218).

Ibën Xheriri, rahimehull-llah, thotë: "Ata që janë shpërngulur nga vendbanimet e idhujtarëve, fqinjësinë e tyre, kanë ikur prej tyre dhe prej fqinjësisë së tyre në vende tjera, hixhret nga një vend në vendin tjetër... Shokët e Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, janë emërtuar muhaxhirë për shkak të shpërnguljes së tyre nga shtëpitë dhe vendbanimet e tyre, nga urrejtja për të jetuar në mesin e idhujtarëve dhe nën pushtetin e tyre, pasi që nuk kanë garancë nga sprovat...".

Domethënia e ajetit është: ata që u shpërngulën nga pushteti i idhujtarëve në shenjë hixhreti, nga frika e sprovës në fenë e tyre dhe i kanë luftuar për hirë të fesë që ti fusin në fenë dhe në gjëra që e kënaqin All-llahun, "ata e shpresojnë mëshirën e Tij", domethëne shpresojnë që All-llahu ti mëshirojë e ti fusë në xhennetin e Tij me mëshirën e tyre për ta". ("Xhamiul-Bejan", 2/ 355).

Imam Sadiu, rahimehull-llah, thotë: "Këto tre vepra janë titulli i lumturisë, boshti i adhurimit, me to njeriu e di fitimin dhe humbjen. Sa i përket besimit, mos pyet se çfarë vlere ka...kurse hixhreti ka kuptim të

largimit nga i dashuri dhe i afërti për ta kënaqur All-llahun. Muhaxhiri largohet nga vatani, pasuria, familja e tij dhe miqtë e tij, për t'iu afruar All-llahut, për ta ndihmuar fenë e Tij. Kurse xhahadi ka kuptim të dhënies së mundit për të zbrapsur armikun, veprimtari të plotë për ta ndihmuar fenë e All-llahut dhe për ta eliminuar fenë e shejtanit. Është kulmi i veprave të mira edhe shpërblimi për këtë vepër është shpërblimi më i mirë. E meritojnë këta njerëz të jenë ata që shpresojnë mëshirën e All-llahut sepse kanë sjellur shkakun që shkakton mëshirën". ("Tefsir Sadi", 1/ 173- 174).

2- "...por ata që u dëbuan prej shtëpive të tyre dhe emigruan, u munduan vetëm pse ishin në rrugën Time, luftuan dhe u vranë, atyre patjetër do t'ua shlyej mëkatet e tyre dhe do t'i vejë në xhennete në të cilët burojnë lumenj. Ai është shpërblim nga ana e All-llahut, se më i miri i shpërblimeve është tek All-llahu". (Ali Imran: 195).

Ibën Xherir Taberiu, rahimehull-llah, thotë: "Ata që u shpërngulën nga populli i tyre mosbesimtar dhe nga fisi i tyre për hirë të All-llahut dhe shkuan te vëllezërit e tyre besimtar, ata që i besuan Pejgamberit të All-llahut, ata që u dëbuan nga shtëpitë e tyre, që janë muhaxhirët që i larguan idhujtarët kurejshit nga Mekeja, "te All-llahu është shpërblimi i mirë për ta", domethënë te All-llahu është shpërblimi për të gjitha llojet e veprave të tyre, është shpërblim, të cilin nuk mund ta përshkruan askush, sepse është ajo që syri nuk e ka parë, veshi se ka dëgjuar dhe ajo që zemra se ka parafytyruar". ("Xhamiul-Bejan", 3/ 216).

Ibën Kethiri thotë: "Janë larguar nga shtëpia e besimit, janë larguar nga të dashurit, miqtë, vëllezërit dhe fqinjët... "Shpërblim nga Zoti", është shprehur kështu All-llahu për të treguar madhësinë e

shpërblimit, sepse I Madhi dhe Bujari japin shumë”. (“Tefsiri i Ibën Kethirit”, 2/ 166).

Sadiu thotë: “Ata grumbulluan besimin dhe hixhretin, ikjen nga të dashurat, qoftë vatani dhe pasuria për të kërkuar kënaqësinë e Zotit të tyre dhe për këtë luftuan në rrugë të All-llahut”. (Tefsir Sadi”, 1/ 306).

3- “Është e vërtetë se ata që besuan, u shpërngulën dhe luftuan me pasurinë e shpirtin e tyre në rrugën e All-llahut, dhe ata që strehuan (të shpërngulurit) dhe u ndihmuan, të tillët janë miq të njëri-tjetrit (në ndihmë dhe në trashëgim). Ata që besuan por nuk u shpërngulën, ju nuk keni përkujdes as ndihmë për ta derisa të shpërngulen edhe ata. ...”. (El-Enfal: 72).

Ibën Xheriri, rahimehull-llah, thotë: “Muhaxhirët dhe ensarët janë njëri prej tjetrit, e ndihmojnë njëri tjetrin kundër idhujtarëve, janë unik kundër atyreve që kanë mohuar Zotin, janë vëllezër të njëri tjetrit, për dallim nga të afërmit e tyre mosbesimtar”. (Xhamiul-Bejan”, 6/ 51).

Ibën Kethiri, rahimehull-llah, thotë: “All-llahu, subhanehu ve teala, i ka përmendur llojet e besimtarëve, i ka ndarë në muhaxhir, të cilët kanë dalur nga shtëpia dhe pasuria e tyre, kanë flijuar pasurinë dhe vetveten në këtë drejtim, dhe në ensar, të cilët janë musliman, prej banorëve të Medinës, të cilët strehuan vëllezërit e tyre muhaxhir në shtëpitë e tyre, u solidarizuan me ta, e ndihmuan All-llahun dhe Pejgamberin duke luftuar së bashku me ta, ata janë miqtë e njëri tjetrit”. (Tefsiri i Ibën Kethirit, 4/ 38).

Sadiu, rahimehull-llah, thotë: “Kjo është akt lojaliteti dhe dashurie të cilën e ka kontraktuar All-llahu mes muhaxhirve dhe ensarëve, të cilët kanë besuar dhe janë shpërngulur në rrugë të Zotit; kanë lënë vatane të tyre për të luftuar në rrugë të Zotit

dhe mes ensarëve të cilët i kanë dhënë strehim Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe shokëve të tij dhe u kanë ndihmuar në kompenzimin e lërjes së vatanit dhe pasurisë. Ata janë miqtë e njëri tjetrit, pasi që kanë plotësuar besimin dhe janë në kontakt të plotë mes tyre”. (Tefsir Sadi, 2/ 219).

4-“Po, ata që besuan, migruan dhe luftuan për rrugën e All-llahut, dhe ata që strehuan dhe ndimuan, janë besimtarë të vërtetë. Atyre u takon falja (e mëkateve) dhe furnizimi në mënyrë të ndershme. Ndërsa edhe ata që besuan më vonë, e që u shpërngulën dhe luftuan së bashku me ju, janë të njëjtë me ju (në të drejta). ...”. (El-Enfal: 74- 75).

5- “Ata të cilët besuan, migruan dhe luftuan me pasurinë dhe veten e tyre në rrugën e All-llahut, ata kanë pozitë më të lartë te All-llahu dhe vetëm ata janë fatlumë. Zoti i tyre i përgëzon ata me mëshirë nga Ai, me disponim ndaj tyre, me xhenete ku ata do të kenë nimet (hirësi-mirësi) të pandërprerë. Ata aty do të jenë përjetë të pasosur e te All-llahu është shpërblimi i madh”. (Et-Teube: 20- 22).

Ibën Xheriri duke e komentuar këtë ajet thotë: ata që kanë besuar në All-llahun me besim të pastër, janë shpërngulur nga vatani i tyre dhe kanë luftuar idhujtarët për hirë të fesë me pasurinë dhe shpirtin e tyre kanë grada më të larta dhe më të mëdha se sa ata që u japin ujë haxhilerëve dhe që ndërtojnë qaben, përderisa jën idhujtar:. (Xhamiul-Bejan”, 6/ 97).

Sadiu, rahimehull-llah, thotë: “Nuk fiton të kërkuarën dhe nuk shpëton nga e urrejtura vetëm ai që i posedon këto cilësi dhe që i posedon këto vlera”. (“Tefsir Sadi”, 2/ 232).

6-“Ata që migruan për hir të All-llahut, e pasi që u torturuan, atyre gjithsesi do t'u

mundësojmë vendbanim të mirë edhe në këtë botë, po shpërblimi i botës tjetër është edhe më i madh, sikur njerëzit ta dinin (për atë shpërblim)". (En-Nahl: 41).

Ibën Xheriri duke e komentuar këtë ajet mes tjerash tha: "ata do të fitojnë vendbanime të cilat i pëlqejnë dhe të mira. ... Kurse shpërblimi i tyre në ahiret për hixhretin e tyre është edhe më i madh, sepse shpërblim i tyre atje është xhenneti, begatitë e të cilit nuk përfundojnë asnjëherë". ("Xhamiul-Bejan", 8/ 106- 107).

Sadiu, rahimehull-llah, thotë: "Ata që shpërngulen për hirë të All-llahut, largohen nga pasuria dhe familja, duke ikur nga torturat dhe telashet në fe, kanë dy shpërblime, një shpërblim të shpejtë, në këtë botë, që personifikohet në furnizim të bollshëm dhe jetë komode, poqëse kanë edhe dije dhe bindje, te All-llahu, në ahiret kanë shpërblim edhe më të mirë dhe më të bollshëm". (Tefsir Sadi", 3/ 61).

7-"Pastaj Zoti yt, atyre që pasi u torturuan, migruan, mandej luftuan dhe qëndruan, dhe pas të gjitha këtyre vuajtjeve, s'ka dyshim se Zoti yt atyre do t'ua falë dhe do t'i mëshirojë (Ai është që fal, është mëshirues)". (En-Nahl: 110).

Sadiu, rahimehull-llah, duke e komentuar këtë ajet thotë: "Zoti yt, i cili i ka edukuar robërit e Tij të sinqertë me Bujarinë dhe Bamirësinë e Tij është Falës dhe Mëshirues për ata që janë shpërngulur për hirë të All-llahut dhe kanë lërë vendbanimin dhe pasurinë e tij, duke kërkuar kënaqësinë e All-llahut, i cili është sprovuar në fe, për tu kthyer në kufër, ka përqendruar në besim dhe me bindjen që ka pasur ka shpëtuar, pastaj ka luftuar armiqtë e Zotit për ti futur në fe, me dorën dhe gjuhën e tij, ka duruar në këto adhurime, të cilat janë të rënda për shumicën e njerëzve. Këto janë shkaqet më

të mëdhaja, me të cilat fitohen dhuratat më të mëdhaja, e ajo është falja e mëkateve prej Zotit". (Tefsir Sadi", 3/ 87- 88).

8-"E ata që për hir të All-llahut braktisën atdheun e tyre, (e duke luftuar) u vranë ose vdiqën, All-llahu do t'i shpërblejë me shpërblimin më të mirë, e s'ka dyshim, All-llahu është më i miri shpërblues". (El-Haxh: 58).

Sadiu, rahimehull-llah, thotë: "Kjo është myzhde e madhe për ate që ban hixhret në rrugë të Zotit, del nga shtëpia, vatani, fëmijët dhe pasuria duke shpresuar fytyrën e All-llahut dhe për ta ndihmuar fenë e Tij, ky njeri e ka fituar shpërblimin nga Zoti, pa marë parasysht a vdes në shtrat ose vritet në rrugë të Zotit". (Tefsir Sadi", 3/ 332).

9-"Kush shpërngulet për hirë (të fesë së) All-llahut, ai gjen mundësi të madhe dhe begati në tokë. E kush del prej shtëpisë si migrues te All-llahu dhe i dërguari i Tij, dhe e zë vdekja (në rrugë), te All-llahu është shpërblimi i tij. All-llahu është mëshirues, mbulon të metat". (En-Nisa: 100).

Ibën Kethiri, rahimehull-llah, thotë: "Ky ajet stimulon në hixhret dhe nxitë në largim nga idhujtarët dhe se besimtari kudo që shkon do të gjenë hapësirë dhe strehimore". (Tefsir Ibën Kethir", 2/ 344).

Abdur-Rahman Sadiu, rahimehull-llah, thotë: "Ky ajet sqaron nxitjen dhe stimulimin për hixhret, sqaron interesin që gjindet në hixhret, premtoi, Ai që premtimet e Tija përherë janë të vërteta, se ai që shpërngulet për hirë të Kënaqësisë së Zotit se do të gjenë në këtë udhëtim strehim por edhe gjërësi, strehim në çeshtjet e fesë dhe gjërësi në çeshtjet e dynjasë". (Tefsir Sadi", 1/ 393).

10-"All-llahu është i kënaqur me të hershmit e parë prej muhaxhirëve (migruesve) dhe prej ensarëve (vendasve-

ndihmëtarë) dhe prej atyre që i pasuan ata me punë të mira, e edhe ata janë të kënaqur ndaj Tij. Atyre u ka përgatitur xhennete, në të cilët rrjedhin lumenj, ku do të jenë përjetë të pasosur. E ky është fitim i madh". (Et-Teube: 100).

Ibën Kethiri rahimehull-llahu, thotë: "All-llahu subhanehu ve teala, tregon se është i kënaqur me të parët e muhaxhirëve dhe ensarëve dhe atyreve që i pasojnë në mënyrë të mirë duke u treguar se çfarë xhennete u ka përgatitur dhe çfarë begati të përhershme i presin". (Tefsir Ibën Kethir", 4/ 141).

B) Hadithet që flasin për vlerën e hixhretit janë këto:

1- "A nuk e din se Islami rrënon gjërat që ke bërë më parë?! Se hixhreti rrënon gjërat që ke bërë më parë?! Se Haxhi rrënon gjërat që ke bërë më parë?!". (Muslimi).

Imam Nevevi duke e komentuar këtë hadith thotë: "Ky hadith tregon pozitën e madhe që kanë Islami, Hixhreti dhe Haxhi dhe se secili prej tyre i rrënon mëkatet që janë bërë më herët". (Sherhu Muslim", 2/ 497).

2- Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ve sellem, i ka thënë Ebu Fatime Damiriu:

"Bën hixhret, se hixhreti ska rival në shpërblim". (Sahih, Nesaiu).

3- Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ve sellem, ka thënë:

"Le të del imam i njerëzve ai që më mirë dhe më herët lexon Kur'anin, e nëse lexim janë të barabartë, le të del imam ai që më herët ka bërë hixhretin, e nëse në hixhret janë të barabartë, atëherë ai që është më i vjetër". (Muslimi).

4- Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sellem, tregon e thotë:

"Kush i ban këto gjëra, (domethënë hyrjen në Islam, Hixhretin dhe Xhihadin) e

vdes, All-llahu e ka obligim ta futë në xhennet, e nëse vritet, All-llahu e ka obligim ta futë në xhennet, ose fundoset, All-llahu e ka obligim ta futë në xhennet, ose e rëzon deveja, All-llahu e ka obligim ta futë në xhennet". (Sahih, Ahmedi).

5- Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ve sellem, thotë:

"Unë i garantoj shtëpi në mes të xhennetit dhe në brendësi të xhennetit, ati që më ka besuar, ka hyrë në Islam dhe ka bërë hixhret". (sahih, Nesaiu).

6- Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sellem, thotë:

"Ju urdhëroj me pesë gjëra, me të cilat më ka urdhëruar All-llahu: kapuni për xhematin, dëgjoni dhe respektoni, bëni hixhre dhe xhihad në rrugë të Zotit...". (Sahih, Ahmedi).

7- Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sellem, pyet: "A e dini cili është grupi i parë që hyn në xhennet?". Thanë: All-llahu dhe Pejgamberi e dinë. Tha: "Në ditën e Kijametit muhaxhirët vinë te dera e xhennetit dhe kërkojnë që t'ju hapet. Shërbëtorët e xhennetit do të thonë: a jeni llogaritur a? ata do të thonë: për çka të llogaritemi? I kemi pasur shpatat në supet tona deri në vdekje. Do tu hapet dera e xhennetit, e do të pushojnë atje katërdhjet vjet para se të hyjnë njerëzit në xhennet". (Hakimi, sahih sipas kushteve të Buhariut dhe Muslimit, këtë e thotë edhe Dhehebiu).

8- Xhabiri radijall-llahu anhu, tregon se një ditë erdhi te Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sellem, Tufejl ibën Amr ed-Dusiu, e i tha: o i Dërguar i Zotit, a dëshiron fortifikatë të fuqishme dhe mbrojtje? Një fortifikatë që kishin fisi Deus në injorancë. Mirëpo Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sellem, e refuzoi një gjë të tillë, gjë të cilën ua kishte rezervuar All-llahu ensarëve. Kur u

shpërngul Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, në Medinë me te u shpërngul edhe Tufejl ibën Amri, me to u shpërngul edhe një njeri nga fisi i tij. Hyrën në Medinë. Ky njeri u sëmur dhe nuk duroi, mori një shigjetë të sprehur dhe i preu enët e gjakut, derisa edhe vdiq. Tufejl ibën Amri e pa në ëndër në formë të mirë dhe me duar të mbuluara. I tha: çka bëri me ty Zoti yt? Tha: ma fali për shkak të hixhretit tim te Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem". (Muslimi në kapitullin: "Ai që ban vetvrasje nuk ban kufër").

Llojet e hixhretit

Mund ta ndajmë hixhretin në dy lloje:

1- Hixhret shpirtëror:

Që domethënë shpërngulja nga kufri në Islam, nga bidati në sunnet, nga mëkati në adhurim, edhe kjo është rezultat i hixhretit te All-llahu dhe Pejgamberi, sepse hixhreti te All-llahu realizohet me besim në te, me tevhid, me frikë, shpresë dhe dashuri ndaj Tij, me ikje nga shirku i madh e i vogël, largimi nga mëkatet e mëdha dhe të vogla, shpeshtimin e istigfarit dhe pendimit, për ta ripërtërirë hixhretin, çdo herë që i dobësohet ecuria në këtë rrugë. Andaj çelësi i shpëtimit është tevhidi dhe istigfari. Kurse hixhreti te Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, realizohet duke e pasuar Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duke e arbitëruar ate, duke iu referuar atij dhe duke i dhënë përparësi para të gjitha epsheve, mendimeve dhe shijeve dhe duke i refuzuar bidatet dhe shpikjet, të cilat skanë lidhje me Islamin.

2- Hixhreti fizik:

Hixhreti fizik nënkupton:

a) Hixhreti te Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, në Medinë dhe kjo është hixhreti më i ndershëm dhe më i miri.

b) Hixhreti nga shtëpia e kufrit në shtëpinë e Islamit dhe vendimi i këtij hixhreti dallon me dallimin e gjendjes dhe situatës.

c) Hixhreti i mëkatarëve dhe bidatçive duke u larguar prej tyre dhe duke i izoluar në shenjë edukimi të tyre dhe duke e mbrojtur shoqërinë prej tyre.

d) Hixhreti në Sham në kohën e mbramë, kur do të shfaqen telashet dhe sprovat.

Abdull-llah ibën Amri tregon: kam dëgjuar Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duke thënë: "Do të ketë hixhret pas hixhreti, njerëzit më të mirë në ruzullin tokësor është ai që kapet për vendin ku ka bërë hixhret lbrahimi, alejhis-selam, atëherë do të mbeten në ruzullin tokësor njerëzit më të prishur, ata do ti gëlltitë toka e tyre, njerëz të degjeneruar, të cilët All-llahu do ti ringjallë me majmunat dhe derrat". (Hasen, Ebu Davudi).

Hukmi i hixhretit

Hixhreti nga vendi i kufrit në vendin e Islamit dallon me dallimin e gjendjes së njerëzve që qëndrojnë në vendin e kufrit:

a) Mund të jetë obligativ. Për ate që ka mundësi të shpërngulet dhe nëse nuk ka mundësi të publikon fenë e tij atje ose nuk ka mundësi t'i realizojë obligimet e fesë atje. Argument për këtë është ajeti Kur'anor ku All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

"Engjëjt që ua morën shpirtin e atyre që ishin mizorë të vetvetës ju thanë: "Në çka ishit ju? - Ata thanë: "Ne ishim të paaftë në atë tokë!" (engjëjt) ju thanë: "A nuk ishte e gjërë toka e All-llahut e të migronit në të?" (e të praktikoni lirisht fenë e Zotit). Vendi i tyre është xhehennemi dhe sa vend i keq është ai!". (En-Nisa: 97).

Kurse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve

sel-lem, ka thënë: “Unë distancohem nga ai musliman që qëndron në mesin e muslimanëve. Zjari i tyre nuk duhet të shihet”. (hasen, Ebu Davudi).

Kuptimi i hadithit është që muslimani dhe idhujtari nuk duhet të jenë aq afër saqë të shihet zjari i njëri tjetrit. Pasi që kyerja e obligimeve të fesë së tij është obligim, e nëse një obligim nuk kemi mundësi të plotësojmë ndryshe përveç se në një mënyrë të caktuar, atëherë edhe ajo mënyra është obligim.

b) Ky obligim bjer nga ai që është i sëmurë, ose i detyruar, ose i dobët, siç janë gratë e fëmijët. I paafiti, për të nuk ka hixhret, sepse All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

“Përveç atyre që ishin të paafte nga burrat, grat e fëmijët që nuk kishin mundësi të gjenin, as mënyrë, as rrugë (për shpërngulje). Atyre do t’iu falë All-llahu. All-llahu është që shlyen e falë shumë (gabime)”. (En-Nisa: 98- 99).

c) Është e pëlqyeshme për njeriun që ka mundësi të shpërngulet, mirëpo edhe e publikon fenë e tij dhe i kryen obligimet në atë vend të kufrit. Për këtë njeri është e pëlqyeshme shpërngulja që të ketë mundësi ti luftojë ata dhe që ta shumojë numrin e muslimanëve dhe tu ndihmojë atyreve, të ikë nga shtimi i jomuslimanëve, përzierja me ta dhe shikimi i negativiteteve mes tyre. Për këtë njeri nuk është obligim, pasi që ka mundësi të publikojë fenë dhe ti kryej detyrat fetare pa u shpërngulur.

Abasi, axha i Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, qëndroi në Mekë, para se të çlirohej, edhe pse ishte musliman. (shiko: “El-Mugni”, 13/ 151).

Nëse thuhet se çka është rregulli për publikimin e fesë?

Do të përgjigjemi me atë që ka thënë Shejh Muhamed ibën Ibrahim, Alu Shejh:

“publikim i fesë nuk është thjesht vetëm falja e namazit dhe degëve tjera të fesë, ikja nga harami, qoftë kamatë ose ndonjë gjë tjetër, por publikim i fesë domethënë publikim i tevhidit dhe distancim nga gjendja e idhujtarëve, siç është idhujtaria në adhurim e shumë lloje tjera të kufrit dhe devijimit”. (Fetava ve resail semahati shejh Muhamed ibën Ibrahim”, 1/ 91- 92).

Disa dijetarë mendojnë se disa herë është e pëlqyeshme me qëndruar në vendin e kufrit, nëse prej këtij qëndrimi ka dobi Islami ose muslimanët. Autori i librit “Mugnil-Muhtaxh” tregon se hyrja në Islam i Abbasit, radijall-llahu anhu, ka qenë para betejës së Bedrit, mirëpo ai e mbante këtë gjë sekret dhe i shkronte Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ku ia tregonte lajmet e idhujtarëve, kurse në Mekë muslimanët mbroheshin me autoritetin e tij. Ai dëshironte të shkojë te Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem,, kurse ky i tha: qëndrimi yt atje është më mirë”. Pastaj publikoj islamin ditën e çlirimit të Mekës. (shiko: “Mugnil-Muhtaxh”, 4/ 239).

Pa dyshim se kjo nuk vlen për secilin njeri, sepse shumica e njerëzve shumë shpejt binë nën ndikimin e mosbesimtarëve, sidomos në këtë kohë kur mosbesimtarët dominojnë në botë. Në këtë kohë shumica e muslimanëve nxitojnë me të madhe në imitimin e mosbesimtarëve duke jetuar në botën islame, e mos të flasim për ata që jetojnë në mesin e tyre, pa dyshim se sprovimi me ta do të jetë më i madh, kurse vendimet e fesë ngriten mbi të përgjithshmen dhe të zakonshmen e jo në të rrallën dhe përjashtimin.

Pra hixhreti qenka krejtësisht një shkollë në vehte, që duhet kuptuar dhe mësuar prej sajë, e nuk mjaftohet vetëm me festime ceremoniale dhe përkujtime të thata.

E lusim All-llahun e Lartmadhërishëm që të na e mësojë fenë, të na i shtojë veprat e mira, të na mbrojë nga sprovat që i dimë e që nuk i dimë, të na dhurojë sinqeritet në

fjalë e vepra dhe të na bëjë nga banorët e xhennetit, e të na mbrojë nga zjari i xhehenemit.

Bekir Halimi

Publikimi i parë në AlblIslam.Com:

20.2.200

Veprat e njerëzve në ditën e Ashurasë

Nëse analizojmë veprat me të cilët njerëzit veçojnë ditën e ashurasë (10 Muharrem) do të vërejmë llojlojshmërinë e tyre. Disa prej tyre agjërojnë dhe kjo është në pajtim me sunnetin e të Dërguarit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

Një palë prej tyre mundohet që natën e Ashurasë ta ngjall me adhurim, në kohë që grupi i tretë pregadit ushqime të ndryshme, presin kurbane, me një fjalë festojnë. Qëllimi i tyre është shprehja e gëzimit dhe haresë në këtë ditë.

Nga ana tjetër në disa vende të botës shohim ceremoni në të cilat shprehet pikëllimi, brenga si dhe hidhëri. Si zakonisht ata janë pjesë e ceremonive të organizuara nga shi'itët e botës.

Në këtë shqyrtim do të mundohemi që të hedhim dritë në llojet e veprave dhe ligjshmërinë e tyre. Para se gjithash duhet ditur se veprat që të afrojnë tek All-llahu, subhanehu ve teala, kanë dy kushte

1. Pasimi i sunnetit të Resulullahit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

2. Sinqeriteti

Nëse i shqyrtojmë veprat e njerëzve, ditën e Ashurasë, në të kaluarën dhe në kohën prezente do të shohim se ato munden të

ndahen në disa lloje:

a) Vepra që bëjnë pjesë në suazat e ibadeteve që bëhen veçanërisht në këtë ditë siç janë: falja natën e Ashurasë, vizita e varrezave, lëmosha, dhënia e zeqatit ditën e Ashurasë, lëximi i sureve ku përmendet Musa, alejhi selam, në mëngjesin e ditës së Ashurasë. Këto vepra edhe pse të ligjshme (meshru'a) shëndrrohen në risi (bidat) sepse janë veçuar me kohë të cilën nuk e ka caktuar as All-llahu e as i Dërguari i Tij. Po të ishin këto vepra të veçuara për këtë ditë Ligjdhënësi do të kishte nxitur në të siç i ka nxitur në agjërimin ditën e Ashurasë.

b) Veprat që bëjnë pjesë në suazat e traditëve dhe që bëhen me qëllim të festimit në këtë ditë siç janë: larja për këtë ditë, parfymosja, zbukurimi me kuhl (pluhur që përdoret për lyerjen e syve), përgaditja e ushqimit të pasur, therrja e kurbanit, shprehja e gëzimit dhe haresë dhe tjerë. Këto adete (në shumë prej tyre janë infiltruar edhe vepra të shëmtuara që janë në kundërshtim me fenë Islame) në esencë janë kundërveprime me qëllim të mohimit të ceremonive të pikëllimit dhe hidhërimit të manifestuara prej shi'itëve me rastin e ditës në të cilën është vvarë Husejni, radijall-llahu

anhu. Nasibijtë (ata që armiqësojnë familjën e të Dërguarit) i shpikën këto gëzime me qëllim të kundërshtimit të veprave që i bënin shi'itët duke shprehur pikëllimin e tyre. Në këto vepra ka gjëra që nuk kanë të bëjnë asgjë me fenë Islame. Me këtë vepër ata u përngjasuan me çifutët të cilët këtë ditë e konsiderojnë festë. (Iktida Siratil Mustekim 2/129-134)

Të veçuarit e kësaj dite me larje, lyerje të mjekrës me këna dhe syve me kuhl nuk ka asnjë bazë. Ibën Tejmijje, rahimehull-llah, thotë: Gjithë këto vepra janë gënjeshtër të cilat i janë mveshur Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Përpos vlerës së agjërit ditën e Ashurasë, asnjë vepër me vlerë të posaçme nuk ka bazë prej të Dërguarit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. (Minhaxh Es Sunne 7/39)

Nga kjo kuptojmë se All-llahu subhanehu ve tealë, këtë ditë nuk e ka veçuar me asnjë gjë përpos agjërit dhe kjo shihet qartë në sunnetin e të Dërguarit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, për të cilin All-llahu, subhanehu ve tealë, thotë: "Ju e kishit shembullin më të lartë në të dërguarin e All-llahut, kuptohet, ai që shpreson në shpërblimin e All-llahut në botën jetër, ai që atë shpresë e shoqëron duke e përmendur shumë shpesh All-llahun." (Ahzab, 31)

Ata të cilët vetën e angazhojnë me këto vepra sa pak prej sunneteve të Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, praktikojnë?!

Ceremonitë shi'ite:

Sa i përket vendit të cilin në historinë Islame e ze Husejni, radijall-llahu anhu, për këtë nuk ka ndarje tek Ehli Sunneti. Husejni, radijall-llahu anhu, konsiderohet dijetar prej dijetarëve të sahabeve, njëri prej grupës së zgjedhur të tyre në dynja dhe ahiret. I dalluari me fisnikëri, bujari, trimëri... nipi i të Dërguarit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

Ehli Sunneti gjithashtu vrasjen e tij e konsideron vepër të shemtuar dhe ndodhi pikëlluese për çdo musliman. Vrasësit e tij All-llahu, subhanehu ve tealë, i poshtëroi në këtë botë dhe i bëri mësim për ata që erdhën pas tyre. Ata u goditën me sprovë në këtë botë dhe shumë pak prej tyre shpëtuan.

Ajo që duhet bërë kur përmendet vrasja e Husejnit, radijall-llahu anhu, është durimi dhe shprehja e pajtimit me caktimin e All-llahut, duke potencuar se ajo të cilën All-llahu, subhanehu ve tealë, e ka zgjedhur për robin e vet është hajr për të, në dynja dhe ahiret.

Sidoqoftë ajo të cilën shi'itët e bëjnë duke shprehur pikëllimin, hidhërimin, duke dënuar vetën me goditje nuk i ka hije një muslimanit dhe në ato vepime shihet dozë e madhe e aktrimit dhe të efektit artistik. Babai i Husejnit, radijall-llahu anhu, Aliu, radijall-llahu anhu, tek shi'itët ze vendin më të lartë se vendi i Husejnit, por ata me rastin e vdekjes së tij (pas atentatit) nuk organizojnë ceremoni të këtij lloji. Shumë njerëz më të vlefshëm se Husejni, radijall-llahu anhu, kanë vdekur para tij dhe me rastin e vdekjes së tyre nuk janë bërë vepra që u përngajnë veprimeve të tyre në ditën e Ashurasë, në të cilën është vuarë Husejni, radijall-llahu anhu. Shprehja e pikëllimit në këtë mënyrë nuk ka bazë e as lidhje me fenë Islame dhe më shumë i përngjan veprimeve të Ehlul Xhahilijje (ata që jetuan në kohën e injorancës para dërgimit të Muhammedit). (Iktida Siratil Mustekim të Shejhul Islam Ibën Tejmijje 2/129-131)

Ibën Rexhebi, rahimehull-llah, thotë: Ceremonitë e pikëllimit të cilët i praktikojnë Rafidijtë me rastin e vrasjes së Husejnit, radijall-llahu anhu, janë vepra të njerëzve veprimi i të cilëve u asgjësua në jetën e

kësaj bote, e megjithatë ata mendojnë se janë kah bëjnë mirë. As All-llahu e as pejgamberët e tij nuk urdhëruan shpalljen e diteve të zia me rastin e vdekjes së pejgamberëve. Nëse këtë nuk e bënë me rastin e vdekjes së tyre e cila me të drejtë konsiderohet musibet, atëherë ceremonitë e pikëllimit me rastin e vdekjes së atyre që

janë në shkallë më të ultë se ata nuk vjen në konsideratë. (Letaiful Me'arif 113)

Nga faktet e paraqitura shihet së këto gjëra të cilat bëhen nga Rafidijët, prej së afërmi e as prej së largu, në asnjë aspekt nuk lidhen me ndonjë bazë të fesë. Ato më tepër i përkasin veprave që konsiderohen ndryshim i fesë së All-llahut.

Selman ibën Jahja El Maliki

Përshtati: T.Kurtishi

Publikimi i parë në Alblislam.Com:

27.2.2004

Një metodë analizimi të teksteve

Gjatë leximit të librit "Libri i Teuhidit", të dijetarit të madh Muhammed Ibën Abdulvehab-it, rahimehull-llah, vërejtja diçka interesante. Shejhu, All-llahu e mëshiroftë, në çdo kapitull të librit të tij së pari i paraqet argumentet që kanë të bëjnë me kapitullin në fjalë, e pastaj në pika (1,2,3 ..) i paraqet dobitë që nxiren nga argumentet e cituara.

Ndoshta kjo gjë në shikim të parë nuk paraqet diçka, mirëpo kjo metodë nëse analizohet, do të përfundojmë se e nxitë lexuesin që ajetet dhe hadithet t'i analizojë mirë, e mos t'i lexojë vetëm kalimthi, e kjo është ajo dobi e madhe që e përfitova nga ky libër i begatshëm, e për të cilën gjë do flas në vijim.

Duke e lutur All-llahun që veprat tona t'i bën të sigjerta për hirë të Fytyrës së Tij dhe të na jep sukses dhe bereqet në to, themi:

Leximi dhe shprehia e leximit janë gjëra bazë në zgjerimin e diapazoneve të diturisë dhe kulturës sonë.

Jorastësisht All-llahu, azze ve xhel-le,

ajetin e parë që e zbriti ishte: "Lexo! Me emrin e Zotit tënd i cili krijoi.".

Mirëpo, ajo që ndodhë në të shumtën e rasteve, është se ne lexojmë në mënyrë mekanike, duke mos u përqëndruar dhe duke mos e analizuar atë që e lexojmë, e si rezultat i kësaj shumë pak përfitojmë nga ajo që e lexojmë.

Duhet ditur se shumë më mirë është të lexojmë pak dhe të përfitojmë shumë sesa të lexojmë shumë e të përfitojmë pak.

Ibën Uthejmini, rahimehull-llah, duke e këshilluar djalin e tij, mes tjerash i thotë: "Kujdesu ta memorizosh Kur'anin e Madhëruar dhe për çdo ditë lexo diçka të caktuar nga Kur'ani, mirëpo lexim me meditim dhe kuptim, e nëse të kujtohet ndonjë dobi gjatë leximit, regjistroje në fletore."

Nisur nga kjo që thamë, nëse duam të përfitojmë më shumë nga ajo që e lexojmë, duhet që të kemi një fletore në të cilën do t'i shkruajmë dobitë e caktuara që i kemi

nxjerrë si rezultat i analizimit të atij teksti.

Ndoshta dikush do të pyet: E pse t'i shkruajmë ato? Përgjigja është: Për shkaqe të shumta, prej tyre:

1. Me anë të shkrimit mund t'i përmbledhim mendimet dhe të koncentrohemi më shumë.

2. Shkrimi na ndihmon që ta memorizojmë më mirë çështjen në fjalë.

3. Shkrimi na ndihmon që atë fjali ta kemi të rruajtur më mirë, kështu që do ta lexojmë disa herë dhe nuk do ta harojmë.

4. Disa herë njeriu është më i disponuar për të shkruar dhe më i kthjellët për të analizuar, andaj këto raste nuk duhet lënë pa i shfrytëzuar. Ai që ka shkruajtur, do të vëren se kur pas një kohe ta lexon atë që e shkruajtur më herët, do t'i ndodhë që të thotë: Wow, a thua vallë unë e kam shkruajtur këtë gjë?

5. Me kalimin e kohës gjërat harohen, sidomos nëse nuk përsëriten, andaj është e nevojshme që të shkruhen, gjë që do të na mundëson t'i përsëritim.

Për ta bërë më të qartë atë që e thamë po e japim një shembull:

Transmeton Imam Ahmedi, rahimehull-llah, me sened të vërtetë se Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Secila vepër ka fazën e gjallërisë, kurse çdo fazë e tillë ka pushimin. Andaj kush e ka pushimin në sunnetin tim, ka shpëtuar, kurse kush e ka pushimin në ndonjë gjë tjetër, është shkatërruar."

Personi i cili e lexon këtë hadith kalimthi, do ta lexojë një herë, pa e analizuar mirë dhe pas një kohë të shkurtër do ta harojë.

Kurse personi i cili e lexon si duhet këtë hadith, do ta lexoj dy-tri herë, do ta analizojë mirë, do ta kapë lapsin e tij, si dhe fletoren e tij të caktuar dhe do të shkruan:

"Dobitë që i nxjerim nga ky hadith:

1. Ado vepër i ka dy faza: fazën e aktivitetit, gjallërisë dhe intenzivitetit si dhe fazën e ngadalsisë, uljes së intenzitetit dhe pushimit.

2. Nxitja në shfrytëzimin maksimal të kohës, sa që edhe pushimi të sjellë diçka të dobishme, e assesi të dëmshme.

3. Fakti se mund të ketë pushim, assesi nuk d.t.th. që të jetë në gjëra të ndaluara dhe të kota, sepse veprimi i tyre nuk arsyetohet në asnjë rast.

4. Pas të vërtetës ska tjetër pos të kotës, e pas sunnetit ska tjetër pos mëkatit dhe bidatit, gjëra këto të cilat të shkatërrojnë.

5. E tërë jeta e besimtarit duhet të jetë në përputhshmëri me shariatit e All-llahut dhe me sunnetin e të Dërguarit të Tij fisnik, sepse në të kundërtën vjen shkatërrimi.

6. Metoda fisnike dhe e urtë që ka përdorur Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, gjatë të folurit, ku e ka theksuar, ngritur dhe vlerësuar të mirën, kurse të keqen e ka nënçmuar dhe poshtëruar. Kjo kuptohet nëse analizohen këto dy fjali:

- "...kush e ka pushimin në sunnetin tim, ka shpëtuar, kurse kush e ka pushimin në ndonjë gjë tjetër, është shkatërruar."

- "...kush bën hixhret për All-llahun dhe të Dërguarin e Tij, hixhreti i tij është për All-llahun dhe të Dërguarin e Tij. E kush bën hixhret për të përfituar të mira të kësaj bote, ose që të martohet me ndonjë grua, hixhreti i tij është për atë që e ka bërë."

Në rastin e parë i potencon dy herë të njejtat fjalë "për All-llahun dhe të Dërguarin e Tij", si respekt dhe madhërim, kurse në rastin e dytë tha "për atë që e ka bërë", e nuk e përmendi përsëri, si poshtërim dhe nënçmim për atë vepër.

7. Poashtu nga ky hadith nxiret një dobi që thirrësi (daiu) duhet ta përdorë gjatë daves së tij, e ajo është: "Tregimi i pasojave

të mira apo të këqija që vijnë si rezultat i veprimit apo mosveprimit të asaj vepre, të cilën dau i urdhëron apo e ndalon”, sepse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kështu veproi. Kjo në këtë rast është në mënyrë të përgjithshme, kurse në raste tjera ai, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, pasojat i tregon në mënyrë të detajizuar. Këtë metodë do ta vërejtsh gjatë leximit të Kuranit fisnik dhe haditheve.”

Mirëpo gjatë këtij procesi duhet t'i kemi parasysh këto gjëra:

1. Njeriu nxjer dobi nga një ajet apo hadith i caktuar, aq sa ka dituri, devotshmëri dhe mendjemprehtësi.

2. Kjo metodë të shërben për t'i memorizuar gjërat më mirë, për ta shtuar diturinë dhe për t'i përmbledhur dhe ruajtur mendimet tua, e assesi nuk të jep të drejtë të japësh fetva duke u bazuar në dobitë që i

ke nxjerë, përveçse nëse e ke arritur atë gradë. Si dhe nuk të jep të drejtë të bësh ixhtihad, përveçse nëse je muxhtehid për atë lëmi.

3. Dobitë që nxiren duhet të jenë në përputhshmëri me Kuranin, Sunetin dhe metodën e Selefus-salih, andaj të rekomandoj që nëse ke paqartësi të konsultohesh me ndonjë hoxhë të Ehli-Sunnetit, i cili do ta sqaron atë gjë.

4. Nëse i lexon librat e ehli-sunetit do të shohësh se fjalët e cekura para dhe pas ajetit apo hadithit të cituar do të ndihmojnë dhe do ta japin kahjen e duhur në nxjerjen e dobive nga ai tekst.

Në fund e lusim All-llahun, tebareke ve teala, që veprat tona t'i bën të sinqerta dhe të na mundëson që atë që e dimë dhe që e themi, edhe ta praktikojmë. Amin.

Omer Islami
21.1.2005

Rija-Syefaqsia

Sinqeriteti është zemra e çdo adhurimi dhe çelës i thirrjes së të gjithë pejgamberëve. Pastaj, ai është kusht i pranimit të veprave. Njëra nga veprat e zemrës e cila e trazon këtë sinqeritet dhe adhurimin e besimtarit e shëndron në pluhur është rijaja ose syefaqsia, hipokrizia. Me fjalë të tjera, shumë muslimanë, me mëshirën e Allahut, ia arrijnë t'a mposhtin shejtani i cili ua tërheq vëmendjen nga adhurimi në Allahun e Lartësuar, andaj Allahut i bien në sexhde, agjërojnë, japin zekat dhe sadaka, kryejnë haxh, mirëpo shejtani iu

afrohet kah nuk shpresojnë i cili në zemrat e tyre mbjell farë të hipokrizisë e cila ua shkatërron tërë mundin e tyre gjatë adhurimeve. Kur Allahu i Lartësuar thotë: " E duke qenë se ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër, pos që ta adhuronin All-llahun me një adhurim të sinqertë ndaj Tij, që të largohen prej çdo besimi të kotë, ta falin namazin, të japin zeqatin, se ajo është feja e drejtë.." (Bejjine 5), Allahu urdhëron në sinqeritet, e pastaj në adhurim, kryerje të namazit e cili është mënyra më e zgjedhur e adhurimit të cilën mund t'a kryej trupi, dhe dhënie të zekatit,

i cili është adhurim me pasuri. Allahu i paralajmëron besimtarët në atë që ua shkatërron veprat e mira, andaj i Lartësuri thotë: 'O ju që besuat, mos i prishni lëmoshat tuaja me të krenuar e me ofendim siç bën ai që e jep pasurinë e vet sa par sy e faqe të njerëzve, e nuk e beson All-llahun dhe as botën tjetër. Shembulli i tij është si një gur i madh e i lëmuar që mbi të ka pak dhe, e kur e godet atë një shi i madh e lë të zhveshur (lakuriq). Ata (formalistët) nuk arrijnë asgjë nga ajo që punuan. All-llahu nuk udhëzon popullin jobesimtar.'" (Bekare 264). Për shembullin e hipokritëve dhe shpirtërave të tyre Ibën Kethiri thotë: "do të thotë se e lë të lëmuar dhe të thatë, pa kurrfarë dheu e cila ka qenë aty. Gjithashtu edhe veprat e hipokritëve të cilët shtiren, zhduken dhe humben te Allahu, ngase veprat e tyre të cilat i kanë parë njerëzit janë sikurse ajo tokë". Pastaj Resuli, sallallahu 'alejhi ue sellem, në hadithin kudsij: "Allahu i Lartësuar ka thënë: 'Unë jam pjesëmarrësi më i pavarur në bashkëpjesëmarrje, andaj vepra e të cilit bëhet për Mua dhe për dikë tjetër, Unë do t'ia lë atij tjetrit '" (Muslimi). Do të thotë se Allahu nuk i pranon veprat e atyre të cilët gjatë adhurimit i bëjnë shirk. Që hipokrizia i shkatërron vetëm veprat do të ishte arsye e majftueshme që zemrat tona t'i ruajmë nga kjo sëmundje, mirëpo ky nuk është dënim vetëm për hipokritët. I Lartësuari thotë: 'Pra shkatërrim është për ata që falen, të cilët ndaj namazit të tyre janë të pakujdesshëm. Ata që vetëm shtiren (sa për sy e faqe)" (Maun 4-6) Subhanallah, Allahu i Lartësuar u kërcënohet atyre që falen dhe të cilët Atij i bien në sexhde, e atëherë si do të jetë për ata të cilët nuk

falen fare. Nga Sad ibën Vekkasi radijallahu anhu transmerohet se ka thënë: "E kam pyetur Resulullahun sallallahu 'alejhi ve sellem, se kush janë ata të cilët janë të pakujdesshëm ndaj namazit të tyre?, ku tha 'Ata janë të cilët nuk e kryejnë namazin në kohë.'" Pastaj i Lartësuari iu kërcënohet përsëri atyre që falen, atyre të cilët shtiren. Imam Ahmedi transmeton nga Abdullah ibën Amri se Resulullahu sallallahu 'alejhi ve sellem ka thënë: "Kush iu flet njerëzve për veprat e tij, (d.m.th. lavdërohet) Allahu do t'a zvogëloj dhe do të bëjë që do t'a urrejnë në sytë e njerëzve." Ajeti qartë udhëzon që përveç shkatërrimit të hipokritëve ata i prët edhe dënimi i ashpër. Se sa është i rrezikshëm në kërkimin e dije flet edhe hadithi në radhë. Ebu Hurejre nga Resulullahu sallallahu 'alejhi ue sellem transmeton të ketë thënë: "Kush fiton dije me të cilën dëshirohet Fytyra e Allahut të Lartësuar, vetëm për pasuri të kësaj bote, në Ditën e Gjykimit nuk do t'i marr erë Xhenetit." (Ebu Davudi me zinxhir të vërtetë). Se sa është e rrezikshme dhe dëmshme shtirja në vepra, flet edhe ajo që Pejgamberi sallallahu 'alejhi ue sellem ka thënë se ajo për të cilën frikohet më shumti për Ummetin e tij është rijaja. Pejgamberi sallallahu 'alejhi ue sellem ka thënë: "Ajo për të cilën frikohem më së shumti për ju është shirku i vogël." E pyetën: "O i Dërguar i Allahut, çka është shirku i vogël? "Ka thënë: Rijaja, syfaqësia. Allahu të tillëve në Ditën kur do t'i shpërblej robërit e Tij për veprat e tyre, do t'u thotë: "Shkoni te ata para të cilëve jeni shtirë në dunjallëk, e shihni se a mos do të merrni shpërblim te ata." (Ahmedi, Ibën Hibani, Albani thotë se është sahih). Të gjithëve na është i njohur

hadithi për tre personat me të cilët Allahu i Lartësuar do të nderz zjarrin e Xhehenemit, për shehidin, dijetarin dhe sadakadhënësin. Muxhahidi i cili ka luftuar që njerëzit t'i thojnë se është trim, dijetarin i cili ka mësuar që njerëzit t'i thojnë i ditur dhe që lexon shumë Kur'an, dhe sadakadhënësinë i cili e ka shpërndarë pasurinë në mënyrë që njerëzit t'i thojnë se si është dorëdhënës. Pastaj Allahu do të urdhëroj që të hidhen në Xhehenem me kokë të poshtë. Nga Xhundub ibën Abdullahu radijallahu anhu transmetohet se Resulullahu sallallahu 'alejhi ve sellem ka thënë: "Ai i cili nga syfaqësia veprat e tij i shfaq veprat para njerëzve, Allah do t'a turpëroj në Ditën e Gjykimit, e ai i cili veprat e tij i shfaq veprat para njerëzve për t'u madhëruar e për të qenë i nderuar para njerëzve, Allahu do t'a tregoj dhe do t'ia zbuloj fshehtësinë e tij para njerëzve." (Buhariu dhe Muslimi)

Çka është në të vërtetë, syfaqësia dhe në çka manifestohet ajo? Rijaja - syfaqësia, hipokrizia rrjedh nga fjala ru'jetu – që do të thotë të parët ose të shikuarit. Andaj rija në esencë do të thotë që të tjerëve t'u tregohesh në cilësi pozitive dhe të shtiresh si diç tjetër me qëllim të përfitimit të simpatisë së tyre apo të mendimit të lartë për të. Syfaqësia është disa llojesh, por hipokrizia në fe shfaqet në pesë gjëra:

1. Në trup – ashtu që hipokriti e shfaq dobësinë ose zbetësinë e tij, duke e paraqitur atë si pasojë e lodhjes nga adhurimi dhe frika nga bota tjetër etj. Kjo është e paraqitur posaçërisht te sufinjtë.

2. Hipokrizia në pamje dhe veshje. Ajo manifestohet në theksimin dhe të shprehurit e qëllimshëm të vjetërsimit të

rrobave, flokëve të pakrehura, uljes së kokës gjatë ecjes, lënies së gjurmëve të sexhdes në fytyrë etj, krejt kjo që të tjerët të vërenin këtë.

3. Hipokrizia në të folur – manifestohet në shtirjen para njerëzve të devotshme, këshillimin, tërheqjen e vëmendjes, citimin e thënieve të urta, në mënyrë që para njerëzve të tregohet pseudodevotshmëria dhe dhënia pas adhurimit dhe të së mirës.

4. Hipokrizia në adhurime (rite) – për shembull, në namaz me zgjatje të qëllimshme të qëndrimit në këmbë, përkuljes, sexhdes, leximit të Kur'anit me zë të zbukuruar, e tërë kjo nëse na shikojnë të tjerët.

5. Hipokrizia në raport me njerëzit tjerë – manifestohet në atë që një person për shembull zgjedh se kë do t'a thërras në vizitë, për shembull ndonjë personalitet të njohur ose të ditur, mirëpo jo me qëllim që të ketë dobi nga dija e tij por për t'u flitur se filani e filani kanë qenë te ai.

Duhet treguar disa rregulla te ruajtja nga syfaqësia dhe në përpjekjen e arritjes së sinqeritetit të plotë në vepra. Para se gjithash duhet ditur:

1. Se është shumë vështirë të arrihet sinqeritet i plotë në vepra, ngase njeriu sipas natyrës së vet është i dhënë pas dunjallëkut dhe anon kah ajo. Pastaj njeriu harron shumë, e kur të dijmë se është ashtu, atëherë është shumë vështirë të paramendojmë që njeriu mund të arrij sinqeritet të plotë përveç ai të cilin Allahu e udhëzon dhe e ndihmon. Ngase, le të pyesim vetën se cili prej nesh hanë ushqimin jo pse e pëlqen atë por pse don që të ndihmohet me atë që të adhurohet Allahu, ose cili prej nesh fle jo pse është mirë të flihet por për të pushuar që t'a

adhurojmë Allahun. Andaj është e jona që, nëse ndodh që në veprat tona përzihet syfaqësia, të mos pikëllohemi e të mos e humbim shpresën, por t'a përmirësojmë atë dhe të përpiqemi t'a mënjanojmë syfaqësinë dhe hipokrizinë (dyfytërsinë).

2. Asnjëherë të mos e lëmë një vepër të mirë nga frika nga përzjerja e qëllimit me syfaqësi. Ebu Talib Mekki ka thënë: "Nuk lihet vepra e mirë nga frika e depërtimit të syfaqësisë në të, ngase ky është synimi i armikut tonë, porse njeriu duhet të qëndrojë në qëllimin fillestar, e nëse ndodh që gjatë adhurimit të vie te syfaqësia, ai duhet t'a largojë e t'a mënjanojë atë. Gjithashtu nuk lihet vepra e mirë për shkak të krijesave duke u turpëruar nga ata dhe duke e urrejtur atë që ata të konsiderojnë ty më të vlefshëm, ngase kryerja e veprave për hirë të njerëzve është shirk, e lënia e veprave për hirë të njerëzve është rija - syfaqësi. Lënia e veprës nga frika e depërtimit të syfaqësisë është injorancë, ndërsa lënia e veprës kur në të depërton syfaqësia është dobësia, ngase ai që hyn, do të thotë e nis një vepër për hirë të Allahut, me qëllim të sinqertë, dhe nga ajo vepër del me qëllimin (nijetin) e njëjtë, nuk do t'i bëjë dëm ajo që ka qenë ndërmjet, nëse gjatë asaj vepre është paraqitur rijaja, por në fund e ka larguar atë. Shembull se si njeriu t'a largojë rijanë. Dikush e përmend haxhin, e ju pyet se sa herë e keni kryer haxhin, e ne themi tri herë. Masha'Allah, i lumi ti. Këtë njeriu duhet menjëherë t'a hedh, ngase nëse na kaplon mendjemadhësia, kryelartësia ose syfaqësia, mundemi për një çast t'i humbim të gjitha veprat. Duhet treguar se Allahu pranon, ngase sa e sa njerëz e kryejnë haxhin, ndërsa nga haxhi i tyre

nuk mbetet asgjë përveç lodhjes dhe djersitjes, kur Allahu të pranonte nga ne ndërsa përsëri ne nuk e dijme këtë.

3. Nijeti mund të përmirësohet nëse ndodh që të prishet ose ndryshohet. Shumë njerëz mendojnë që nëse nijeti në vepër prishet, atëherë atë vepër duhet ndërprerë edhe braktisur. Mirëpo është e vërtetë që qëllimi mund të përmisohet dhe mund të shtohet me vepër në veprën e njëjtë pa ndërprerje dhe barktisje. Ka shumë shembuj të të parëve tanë të mirë të cilët kanë kërkuar dije ose kanë bërë vepra të mira pa nijet të plotë, e pastaj e përkujtonin e i ktheheshin Allahut të Lartësuar dhe e përmisonin nijetin e tyre e pastaj e vazhdonin kërkimin e dijese. Imam Dhehebiu thotë: "Të parët tanë të mirë kërkonin dije për hirë të Allahut, andaj janë bërë udhëheqës pas të cilëve shkon populli. Ndërsa disa nga ata kërkonin dije, mirëpo jo për hirë të Allahut, e kur e kanë fituar dijen e kanë rishqyrtuar veten, e dija i ka shpjer në sinqeritet, sikurse thotë Muxhahidi: "Kërkonim këtë dije, e nuk kishim nijet të madh për të, ndërsa Allahu na ka pajisur me nijet më vonë."

4. Ajo çka e përzien (turbullon) nijetin ka hise në shpërblim, ashtu që e zvogëlon e nuk e shkatërron veprën në përgjithësi. Kështu nëse personi me atë vepër e ka për qëllim Fytërsinë e Lartësuar të Allahut dhe është i sinqertë në këtë, mirëpo ky sinqeritet përzihet me dëshirën (etjen) për dobi të kësaj dunjaje ose për kënaqjen e epshit, shpërblimi për atë vepër nuk do të humb nga mëshira dhe mirësia e Allahut, mirëpo do të zvogëlojë shpërblimin e asaj vepre për aq sa ka pjesëmarrje (hise) në nijet.

5. Është e lejuar të tregohen disa vepra

të mira, mirëpo me qëllim të mirë. Meqenëse esenca e veprave të mira është se ato duhet të fshihen, sikurse ka ardhur në hadithin e njohur për shtatë personat të cilët Allahu do t'i strehojë në hijen e Tij ne ditën kur nuk ka hije tjetër përveç hijes së Tij, ku është thënë: "Edhe njeriu i cili jap sadaka ashtu që dora e tij e majtë nuk e din se sa ka dhënë e djaththa". Për këtë baza është që veprat, nëse është e mundshme nuk tregohen, ose nëse është vepër e tillë që nuk mund të fshihen, sikurse namazi me xhemat, haxhi etj, atëherë këtu s'ka pengesë. Sa i përket veprave tjera të cilat fshihen dhe nuk shfaqen para tjerëve, mund të tregohen por me dy kushte: 1. Nëse personi është i sigurt nga rijaja, hipokrizia, dhe 2. Nëse në atë ka dobi për fenë tonë, e cila mund të arrihet nëse tregohet vepra jonë e mirë, për shembull sikurse iu ka thënë Sufjan ibën Harith, i cili ka qenë djali i axhës së Resulullahut sallallahu 'alejhi ue sellem, familjes së tij para vdekjes: "Mos qani për mua, ngase nuk kam bërë asnjë mëkat prej se e kam pranuar islamin."

Si mund të shërohet besimtari dhe ta ruaj zemrën e tij nga syfaqësia dhe si ta arrijë sinqeritetin.

Tani pasi që e kemi parë rrezikun e syfaqësisë edhe kur e kemi parë se sa është kjo vepër te Allahu e urrëjtur, duhet të mësojmë se si mbrohet zemra nga syfaqësia, si të ruhet sinqeriteti dhe si të shërohet zemra e sëmurë nga rijaja. Dijetarët theksojnë disa mënyra të mbrojtjes nga rijaja:

1. Duaja (lutja) dhe të strehuarit te Allahu i Lartësuar i cili është i vetmi i cili ka mundësi të na mbrojë nga çfarëdo belaje, domethënë lutja drejtuar Atij që

zemrat tona t'i mbrojë nga kjo sëmundje e cila i shkatërron veprat.

2. Dija – që besimtari dhe besimtarja të dijnë se sa është rreziku i syfaqësisë, cilat janë pasojat e saj, si i afrohet shejtani njeriut, vlera e sinqeritetit etj, në mënyrë që të pajisemi me dije përmes së cilës njeriu i dallon kurthat e shejtanit.

3. Lufta – njeriu duhet të luftojë dhe vazhdimisht të rishqyrtojë njetin e tij, që nëse vëren syfaqësi, menjëherë ta mënjanojë atë. Andaj është e nevojshme lufta me shpirtin (nepsin, egon) e tij i cili është i prirur kah epsheet dhe hipokrizia.

4. Shoqërimi me njerëz të mirë e të devotshëm, ngase kjo do të ndikojë te personi që ta dojë sinqeritetin dhe të përpiqet që të kryej vepra me sinqeritet dhe të fitojë cilësi të atyre të cilët janë të sinqertë. Pastaj do t'a mwsojw pwr përpkjekjet, durimin dhe luftën e tyre kundër rijasë.

5. Leximi i jetëshkrimeve të paraardhësve dhe dijetarëve tanë të devotshëm, ngase nuk ka asgjë më të dobishme pas leximit të Kuranit dhe hadithit, pastaj të ndihmës e udhëzimit të Allahut, sesa leximi i jetëshkrimeve të tyre, të fjalëve dhe luftës së tyre.

6. Dijetarët te shërimi i syfaqësisë përmendin prerjen e syfaqësisë në rrënjë, ndërsa rrënjët e hipokritëve dhe iniciatorë kryesor janë tri gjëra: 1. Animi i kënaqësisë në lavdërim, 2. Përpkjka e largimit të dhembjes të të urrëjturit te njerëzit dhe 3. Lakmia për përmbushjen e interesave personale te njerëzit tjerë. Këtë sëmundje njeriu do t'a shërojë me njohjen e dëmit të saj, me të vërejturit që ajo e pengon pastërtinë e zemrës, pamundëson arritjen e suksesit, lumturisë dhe pozitës së lartë te Allahu në botën

tjetër. Andaj kur njeriu të mendojë dhe krahasojë pasojat e hipokrizisë dhe arritjes së famës në dunja me humbjen e shpërblimit për vepra të mira në botën tjetër, atëherë është më lehtë që t'i kundërvihet, kësaj sëmundjeje, sikurse ai i cili e di që mjalta është e ëmbël mirëpo nuk e provon nëse është i vetëdijshëm që në të është i vendosur helm.

7. Që njeriu gjatë kryerjes së adhurimit, për shembull namazit e shmang të shtirurit. Mirëpo si t'a bëjë atë kur shejtani nuk e lë askë e të mos i përshpërisë "zbukoroje, të tjerët të shikojnë, ata do të shohin se je i devotshëm", vetes duhet thënë: "e çka kam nga ajo që ata e dijnë apo nuk e dijnë për adhurimin tim, është me rëndësi që për adhurimin tim din vetëm Allah i Lartësuar, e çfarë dobie kam nëse për të dijnë edhe njerëzit tjerë".

Pastaj duhet treguar se në rija nuk hyn edhe kur dikush e bënë një vepër të mirë për hirë të Allahut e të tjerët e marrin vesh këtë, e këtij që e ka bërë atë vepër i vjen mirë. Ibën Kethiri thotë: "Duhet

shtuar se në rija – syfaqësi nuk hyn edhe kur dikush e bënë një vepër të mirë në emër të Allahut s.u.t., pastaj atë e marrin vesh njerëzit, e atij që bënë i vie mirë. Dëshmi për këtë janë fjalët e Ebu Hurejres të cilat i shënon Hafidh Ebu Ja'la në Musned: "Kam hyrë në mesxhid e ka hyrë një njeri e më ka ardhur mirë. Atë ia kam përmendur Pejgamberit sallallahu 'alejhi ue sellem, e më ka thënë: 'Të janë vërtetuar dy shpërblime, e fshehta dhe e dukshmja.'" Në këtë tregon edhe hadithi të cilin e transmeton Ebu Dherri radijallahu anhu: "E kanë pyetur Resulullahun sallallahu 'alejhi ue sellem: 'Aka nëse njeriu bënë një vepër të mirë, e njerëzit e lavdërojnë për këtë?', e është përgjegjur: 'Kjo është lumturia e besimtarit e kësaj dunjaje.'" (Muslimi).

Aliu radijallahu anhu ka thënë: "Atë që shtirët do t'a njohesh me katër shenja: 1. është dembel kur është vetëm 2. është i vyeshëm kur është në prani të njerëzve 3. I shton veprat kur të lavdërohet 4. E kur e kritikojnë i zvogëlon ato.

Përgaditi: Selmir Haxhiq
Përktheu: Ebu Eljesa
28.1.2005

Objektivat e ligjit islam

(objektivat e Sheriatit, MEKASIDUSH-SHERIATI)

Ligji islam është në dobi të njerëzve

"Ne të dërguam ty (Muhammed) si mëshirë për të gjitha krijesat." (Kur'an:

El-Enbija, 107)

Se Pejgamberi i Zotit është dërguar mëshirë për njerëzimin, do të thotë se ai është dërguar me udhëzimin i cili me të vërtetë është në dobi të njerëzve. "Udhëzimi" e "mëshira" është sjellje e asaj që është e dobishme për njerëzit dhe

largim i së dëmshmes nga ata, dhe pikërisht ky është interesi i përgjithshëm dhe i përbashkët i njerëzimit. Vlerësimi absolut i një sendi si i mirë apo i keq/i dobishëm apo i dëmshëm i takon vetëm Sheriatit – Ligjit të Zotit, ngase të vërtetën e plotë për njeriun dhe për atë se ku qëndron e mira e dobishme për të nuk e di askush përveç Krijuesit dhe Zotit të njeriut. Dhe poqë se kjo detyrë do t'i lihej njeriut, do të hasnim në lloj-llojshmëri të ideve kundërtëhënëse të varura nga kultura, nga niveli intelektual, nga shoqëria, nga koha dhe nga individi. Së këndejmi e mira dhe e keqja do të “merrnin” karakter konvencional, ashtu siç argumentonin sofistët.

“Besimi përbëhet nga shtatëdhjetë e disa degë, më e larta e të cilave është Nuk ka zot përveç All-llahut (La ilahe illallah) dhe më e ulëta largimi i një pengese nga rruga.” (Pejgamberi Muhammed, paqja qoftë mbi të)

Nga kjo thënie kuptojmë se besimi është kryerja e të gjitha punëve të mira dhe të dobishme, të vogla qofshin apo të mëdha. Vërejmë se Pejgamberi në këtë hadith ka përkufizuar dhe shpjeguar konceptin e besimit duke lidhë dy skaje: besimin dhe adhurimin e Zotit nga njëra anë dhe largimin e pengesave nga rruga nga ana tjetër.

Ekzistojnë edhe shumë e shumë dëshmi nga tekstet islamike se Ligji islam – Sheriati jep parametrat e një jete kualitative me të cilën realizohen interesat më të larta dhe arrihet mirëqenia më e lartë e mundshme për njeriun në këtë botë dhe në të ardhmen. Ja disa prej tyre:

“All-llahu urdhëron drejtësi, bamirësi, ndihmë të afërmve, e ndalon nga imoraliteti, nga e neveritura dhe dhuna.”

(Kur'an: En-Nahl, 90)

“O ju që besuat, përgjigjuni All-llahut dhe të dërguarit kur ju ftojnë në atë që ju jep jetë” (Kur'an: El-Enfal, 24)

“All-llahu dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju.” (Kur'an: El-Bekare, 185)

“Ai është që krijoi vdekjen dhe jetën, për t'ju provuar se cili prej jush bën vepër më të mirë.” (Kur'an: El-Mulk, 2)

“O ju të zotët e mendjes! Në masat e dënimit ka jetë për ju, ashtu që të ruheni (nga krimi dhe zullumi).” (Kur'an: El-Bekare, 179)

“Të pyesin ty për verën dhe bixhozin. Thuaj: “Që të dya janë mëkat i madh, e ka edhe dobi në to për njerëz, por dëmi i tyre është më i madh se dobia e tyre.” (Kur'an: El-Bekare, 219)

“Për çdo nyjë në trupin e tij njeriu duhet të japë lëmoshë (sadaka). Ado ditë në të cilën njeriu vendos drejtësi në mes të dy njerëzve është lëmoshë. Ndihma që i ipet tjetrit për të hipur mbi kafshën e tij apo për t'i ngarkuar plaçkat mbi kafshë është lëmoshë. Fjala e mirë është lëmoshë. Ado hap që qet njeriu kur të shkojë për t'u falur është lëmoshë. Largimi i pengesave nga rruga është lëmoshë.” (hadith)

“Nuk lejohet t'i shkaktohet dëm askujt, por as nuk lejohet të kthehet e keqja me të keqe (dëmi me dëm).” (hadith)

Dëshmi tjetër për këtë është se Ligji islam respekton dhe pranon të gjitha traditat dhe zakonet e mira të individëve dhe grupeve shoqërore të cilat nuk kundërshtojnë shpirtin e Sheriatit. Ekzistojnë shumë adete të arabëve në kohën e Pejgamberit Muhammed të cilat Ligji i Sheriatit i ka mirartuar dhe lavdëruar, si për shembull, pagesa e një

shume të caktuar të parave me rastin e vrasjes apo plagosjes së personit tjetër, ngjashmëria (shoqërore, ekonomike etj.) e çiftit që don të lidhë martesë, ortakëria në biznes, mbulimi i Qabesë me pëlhurë e të tjera.

Edhe një argument logjik: duke u nisur nga atributi i Zotit se Ai është i Urtë, ligji që rrjedh nga Ai duhet të jetë i dobishëm dhe në interes të njerëzve. Zoti ka çuar pejgamberë ndër njerëzit në kohë të ndryshme të historisë dhe kështu Ai ka manifestuar mëshirën, dhembshurinë dhe bamirësinë e Tij për njerëzit, në mënyrë që t'i udhëzojë ata në rrugë të drejtë që të jetojnë në mirëqenie në këtë botë dhe në të ardhmen.

Pikësynimet e ligjit islam - shariatit

Sheriati është ligji të cilin Zoti e shpalli dhe e qartësoi për njerëzit. Burimi i këtij ligji të Tij pra, është shpallja nga Zoti, e cila përfaqësohet në Kur'an, si fjalë e Zotit, dhe në Sunneh apo Hadith të të Dërguarit të Tij, si fjalët, veprat dhe miratimet e Tij. Ai mbron interesat e njerëzve dhe realizon ato në mënyrën më të përsosur që është e mundur. Ibën Tejmije thotë: "Ligji islam ka ardhur të realizojë ato që janë të dobishme për njeriun në mënyrë sa më të plotë dhe t'i ndërpresë apo t'i pakësojë e zvogëlojë të dëmshmet." (Minhaxhus-sunnetin-nebevijeti, 2/131) Islami thërret që të promovohet e mira dhe vlerat shpirtërore e morale.

Islami përmirëson njerëzimin duke përmirësuar individët. Prandaj, ai porositi të korrektohet besimi, i cili është burim i mendimit dhe i sjelljes së njeriut. Pastaj, njeriun e përmirëson duke thirrur në

pastrim të shpirtit, zemrës apo brendësisë së tij, ngase e brendshmjia e shëndoshë është lëvizësi i njeriut drejt punëve të mira. Më tutje jetën e njeriut dhe raportet mes njerëzve i trajton dhe i përmirëson përmes ligjeve të cilat i ka paraparë Urtësia hyjnore.

Në bazë të studimit sistematik të normave dhe rregullave të Sheriatit, apo Ligjit islam, hetojmë se ai, me urdhëresat dhe ndalesat e tij, synon të realizojë dhe të sigurojë të mirat e përgjithshme apo interesat e njerëzve (MESALIH) duke promovuar mirëqenien e tyre si individë dhe si trup kolektiv dhe duke larguar dëmin nga ata (EL-MEFASID). Ose me fjalë të tjera qëllimi kryesor i Sheriatit është t'i largojë të gjitha veprimet e dëmshme apo të këqia nga njerëzit si dhe t'i kultivojë e t'i mbrojë ato që janë të dobishme apo të mira për ata. Në të vërtetë ky ka qenë boshti i të gjitha mesazheve të profetëve të Zotit. Në mënyrë që të arrihet ky qëllim i madh Sheriati siguron një numër normash që kanë të bëjnë me njeriun dhe me besimin që aludojnë mëshirën, dhembshurinë, drejtësinë, mirësinë, lehtësinë e jo vështirësinë. Nga këto norma të larta mund të përmendim: obligueshmëria e drejtësisë dhe ndalimi i padrejtësisë (zullumit), mbrojtja e të drejtave, mbrojtja nga dëmtimi, norma për sinqeritet e dëlirësi, përmbushje të premtimit dhe parime të tjera të moralit islam të cilat realizojnë interesat që janë në dobi të individit dhe shoqërisë.

Dijetarët islamë këtë tematikë e kanë shqyrtuar në librat e shkencës së Usulul-fikhit, me një qasje përafërsisht të njëjtë.

Largimi i së dëmshmes (der'ul-mefasid)

El-mefsedeh, apo el-mefâsid në shumë, nga gjuha arabe ka kuptim e keqja, e dëmshmjia, ajo që çrregullon, shkatërron, korrupton dhe kuptime të ngjashme.

E dëmshmjia mund të jetë në jetën e kësaj bote, që është çdo veprim që i sjell dëm njeriut në këtë jetë, si dhe në jetën pas kësaj, ku Zoti realizon drejtësinë absolute dhe atëbotë ndëshkimi i Tij është dëmi më i madh për ata të cilët e vuajnë atë.

Sigurimi / tërheqja dhe ruajtja e së dobishmes (xhelbul-mesalih)

Nocioni el-maslaha, apo në shumë el-mesâlih është e mira, e dobishmjia, lumturia dhe shkaqet e saj, dhe të gjitha ato që i do dhe i pëlqen njeriu.

Objekti i Sheriatit është arritja e kufirit më të lartë të mirëqenies së njerëzve, prandaj ligjet e tij synojnë t'i sigurojnë, t'i mbrojnë dhe t'i kultivojnë të gjitha ato punë që janë në interes apo në dobi të njerëzve. Ajo që është e dobishme për njeriun nuk kufizohet vetëm në çështjet e kësaj bote, por në Sheriat ajo përfshin këtë botë, por edhe botën e ardhshme e cila është e amshuar; përfshin trupin material dhe shpirtin. Ligji islam – Sheriati, më tutje, synon të pajtojë dhe të barazpeshojë interesat e individit me ato të shoqërisë; interesat e të gjitha shtresave të shoqërisë; interesat e një kombi në veçanti me ato të njerëzimit në përgjithësi; interesat e gjeneratave të tanishme me ato të gjeneratave të ardhme. Këtë ai synon ta bëjë, sipas rendit të përparësisë, përmes:

1. garantimit të nevojave të

domosdoshme, qenësorë dhe vitalë (el-mesâlihu ad-darûrijjetu) të tyre,

2. plotësimit të kërkesave ose nevojave të tyre (el-mesâlihu el-hâxhijjetu),

3. përmirësimit të kualitetit të jetës së tyre (el-mesâlihu et-tahsinijjetu).

Ne shohim dhe jemi dëshmitarë se interesat dhe të mirat e të dobishmet të cilat njerëzit synojnë t'i sigurojnë në jetën e tyre individuale dhe shoqërore nuk dalin jashtë këtyre tri tipeve që i përmendëm. Kur njeriu ka nevojë për shtëpi ose së paku një shpellë ku do të ruhet nga të ftohtët dhe të nxehtët dhe nga gjëra të tjera që mund t'i shkaktojnë edhe vdekjen, ai në rastin tonë plotëson një nga interesat e domosdoshme. Ndërsa kur ai dëshiron që shtëpia e tij të ketë dritare dhe dyer që të dalë e të hyjë kur të dojë pa vështirësi dhe t'i hapë e t'i mbyllë dritaret pa vështirësi dhe kurdo që ka nevojë për fllad, rreze dielli apo ajër të pastër, ai në të vërtetë plotëson njërin nga ato që ne po i quajmë interesat e nevojshëm. Kurse kur atij i pëlqen që të ketë në shtëpi orendi funksionale dhe të bukura, shtrat të rahatshëm dhe gjëra të tjera pa të cilat përndryshe nuk do t'i ishte rrezikuar jeta, ai plotëson një interes përmirësues, siç po e quajmë në këtë kontekst. Ligji islam – Sheriati shërben që të sigurohen, të garantohen dhe të ruhen të gjitha këto tipe të interesave të njeriut si individ dhe shoqëri. Këtë mund ta hetojmë nga studimi i ligjeve të tij në sfera dhe aspekte të ndryshme të jetës, dhe duke studiuar shkaqet dhe urtësitë që fshihen pas ligjeve përkatëse.

Meqë interesat e njerëzve në jetë përfshijnë çështjet e domosdoshme, të nevojshme dhe përmirësuese, atëherë kurdo që atyre u sigurohen këto çështje

mund të thuhet se u janë realizuar interesat e tyre. Ligji islamik përmban norma dhe dispozita përkitazi me fusha të ndryshme të veprimit të njerëzve me të cilat realizon këto tri kategori interesash për individin dhe shoqërinë.

Pra, e dobishmja apo e mira të cilën Sheriati synon ta sigurojë mund të jetë njëra nga këto kategori të lartpërmendura. Të flasim në vazhdim për secilën nga këto veç e veç pak më gjerësisht.

Nevojat apo interesat e domosdoshëm, qenësorë dhe jetikë ose vetëm domosdoshmëritë

(El-mesâlihu ad-darûrijjetu ose shkurt ad-darûrijât)

Nevojat e domosdoshme dhe qenësore vitale të cilat Sheriati synon t'i mbrojë janë ato nga të cilat varet jeta e njeriut dhe pa të cilat jeta njerëzore nuk funksionon mirëfilli. Nëse ndonjë nga këto nevoja privohet ose kërcënohet, korruptohet apo prishet, atëherë kjo do të rezultojë në jetën e individit si dhe të kolektivit duke prishur dhe shkaktuar prishje të rendit në jetë.

Këto nevoja të domosdoshme, sipas rendit të përparësisë, janë pesë:

1. Feja ose sistemi natyral i besimit dhe mënyra islame e jetës (hifdhud-dîni);
2. Jeta e individit dhe e gjinisë njerëzore (hifdhun-nefsi);
3. Mendja e individit (hifdhul-akli),
4. Lidhshmëria e gjakut apo përkatësia familjare dhe nderi i individit (hifdhun-nesli ose hifdhun-nesebi dhe hifdhul-irdi) dhe
5. Pasuria apo prona (hifdhul-mali).

Disa dijetarë nën këtë kategori rradsisin edhe:

- Shteti (hifdhud-devleti),
- Siguria (hifdhul-emni) dhe

Dinjiteti i njeriut (hifdhul-kerâmetil-insânijjeti).

Ruajtja e secilës nga këto është e domosdoshme për mirëqenien e individëve dhe të shoqërisë. Prandaj, çdo gjë që garanton sigurimin dhe ruajtjen e këtyre parimeve, është e mirë dhe e dobishme, ndërsa çdo gjë që rrezikon këto, është e keqe dhe e dëmshme. Sheriati i mbron këto nevoja të domosdoshme për mirëqenien e jetës së njeriut, ashtu që përkitazi me to ka paraparë ligje të prera dhe për ata që shkelin këto ka përcaktuar masa, ndëshkime dhe sanksione. Ai parasheh ligje, dispozita dhe norma të cilat garantojnë këto nevoja jetike si dhe sistem e konventa penale me të cilën i mbron këto domosdoshmëri.

Me Fe nënkuptohet tërësia e besimeve, praktikave dhe ligjeve me të cilat Islami rregullon marrëdhëniet në mes njeriut dhe Krijuesit të tij dhe në mes njerëzve në mënyrë të ndërsjellë. Ruajtja e fesë nënkupton ruajtjen e saj nga devijimi dhe gabimi dhe thirrjen e të tjerëve që të pranohet dhe të jetohet në pajtim me të, dhe të mbrohet nga forcat që e rrezikojnë atë. Prandaj besimi, ritet e adhurimit (ibadetet), ndalesa nga risitë në Fe (bid-ah), ligjet përkitazi me luftën (xhihadin), me dispozitat për renegatët, të gjitha këto janë për ruajtjen e Fesë.

Me ruajtjen e jetës nënkuptohen masat për ruajtjen e gjinisë njerëzore në mënyrën më të mirë të mundshme, dhe kjo përfshin ligjet në lidhje me martesën dhe shtimin. Ajo gjithashtu përfshin sigurimin e nevojave të domosdoshme të ushqimit, pijes, veshmbathjes, strehimit dhe sigurisë, si dhe ligjet përkitazi me ndalimin e vetëvrasjes dhe abortit dhe

dënimin për vrasësin. Për të garantuar jetën, është paraparë banimi në shtëpi, pastaj martesë, dispozitat në lidhje me familjen, ndalesa për vetëvrasje, urdhri për shërim, lejimi i ngrënies së coftinës dhe ushqimeve të tjera parimisht të ndaluara në raste kur jeta varet nga këto ushqime, sepse nuk gjindet ushqim tjetër etj. Ligjet në lidhje me ndëshkimet dhe dëmshpërbëlimet për ata që privojnë të tjerët nga jeta e tyre janë vënë për ta ruajtur jetën e njeriut.

Ruajtja e mendjes është interes, për realizimin e të cilit Sheriati ka ndaluar konsumimin e alkoolit dhe të gjitha substancave dehëse. Gjithashtu, për këtë qëllim, Sheriati ka urdhëruar nxënien e diturisë, që mendja të pasurohet me njohuri dhe dituri, të mendohet për krijimin e qiejve, të tokës dhe çfarë ka në to. Më tutje Sheriati ka paraparë ndëshkim për ata që e konsumojnë alkoolin.

Nxitja e të rinjëve për t'u martuar, ndëshkimi për marrëdhënie seksuale joligjore (zina), ligjet që kanë të bëjnë me kufizimin apo përmbajtjen e shikimit, ndalesa nga vetmimi i mashkullit dhe femrës së huaj, ndalimi nga provokimi i gjinisë tjetër më veshje, me të folur etj., janë vënë për ta ruajtur pastërtinë morale dhe nderin. Ligjet në lidhje me ndëshkimet për ata që ngrenë akuza të pabaza kundër njerëzve të cilët janë të pafajshëm dhe të pastër kanë për qëllim të ruajnë nderin dhe dëlirësinë e njeriut. Ndalimi që fëmiu i huaj t'i mvishet një njeriu që në të vërtetë nuk është prind i tij ruan prejardhjen e individit.

Për ruajtjen e pronës dhe pasurisë janë përkujdesur ligjet e Sheriatit që nxitin njerëzit të punojnë dhe të fitojnë të mirat

materiale në mënyrë të ligjshme dhe të cilat ndalojnë shfrytëzimin dhe padrejtësinë. Për t'u furnizuar dhe pasuruar njerëzit me të mirat e botës, All-llahu ka obliguar punën, ka sqaruar rrugët e lejuara për t'u pasuruar dhe ka përcaktuar ligjet që rregullojnë dhe lehtësojnë tregtinë dhe veprimtaritë tjera afariste. Ndëshkimet për vjedhje, rryshfet e korrupsion janë për ta ruajtur pasurinë, e kështu me radhë. Gjithashtu ka obliguar të pasurit të japin një pjesë të caktuar nga pasuria e tyre për të varfërit dhe nevojtarët, dhe i ka nxitur ata për lëmosha të tjera vullnetare në mënyrë që edhe atyre t'u sigurohen bile nevojat më elementare për një jetë sa më normale.

Për ruajtjen e shtetit, All-llahu ka obliguar emërimin e halifes (kryetari i shtetit islam) për të gjithë muslimanët dhe ka ndaluar rebelimin ndaj shtetit, ka përcaktuar dënimet për ata që shkelin ligjet, ka ndaluar racizmin, nacionalizmin dhe format e tjera të diskriminimit dhe ka obliguar respektimin e halifes në ato çështje të cilat janë në pajtimin me Sheriatin.

Për të ruajtur sigurinë, All-llahu ka urdhëruar të pregatiten forcat me të cilat do të luftohet krimi dhe ata që e rrezikojnë sigurinë, ka urdhëruar promovimin e të mirave, thirrjen në punë të mira dhe ndalimin nga punët e liga, ka urdhëruar drejtësi në mes të njerëzve, ka ndaluar terrorizimin e njerëzve të pafajshëm etj.

Për të ruajtur dinjitetin e njeriut, Islami ka ndaluar zbatimin e dënimit mbi të akuzuarin para se të gjykohet bindshëm për fajësinë e tij; ka ndaluar të dënohet fajtori me dënime të shëmtuara të cilat nuk i ka paraparë Sheriati, si ndukja e

thonjëve, djegia me zjarr etj.; ka ndaluar fyerjen, përgojimin dhe akuzimin për zina pa patur dëshmitarë, e bile ai dënon ata që bëjnë këtë.

Interesat e nevojshëm apo vetëm nevojat apo kërkesat (El-mesâlihu el-hâxhijetu ose el-hâxhijât)

Këto kanë të bëjnë me ligjet e Sheriatit të cilat kanë për qëllim lehtësim në raste vështirësie dhe të cilat largojnë apo zvogëlojnë vështirësinë nga jetët e njerëzve dhe kanë për qëllim masat parandaluese që pengojnë të dëmshmet (el-ihitijât) apo ato që rrezikojnë domosdoshmëritë. Si shembull të këtyre, po përmendim llojet e ndryshme të kontratave dhe praktikave tregtare në veprimtaritë e biznesit që i ka pranuar Sheriati. Pastaj lejimin e shkurorëzimit në rast nevoje; ndalimin e shitjes së alkoolit në mënyrë që të pengohet apo vështirësohet arritja deri tek ai, apo për shembull joobligueshmëria e agjërimit për personin që është në udhë apo i sëmurë, tejemumi për atë që nuk gjen ujë, lejimi i shkurorëzimit dhe dispozita tjera të cilat e bëjnë jetën më të lehtë. Fjala është pra, për ato dispozita të cilat u mundësojnë njerëzve të çojnë jetë sa më të lehtë dhe poqë se mungon njëra nga këto nuk prishet rregulli i jetës së tyre, por jeta dhe aktiviteti njerëzor vështirësohet.

Nga ilustrimi vijues vërehet dallimi në mes të domosdoshmërive dhe nevojave: të ngrënit dhe veshmbathja janë nga dispozitat që bëjnë pjesë në domosdoshmëritë, ndërsa ushqimet e mira e të shijshme dhe veshmbathja e mirë dhe e rahatshme bëjnë pjesë në nevojat. Kështu, nëse ushqimi nuk është kushedi se sa i shijshëm apo rrobat nuk janë kushedi se sa të mira, kjo nuk don të

thotë se njeriu do të vdesë urie, apo nga të ftohtit, respektivisht nga të nxehtit, porse jeta e tij nuk është e lehtë dhe e rahatshme sikurse e atij që në bazë të kulturë së vet zgjedh ushqimet dhe rrobat e të mbathuarat më të mira.

Interesat përmirësuese të kualitetit të jetës ose përmirësueset (El-mesâlihu et-tahsînijetu ose et-tahsînijât)

Këto kanë të bëjnë me të gjitha ligjet e Sheriatit të cilat lidhen me përmirësimin e kualitetit dhe kushteve të jetës si dhe moralit të njerëzve. Përfshijnë ligjet në lidhje me pastrimin e trupit, rrobave dhe mjedisit, mbulimin e pjesëve private, mënyrën e largimit të papastërtisë, kryerjen e veprave jo të obliguara të adhurimit siç është agjërimi vullnetar, lëmosha e kështu me rradhë. Përmirësueset nënkuptojnë sjelljet dhe traditat e mira dhe largim nga situatat dhe sjelljet që janë të papranueshme. Fjala është pra për moralin dhe sjelljet e mira, si dhe për ato që e ruajnë dinjitetin dhe nderin e njeriut, si për shembull mbrojtja e njeriut nga akuzat e rrejshme dhe nga të fyerit. Fyerja, për shembull, nuk e rrezikon jetën e njeriut, dhe as privon një nevojë nga nevojat e tij, por ndalimi i saj e mbron njeriun nga gjërat që e poshtërojnë dhe e irritojnë atë. Në këtë kategori rradhiten normat që kanë të bëjnë me moralin, ato me pastërtinë, ta zëmë pastrimi i fëlliqësirave nga rrobat dhe ambienti ku jeton, prerja e thonjëve, larja, veshja e rrobave të bukura, largimi i pengesave nga rruga, mikëpritja dhe dispozitat tjera të cilat e zbukurojnë jetën. Nëse mungojnë përmirësueset nuk prishet rregulli i jetës dhe as nuk vështirësohet jeta, por ajo zhvishet nga edukata dhe kultura, ndërkaq kualiteti i

jetës do të jetë më i ulët gjithsesi.

Interesat plotësuese (El-mesâlihu et-tekmîlijjetu ose et-tekmîlijjat)

Në literaturë mund të hasim edhe në këtë kategori të veçuar nga të tjerat. Këto plotësojnë interesat e domosdoshme dhe të nevojshme ashtu që ato realizohen në mënyrë sa më të përsosur.

Në të vërtetë, nevojat janë plotësim i domosdoshmërive dhe plotësueset janë plotësim i nevojave. Prandaj, kur All-llahu ndalon një gjë, Ai ndalon edhe gjërat që çojnë te ndalesa përkatëse. Kështu kur Ai ndaloi marrëdhëniet seksuale jashtë martesës (zina) ndaloi të gjitha situatat dhe rrugët që çojnë tek ato, si për shembull qëndrimi vetëm i mashkullit dhe femrës së huaj në një vend, përzierja e gjinive pa kontroll, zbulimi i pjesëve provokative të trupit e të tjera. Për këtë në Kur'an thuhet: "Mos iu afroni zinasë..." Kjo aludon mbylljen e çdo rruge që çon te zinaja. Një shembull tjetër i interesave plotësuese mund të përmendet edhe ndalimi i kamatës që është plotësim i parimit të ruajtjes së pasurisë, që bën pjesë në domosdoshmëritë, ngase pjesa e shtuar që ipet si kamatë është pjesë e së mirës materiale që paguhet pa kundërvlerë. Në interesat plotësuese aludojnë rregullat e përgjithshme të fikhut, si: rruga që çon te harami është haram; çfarë ndalohet të merret, ndalohet edhe të jepet; çfarë ndalohet të hahet a të pihet, ndalohet edhe të shitet; ajo pa të cilën nuk mund të kryhet vaxhibi është vaxhib etj., si dhe dispozitat e veçanta si për shembull ajo që u cek më lartë në lidhje me ndalimin e vetmimit të mashkullit dhe femrës së huaj së bashku etj.

Kategoritë e lartpërmendura ndërlihen

me qëllimet e përgjithshme të Sheriartit. Nga këto, mund të shohim se interesat e Sheriatit nuk kanë të bëjnë vetëm me aspektet personale të fesë ose riteve të adhurimit, por merren me të gjitha aspektet e jetës.

Llojet e interesave për nga të marrët e tyre në konsideratë nga sheriati

Vështruar nga ky aspekt interesat i grupojmë në tri lloje:

1. Ato të cilat i merr në konsideratë, ose ua hedh vëmendjen Sheriati duke i mbrojtur ato dhe duke ndaluar çdo gjë që rrezikon dhe i kundërshton ato, siç është ruajtja e fesë që realizohet përmes përhapjes së diturisë fetare dhe propagandimit të tij si dhe duke ndaluar të gjitha ato që dobësojnë apo janë në kundërshtim me të;

2. Ato të cilat Sheriati nuk i pranon, siç është për shembull interesi i gruas për të qenë e barabartë me mashkullin në trashëgimi. Në këtë grup hyjnë të gjitha ato që nuk pranohen nga Sheriati, edhe pse njeriu mund t'i marrë si të mira, por nuk janë të tilla, sepse ose janë në kundërshtim me Sheriatin, ose bien ndesh me një nga qëllimet e tij, ose bien ndesh me një interes më të madh,

3. Ato për të cilat Sheriati nuk flet fare, pra as i ruan e as i kundërshton. Në këtë grup hyjnë të ashtuquajturat el-mesâlihul-murseletu.

Llojet e interesave për nga ndryshueshmëria

Sipas ndryshueshmërisë interesat mund të jenë:

1. Të pandryshueshëm apo të

qëndrueshëm, siç janë obligimet (vâxhib) dhe ndalesat fetare (harâm) dhe

2. Të ndryshueshëm varësisht nga situatat që i imponojnë kushtet kohore dhe vendore, siç janë ndëshkimet që nuk i parasheh Sheriati, por i propozojnë juristët ligjvënës, përdorimi i metodave dhe mjeteve të ndryshme me qëllim të propagandimit të Fesë, të cilat nuk kundërshtojnë ndonjë normë të Sheriatit e kështu me radhë.

Objektivat e shariatit në raport me nevojat e natyrshme të njeriut

Varësisht se si qëndrojnë interesat që i përfaqëson Ligji islam në raport me nevojat dhe kërkesat e natyrshme të njeriut ato janë dy llojesh:

1. Ato të cilat janë të pajtueshme me kërkesat e natyrshme të njeriut, pra janë të ngulitura në natyrën e tij dhe ai ndjen nevojë për to dhe

2. Ato që sipas natyrës së tij njeriu nuk i kërkon dhe nuk kanë dobi të dukshme për të.

Pra, fjala është për dobi apo interesa të dukshme dhe të padukshme, ngase shumë interesa të llojit të dytë në sy të njeriut nuk janë të dobishme, por në të vërtetë kanë dobi të fshehura, edhe pse njeriu mund të mos i sheh ato dobi.

Si shembull nga lloji i parë mund të përmendim: veshmbathja, të ngrënit dhe të pirët për të ruajtur jetën dhe kënaqja e nevojës seksuale. Ndërsa nga lloji i dytë po përmendim: zgjerimi i rrugëve, caktimi i rojeve natën e kështu me radhë.

Tekstet shariatike nuk kërkojnë në mënyrë urdhërore nga njeriu të kryejë veprat që ia sigurojnë interesat nga lloji i parë, sepse vetë kërkesat dhe nevojat e

natyrës apo trupit të tij do ta motivojnë atë për t'u angazhuar në ato punë, por roli i Sheriatit në këso raste është të ndalojë çdo gjë që pengon realizimin dhe arttijen e këtyre interesave. Për shembull Sheriati ndalon të merret pa të drejtë nga pasuria e tjetrit dhe ai të mbetet pa ushqim e veshmbathje. Ndërkaq Ligji (Sheriati) vë theks mbi veprat nga të cilat rezultojnë interesat e llojit të dytë, kërkon të kryhen ato si dhe kërcënon poqë se nuk kryhen ato.

Rëndësia e njohjes së objektivave të ligjit të shariatit

Gjithë Ligji islam duhet të kuptohet në dritë të objektivave të tij.

Ekspertët e ligjvënies në qeveritë bashkëkohore kujdesen që të shkruajnë dhe përmbledhin shënime shpjeguese për të sqaruar qëllimin e përgjithshëm të ligjit dhe qëllimet e secilit nen në veçanti. Pikërisht këto shënime shpjeguese bashkë me të gjitha hulumtimet dhe debatet të cilat shënohen me rastin e propozimit dhe miratimit të një ligji shërbejnë si ndihmesë për juristët dhe gjykatësit për të kuptuar ligjin përkatës dhe për të zbatuar atë.

Ligjet e Sheriatit nuk kuptohen drejt nëse nuk njihen qëllimet e përgjithshme të Sheriatit dhe qëllimet e veçanta të secilit ligj, rastet dhe shkaqet për të cilat kanë zbritur ligjet qofshin ato nga Kur'ani apo nga Sunneti. Njohja e qëllimeve të përgjithshme të Sheriatit është njohja më e rëndësishme me anë të së cilës kuptojmë drejt tekstet e Sheriatit, praktikojmë ato dhe nxjerrim ligje për të cilat nuk ka tekst përkatës nga burimet e Sheriatit. Ndërsa kuptimi dhe gjykimi

vetëm në bazë të teksteve të veçanta në lidhje me një çështje të caktuar shpeshherë jep rezultate gjysmake dhe të njëanshme, pra të gabuara dhe të rrezikshme nëse implementohen ato.

Shpeshherë shprehjet e teksteve të Sheriatit aludojnë në më tepër se një kuptim apo përmbajnë më shumë se një aspekt kuptimor. Bile disa tekste, shikuar sipërfaqësisht, mund të kenë kuptime kundërtëse ndërmjet veti. Për të zgjedhur një kuptim si më të saktë dhe më të vërtetë, apo për të shpjeguar “kundërtësit”, merret parasysh qëllimi i Sheriatit që rezulton nga dispozita apo ligji përkatës. Mund të ndodhë që për probleme të caktuara të mos gjindet ligj përkatës në tekstet e Sheriatit që do t'i zgjedhë ato probleme, ndërsa njerëzve u intereson gjykimi apo qëndrimi i Sheriatit në lidhje me to. Prandaj edhe në këso rastesh, për të dhënë përgjigje duhet të njihen qëllimet e përgjithshme të Sheriatit që të nxirren gjykime të reja në dritë të tyre dhe në pajtim me shpirtin e këtyre objektivave.

Sheriati islam ka metodë të veçantë dhe të pashoqe në realizimin e këtyre dy qëllimeve, pra largimin e së dëmshmes dhe sigurimin e mbrojtjen e së dobishmes për njerëzimin. Kjo metodë e urtë hyjnore ndërtohet mbi parime dhe rregulla të caktuara të shpjeguara gjerë e gjatë në literaturën e shkencës së Usulul-fikhut.

Njohja e thellë e kësaj lamie na jep

përgjigje në situata kur ndodhemi të zgjedhim ndërmjet dy të këqia apo të dëmshmeve se çfarë duhet të veprojmë, në rast se bien ndesh dy a më shumë të dobishme cilës duhet t'i japim përparësi si dhe në situata të tjera të pshtjelluara në jetë në të cilën e bardha dhe e zeza janë të përziera ndërmjet veti.

Peshimi i dobive dhe i dëmeve dhe gjykimi në situata të ndërlikuara në jetë, konsiderohet nga çështjet më precize të cilën kanë kompetencë ta bëjnë vetëm dhe vetëm ekspertët e kësaj lamie, pra ata që njohin mirë tekstet dhe objektivat e Ligjit islam - Sheriatit.

Literaturë e konsultuar:

- El-Muvafekatu fi usulish-sheriat, Esh-Shatibi(2/5-39),
- El-Mustesfa min ilmil-usul, Ebu Hamid El-Gazali (1/287),
- Minhaxhus-sunnetin-nebevijjeti, Ibënu Tejmijje,
- El-emru bil-maruf ven-nehju anil-munker, Halid Ibën Uthman Es-Sebt,
- Ilmu usulil-fikh, Abdul-vehhab Hilaf,
- Nahve thekafetin islamijetin asiletin, Umer El-Eshkar,
- Nadharatun fith-thekafetil-islamijjeti, grup autorësh,
- Mexhel-letu El-Hikmeh, nr. 7, 11, 17, 18.

Gëzim Selaci
redaktuar nga: Alblislam.Com
4.2.2005

Gruaja dhe familja

Zezaqja, banore e xhennetit

Ne shpesh i dëgjojmë ligjëruesit në faljen e xhumasë ose në ligjëratat e tyre mbi Parajsën dhe të gjithë i shohim zemrat, mendjet dhe mendimet përqëndrohen. Megjithatë, shumica e tyre flasin rreth Parajsës sikurse ajo të ishte vetëm për burrat. Realiteti nuk është ashtu. Parajsa është për besimtarët burra dhe gra. Amimi për të është besimi i pastër tek Allahu, dashuria ndaj Allahut dhe ndaj të Dërguarit të Tij, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, bindja ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

Më poshtë janë përgëzimet e dhëna nga i Dërguari i Allahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, për disa gra midis sahabijeve.

- I transmetuar nga Aisha, radijall-llahu anha: "Nuk ndjem xhelozë për asnjë nga gratë e Profetit aq shumë sa ndjehesha për Hatixhen (megjithëse) ajo vdiq përpara se ai më martoi mua, sepse shpesh e kam dëgjuar atë ta përmend Hatixhen dhe Allahu i ka treguar atij për t'i dhënë asaj përgëzimet që ajo do të ketë një pallat të ndërtuar me xhavahire dhe gurë të çmuar në Parajsë dhe kurdo që ai do të prente një bagëti, ai do t'i dërgonte shoqëve të saja një pjesë prej tij". [Buhariu].

- Enesi transmeton që i Dërguari i Allahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Gratë më të mira janë katër, Merjemeja, vajza e Imranit, Asija gruaja e Faraonit, Hatixheja, vajza e Huuejlit dhe Fatimeja, vajza e të Dërguarit të Allahut". [Buhariu dhe

Muslimi].

- Transmeton Ebu Hurejra, radijall-llahu anhu: "Xhibrili erdhi tek Profeti dhe i tha: "O i dërguar i Allahut! Kjo është Hatixheja që vjen tek ti me një pjatë me gjellë (ose pak ushqim ose pije) ku nuk do të ketë as zhurmë dhe as lodhje". [Buhariu].

- Transmeton Ata bin Ebu Rabah, rahimehull-llah: "Ibën Abbasi më ka thënë mua: "A do të të tregoj unë ty një grua nga njerëzit e Parajsës?" Unë i thashë: "Po". Ai tha: "Ajo grua e zezë erdhi tek Profeti dhe tha: "Unë kam ngacmime epilepsie dhe trupi im zbulohet (zhvishet), të lutem lutju Allahut për mua". Profeti i tha asaj: "Nëse dëshiron duro dhe ti do të hysh në Parajsë dhe nëse dëshiron unë do ta lus Allahun për të të shëruar ty". Ajo tha: "Unë do të duroj". Dhe shtoi "Por unë zhvishem, kështu të lutem lutju Allahut për mua që unë të mos të zhvishem". Kështu ai u lut për të". [Buhariu].

Hadithet e përmendura më lart tregojnë qartë statusin e grave që ju është garantuar Parajsa.

Çfarë mund të themi për gratë e sotme?

Si mund ato të arrijnë këtë sukses, Parajsën?

Që ta arrijnë atë, ato duhet të mësojnë sesi këta gra jetuan, sesi ata u sollën, sesi ato folën, sesi ato u veshën, sesi ato ecnin etj.. Në këtë çështje besimtarja për të cilën do të flasim është një zezake e përmendur në hadithin e fundit. Zezakes madje nuk i dihet emri ose ndodhitë e saja, ndryshe ajo

është e njohur për veprat e saja, besimin e saj, modestinë e saj, ndershmërinë e saj dhe gjithashtu është e njohur për përgëzimin me Parajsë, zatën, kjo është që ka rëndësi më tepër.

Kur Abdullah Ibën Abbasi, radijall-llahu anhu, tha "ajo zezakja", nuk e kishte për qëllim të tregonte racën e saj ose ta poshtëronte atë në ndonjë mënyrë. Me të vërtetë, ai e bëri këtë për t'i mësuar njerëzve rreth një princip të madh në islam i cili është i përmendur në vargun kur'anorë:

"O njerëz! Ne ju kemi krijuar ju nga një burrë dhe një grua dhe ju kemi bërë popuj dhe fise kështu që mund ta njihni njëri-tjetrin, me të vërtetë më të ndershmit nga ju në shikimin e Allahut janë ata më të devotshmit".

I njëjti princip është përmendur në hadithin : "Allahu nuk shikon në format dhe trupat tuaj por Ai shikon në zemrat e juaja (dhe në veprat e juaja)". [Muslimi].

Ajo (zezakja) ishte fizikisht e sëmurë, dhe u kurua me duanë e Profetit të Allahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Ajo e dinte se ai që shëron është Allahu dhe Allahu iu përgjigj dausë së Profetit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

Ky rast na jep të kuptojmë se duaja i shëron të gjitha sëmundjet, qofshni ato të zemrës ose të trupit.

Duke e komentuar këtë hadith, el-Hafidh Ibën Haxheri, rahimehull-llah, ka thënë: "Në këtë hadith është e treguar se kurimi i sëmundjeve përmes duasë dhe lutjes drejtuar Allahut dhe drejtimi unë kah Ai është mënyra më e sukseshme e shërimit por kjo nuk mund të përmbushet përderisa nuk plotësohen dy kushte: njëjeti i sinqertë dhe besimi i patundur ne efektivitetin e duasë dhe mbështetjes te Allahu.

Fakti që Muhammedi, sal-lall-llahu alejhi

ve sel-lem, ka thënë: "Nëse ti dëshiron bëhu e durueshme dhe do të hysh në Parajsë" është fakt për virtytin dhe shpërblimin e durimit gjatë sëmundjes. Në një tjetër hadith ai, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë: "Kurdo që një vështirësi e godet muslimanin, do t'i falen mëkatet për këtë gjë, madje edhe nëse e shpon ndonjë gjemb". [Muslimi].

Dhe në një hadith gjithashtu të transmetuar nga Muslimi, Ummus-Saib i mallkoi ethet, kurse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i tha: "Mos i mallko ethet sepse ato i heqin gjynahet si zjarri që i heq papastërtitë e një hekuri".

Zezakja preferoi vuajtjen në këtë botë që të merte shpërblimin e Parajsës! Ajo vuajti nga sëmundja, kurse dhimbja e saj dhe vështirësitë nuk e detyruan atë që të mos ta kënaqte Allahun!

S'ka rëndësi se kush është, nëse është në rrugën e Allahut, secili do të haset me vështirësi, sepse Parajsa është e rrethuar me vështirësi. Nëse gjërat e lehta dhe jeta janë pa vështirësi atëhere ai duhet të shikojë veten e tij, a jemi duke e ndjekur islamin e vërtetë? Veçanërisht në ambijentet e sotme mund të jetë e vështirë për një vajzë të re të vesh veshjen e modestisë, hixhabin (madje edhe pse është e obligueshme), të mos i flasin burrave dhe largohen prej tyre (e cila është e obligueshme) përveçse kur është e nevojshme.

Të gjitha këto mund të jenë shumë të vështira për tu arritur për dikënd në fillim, por kur ajo e përmirëson veten për hir të Allahut, atëhere të gjitha pengesat e tjera bëhen të pabaza.

Kështu, arrijmë deri te pyetja: si ta përmirësojmë veten?

Duke e njohur Allahun me emrat dhe atributet e Tij, duke e dashur dhe duke ju

bindur Allahut dhe të dërguarit të Tij, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, atëhere do të vijë ndihma e Allahut, inshallah.

Ajo (zezakja) preferoi të qëndronte e durueshme por nuk mund të toleronte që nderi i saj, modestia e saj dhe ndershmëria e saj të dëmtohej, madje as të prekej, e asnjë pjesë e trupit të saj të mos zhvishej, megjithëse ajo nuk kishte kontroll mbi të (për shkak të sëmundjes). Me të vërtetë ajo ishte një robëreshë e vërtetë e Allahut, ajo ishte besnike, një besimtare, një muslimane, një grua e devotshme dhe e drejtë, një grua e vërtetë dhe ajo ishte besnike ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Jo vetëm që kishte këto cilësi frymëzuese, ajo ishte gjithashtu e zgjuar dhe një grua madhështore, sikurse fjalët e saja të paharuara: "...por unë zhvishem, kështu të lutem lutju Allahut për mua që unë të mos të zhvishem".

Nëse ka fjalë që duhet të shkruhen me germa të arta, atëherë këto fjalë duhet të shkruhen me germa të arta...kujtoni këtë ekuacion të thjeshtë:

Iman + vuajtje + durim = Parajsë

Mund gjithashtu të thuhet që gruaja e drejt muslimane e do mbulesën, e do modestinë dhe urren ekspozimin e trupit të saj dhe bukurisë së saj. Zezakja, radiallahu anhu, mund të duronte të qënurit e sëmurë por nuk mund të duronte zhveshjen e saj përpara njerëzve.

Nuk është me rëndësi a je i bardhë apo je i zi, je arab apo jo arab, i pasur apo i varfër por a kemi besim të thellë në zemër sikurse gjaku që rrjedh në venat e tyre.

Ata, sahabijet, ishin të përkushtuar plotësisht islamit.

Katërmbëdhjetë shekuj historie kanë treguar që gratë muslimane mund të

duronin urinë, varfërinë por kurrë nuk mund të duronin mosbindjen ndaj Allahut. Gruaja do t'i thonte burrit të saj kur ai shkonte për në punë: "Frikësohu Allahut për ne, sepse ne mund të durojmë urinë dhe etjen por nuk mund të durojmë zjarrin e xhehennemit".

Të dashura motra, pyeteni veten çfarë e bëri Hatixhen, radijall-llahu anha, të përshëndetej nga Allahu dhe nga Xhibrili alejhisselam.

Pyete vetveten çfarë e bëri Hatixhen të përgëzohet me një shpërblim si ai i një pallati në Parajsë sa nuk mund të imagjinohet?

Nëse lexojmë biografinë e Hatixhes dhe grave të tjera si ajo, ne do të kishin dashur të ishin në shërbim të tyre, të mbanim këpucët e tyre, të lanim rrobat e tyre, t'i shërbenim në çfarëdo mënyre dhe t'i kërkonim të bënin dua për ne. Është e trishtueshme që ne nuk nuk dimë madhështinë e këtyre personaliteteve të mëdhenjë të këtij ummeti. Nëse ne vetëm do të përpiqeshim të studjonim jetët e selefëve që na kanë kalura ne, ne do të gjejmë udhëzime të madh për ekzistencën tonë dhe nëse ne i njohim ata dhe i ndjekim ata ne mund të jemi në rreshtin e parë të njerëzimit...

Është e thënë që: "Imani nuk është shpresë boshe por është besim me zemër dhe i provuar me vepra. Ne ju lejmë ju që të mendoni rreth kësaj dhe t'i luteni Allahut që të na bëjnë ne prej banorëve të xhennetit dhe të na vendosë mbi ne besimin dhe durimin që do të na çojë në Parajsë. Dhe për ta bekuar Ummetin e tashëm musliman me shumë gra si ajo zezakja, radijall-llahu anha, të cilat na ndihmojnë të përqëndrohemi mbi këtë rrugë të drejtë...

Gratë dhe thirja islame

Që nga fillimi, gratë kanë luajtur një rol vital në përhapjen e të vërtetave themelore të daveit islam. Nga sakrificat e Sumejas e deri tek koleksionimi i haditheve nga Aisha, gratë kanë qenë të kyqyra në lulëzimin dhe përhapjen e kësaj feje. Fatkeqësisht gjatë këtyre kohërave, ringjallja islame vuan nga dobësia në personelin e kualifikuar mirë, i cili e kufizon përhapjen e saj dhe e limiton daveitin vetëm në një elitë grupesh aktiviste, me përpjekje të kufizuara të daveit dhe të edukimit me përqëndrim mbi gratë.

Daveiti midis grave meriton dhe duhet të tëhjekë më shumë vëmendje sesa ka momentalisht. Deri tani, përveç në disa raste të vogla, gratë janë distancuar nga fusha e daveit. Nëse ne shikojmë realitetin dhe situatën e daveit islam dhe pozicionin e grave sot, ne mund lehtësisht të gjejmë problemet e mëposhtme:

- Gabime në aftësitë e daveit midis grave dhe nga gratë.
- Përdorimi i keq i burimeve të kufizuara që ekzistojnë në kombinim me një mungesë të iniciativës personale nga ana e grave.
- Një neglizhim mbi dështjet e grave në planifikimin e daveit islam.
- Mungesa e një edukimi të fortë dhe mungesa e dijes themelore islame në thirrëset islame në fushën e daveit. Vetëm pak gra dhe vajza thirrëse kanë ndonjë farë dije islame.

• Pjesa më e madhe e grave nuk posedojnë një të kuptuar të drejtë të rolit të daveit që është bërë i detyrueshëm mbi burrat e tyre. Për shkak të kësaj, ata nuk mund ta kuptojnë rëndësinë e kohës së dhënë projekteve jashtë shtëpisë, të cilët në kthim, mund të bëhen një burim tensioni brenda shtëpisë.

- Niveli i përgjithshëm i dijes islame midis pjesës më të madhe të grave është i ulët.
- Programet e daveit të grave, ashtu si programet e daveit në përgjithësi dhe institucionet janë të rralla dhe nuk janë të organizuara mirë.

Shumë pengesa dhe kufizime janë bërë shkaqe prapa dobësisë dhe neglizhimit të daveit midis grave. Ato janë të njohura dhe të analizuara, zgjidhje të mira mund të shihen dhe të praktikohen.

Një arsye madhore, është që shumë gra nuk janë të bindura rreth rëndësisë së rolit të grave dhe përgjegjësive në fushën e daveit. Vargu kura'norë: "...qëndroni në shtëpiat tuaja".[33:33] është keqinterpretuar nga shumë...

Në shumë raste ne shohim burra që kundërshtojnë pjesëmarrjen e grave në daveit dhe kështu i pengojnë ato për të përmbushur rolin e tyre drejt motrave të tyre muslimane dhe të shoqërisë së gjërë në përgjithësi. Përhapja e islamit është e bërë obligim mbi të gjithë muslimanët, burra dhe

gra.

“Është vitale që burrat t'i inkurajojnë gratë e tyre për të marrë pjesë në davetin islam” ka thënë Dr. Aisha Hamdan, Drejtoresha e Fondacionit të Edukimit Islam, i vendosur në Mineapolis, Minezota. Ajo ka një PH.D. (doktoraturë) në Psikologji Klinike me specializim në çështjet e fëmijëve dhe familjeve. Ajo jep mësim në një universitet privat në Twin Cities. IEF është një organizatë dy vjeçare, me një qëlim që të shtojë nivelin e vetëdijes dhe për të ofruar stërvitje në davetin islam, midis grave muslimane dhe burrave. “Ata duhet t'i inkurajojnë ato për të përhapur mesazhin e kësaj feje, ndoshta duke i marrë përkrah kur ata dalin jashtë dhe duke i mësuar atyre mënyrat e rregullta për prezantimin e islamit”.

Një arsye më e veçantë është mungesa apo konfuzioni i prioriteteve në mendjet e daive (thirrëseve). Pjesa më e madhe e tyre janë të ç'orientuar nga gjendja e Ummetit, madje edhe deri në atë pikë sa injorojnë për t'i dhënë vëmendjen e tyre shtëpiave të tyre dhe familjeve të tyre. Energjitë e tyre janë shterur jashtë, në punën jashtë shtëpisë, duke i lënë ata pa asgjë për familjet e tyre. Ky mos balancim vret jo vetëm familjet por edhe komunitetin e tërë.

Niveli i edukimit të grave dhe i vetëdijes së pozicionit të tyre dhe përgjegjësisë së tyre luan një rol të rëndësishëm. Ashtu si edukimi dhe vetdija bien, gratë janë bërë më të pa interesuara, niveli i tyre i dhënies dhe sensi për sakrificë është dobësuar. “Fatkeqësisht, jo shumë gra muslimane ndjejnë që ata dinë shumë rreth islamit për ta ndarë atë me të tjerët. Ata kanë nevojë që përgjegjësia e tyre për të përvetësuar atë dituri dhe pastaj për ta ndarë atë me të tjerat. Shumë gra gjithashtu ndjehen të

parehatshme që t'i prezantohen grupeve të njerëzve për shkak të shumë arsyeve”.

Dr. Hamdan ka thënë: “Kjo është pse ne jemi duke u stërvitur këtu, rreth asaj se si të sillemi kur të bëjmë davet. Ne jemi të përkushtuar për tu përpjekur për t'i armatosur gartë me aftësitë e nevojshme që do t'i jap atyre konfidencën për të marrë këtë me shumë seriozitet dhe që është shpesh rol i neglizhuar në jetën e tyre si muslimane”.

Jetesa në luks, madje edhe nëse ato janë gjëra që janë të lejuara, zakonisht i detyrojnë gratë të ndajnë më tepër kohë atyre dhe pak kohë davetit islam. Kjo është gjithashtu ndodh kur ata e gjejnë atë vështirë për të balancuar të drejtat me detyrat. Ngandonjëherë gratë humbin prespektivën, duke harruar që puna brenda shtëpisë është thelbi i misionit të tyre. Duke neglizhuar këtë rol apo kur ato dështojnë t'i sistemojnë prioritetet e tyre dhe për tu shtrënguar tek një punë që i tërheq ata, ata përfundimisht dështojnë në përmbushjen e roleve të tyre në davetin islam në të dyja edhe në shtëpi edhe jashtë. “Për shumë gra, puna e tyre si grua, nëna, kuzhinieri dhe mësuese, brenda shtëpive të tyre, janë aq shumë të zëna që pengesa kryesore për të është mungesa e kohës” ka thënë Dr. Hamdan. “Kjo është pse është aq e rëndësishme për burrat për të qenë më shumë mbështetës ndaj grave të tyre në përmbushjen e obligimeve të tyre brenda shtëpisë por edhe ato jashtë shtëpisë”.

Një tjetër realitet fatkeq është që pjesa më e madhe e organizatave të davetit kanë dështuar në përvetësimin dhe përdorimin e energjive të grave dhe kanë dështuar gjithashtu në rregullimin e planeve dhe programeve të tyre në një mënyrë që do t'i përfshinte edhe gratë si esenca e davetit të

tyre islam.

Media, dhe shumë element të tjerë së shoqërisë së prishur në të cilën ne jetojmë, kanë patur një rol madhorë mbi psikikën e grave muslimane. Kjo psikikë i ka mabjtur gratë larg nga misioni i tyre dhe ka shtrembëruar imazhin e tyre të islamit në mendjet e shumë prej tyre.

Një kërkim i ndërmarrë nga revista el-Xhumua, në republikën Dominikane, ka treguar që rreth 75 për qind e atyre që pranojnë islamin midis atyre vendasve, janë gra. Për shkak të kësaj, ka një nevojë shumë të madhe për gratë muslimane për të marrë pjesë në davetin islam. "Roli për të thirrur në këtë fe, nuk përfundon me shqiptimin e shehadetit" ka thënë Dr. Hamdan. "Gratë kanë nevojë për të ndihmuar gratë e tjera për tu futur në islam dhe kanë nevojë për t'i mësuar atyre pasi ato bëhen muslimane". Arsytet për pjesëmarrjen e grave është e rëndësishme si më poshtë:

- Gratë janë më të afta sesa burrat për të komunikuar me gratë. Gratë janë zakonisht më shumë të ndikuara nga fjalët, veprat dhe sjelljet e grave, më tepër sesa ato të burrave. Gratë janë më tepër të afta për të njohur veçantitë dhe problemet të ndërlidhura me edukimin e grave.

- Gratë mundet më mirë të kuptojnë drejtimin në të cilin duhet të marrë daveti islam. Ata mund të dallojnë më mirë prioritetet, sepse ata janë më familjar me këtë sferë.

- Gratë janë të lira se burrat për të komunikuar me gratë e tjera, ose individualisht për aktivitetet e davetit ose në mësimin e grave dhe të tjera forume dhe vende takimi.

- Shumë gra muslimane të cilat kanë nevojë për udhëzim, edukim dhe drejtim i mungon prezenca e vëllezërve musliman të

cilët mund të ofrojnë këtë shërbim, si rezultat është e dukshme që duhet gra të kualifikuara në komunitet të ofrojnë këtë.

- Nevoja për edukim e grave është më shumë e madhe sesa për burrat. Ata mbesin shtatëzëne, lindin, dhe ushqejnë fëmijët. Fëmijët janë të lidhur me shumë me ta sesa me baballarët e tyre. Gratë qëndrojnë në shtëpi me djemtë dhe vajzat e tyre dhe kështu mund t'i edukojnë si të duan. Nëse atyre nuk i lejohet të ndajnë përpjekjet e davetit me burrat e tyre, shumë nga rezultatet që duhen nuk do të arriheshin.

- Gratë kanë një efekt të madh mbi burrat e tyre. Nëse ata kanë një iman dhe karakter të fortë, ato kanë një shans të mirë për të ndihmuar burrat e tyre për tu bërë më të fortë.

Gratë kanë shumë karakteristika që tregojnë për rëndësinë e rolit të tyre në davet. Ata duhet gjithashtu të merren në llogari kurdo që të planifikohet ndonjë organizim për davetin islam. Disa prej tyre janë:

- Gratë kanë aftësi të lindura për të komunikuar fuqishëm çfarë ato besojnë se është e vërtetë në zemrat e tyre. Dr. Hamdan gjithashtu tregon që: "Gratë janë gjithashtu më të fuqishme në termat e aftësive verbale dhe emocionale".

- Gratë ngandonjëherë i mungon vullneti dhe një sens drejtimi dhe si rezultat kanë nevojë për ndihmesë nga gratë e tjera për t'i motivuar dhe fuqizuar.

Puna e grave në fushën e davetit islam, fuqizon punën e burrit dhe e zgjeron aty ku efektiviteti i saj e kalon atë të burrit. شتhtë thënë që ky rol është aq i nënvlerësuar. Nga natyra e saj si një prehje shpirtërore dhe psikologjike e burrit, gruaja mund të luaj një rol shumë të rëndësishëm në davetin islam,

se sa një burrë i cili është i preokupuar me punët dhe qëllimet, të përballet probelemt e tij, le të mos flasim të mabjë edhe peshën e davetit islam mbi supe. Shumë kanë dështuar në rrugën e davetit për këtë arsye. Prehja, ndihma dhe mbështetja e Hatixha-s për Pejgamberin, salallahu alejhi ve sel-lem, ofrojnë faktet më të mëdha të rëndësisë së këtij roli. Sahabet e Pejgamberit, salallahu alejhi ve sel-lem, të cilët i lanë shtëpiat e tyre për të shkuar në vende që ishin me mijëra milje larg për ta çuar fenë e re tek njerëzit, ata kishin mbështetjen e grave të tyre.

Shumë pak gra sot kuptojnë apo janë të vetdijshme për një rol të tillë, le të mos flasim për kryerjen e tij. Një grua mund të mendojë që martesë është një vend rehatie dhe lehtësie. Atyre i duhet ende të kuptojnë që martesë është fillimi i luftës, sakrificës, dhënies dhe përgjegjësisë.

Roli i grave nuk përfundon tek dera. Ajo mund të jetë më efektive duke qenë një shembull i mirë për të tjerët, duke qenë me zemër të mirë, me të folur të këndshëm dhe sjellje miqësore. Ajo mund të ofrojë ndihmesë dhe të ndajë shqetësime ashtu si ajo gëzon. Ajo mund gjithashtu të përdorë të gjitha mundësitë për të edukuar, udhëzuar dhe thirrur të tjerët megjithesë duke i vështruar kushtet e atyre të cilëve ajo i drejtohet.

Gratë, të cilat kuptojnë roline tyre, filluan të edukojnë vetet e tyre dhe duke marrë të drejtat e tyre të edukimit. Shikoni tek hadithi i transmetuar nga Ebu Said që gratë i thanë, Pejgamberit, salallahu alejhi ve sel-lem,; "Burrat janë duke të mbajtur shumë të zënë dhe ne nuk marrim vëmendje të mjaftueshme nga ti. A do të na lësh një ditë për ne, gratë? Ai pastaj premtoi një ditë për tu takuar me to dhe për t'i edukuar ato dhe

për t'i paralajmëruar ato". [Buhari]

Frutet e këtij të kuptuari dhe nga sahabijet e Pejgamberit, salallahu alejhi ve sel-lem, dhe vëmendja që i dha atyre, janë shembuj dhe një burim krenarie për gratë muslimane.

Këtu janë edhe disa raste të tjera:

Umm Sulejm duke e mësuar djalin e saj Enes Ibën Melik rreth islamit, madje edhe burri i saj refuzoi islamit. Kur Ebu Talha i propozoi asaj (përpara se të pranonte islamit) ajo i tha atij që mehri i saj do të ishte islami, ai përqafoi islamit dhe ajo e martoi atë. Ajo e bëri djalin e saj Enesin shërbëtorë të Pejgamberit, salallahu alejhi ve sel-lem.

Ummu Hakim ishte sepeli për përqaftimin e islamit nga ana e burrit të saj dhe halla e Adi Ibën Hatim e solli atë në islam. Amra, gruaja e Habib el-Axhamit e ngritte burrin e saj për të falur namazin. Esmaja, vajza e Ebu Bekrit, e ndaloi djalin e saj, Abdullah Ibën Zubeir të pranojë një mënyrë për t'i ikur vdekjes megjithesë ajo ishte në moshë dhe kishte nevojë për dikënd krahas saj.

Nëse ne lëvizim tek një rreth më i gjërë, ne do të gjejmë që gratë muslimane kanë luajtur një rol shumë të madh në sakrifikimin dhe shërbimin për fenë e Allahut. Sumeja dorëzoi jetën e saj kur Ebu Xhelhi e vrau atë sepse ajo u bë muslimane. Ajo ishte muslimani dhe gruaja e parë e vrarë në islam. Hatixha, gruaja e parë e Pejgamberit, salallahu alejhi ve sel-lem, e cila ishte shumë e pasur, shpenzoi paratë e saja për të mbështetur davetin islam. Ummi Seleme e la burrin e saj dhe pa fëmijët e saj të persekutohen kur ajo migroi. Ummi Imare luftoi në mbrojtje të Pejgamberit, salallahu alejhi ve sel-lem, në luftën e Uhudit. Kurimi i plagëve në luftëra ishte roli i grave muslimane gjatë gjithë historisë.

Ka kushte që duhet të takohen që daveti i gruas të ketë sukses dhe të ta arrit këtë qëllim. Shumë gjëra në diskutimin e mëposhtëm duhet të konsiderohen mirë gjatë gjithë kohës, por është gjithmonë e rëndësishme për të qenë në lidhje me ambientin specifik në të cilin bëhet davet, studjuar atë dhe për të vizatuar të gjitha programet për t'i përshtatur realitetit dhe nevojave.

Sigurisht, argumentet nga Kur'ani dhe Sunneti, mbulojnë dhe i aplikohen të dyve edhe burrave edhe grave. Përemrat meshkij janë më shumë të përdorur për shkak të zakonit të gjuhës. Megjithëse, ka disa argumente që janë të veçanta për burrat. Dhe në të njëjtën kohë, Allahu i ka urdhëruar disa gjëra vetëm për gratë. Kjo tregon që ata kanë një karakter dhe personalitet të pavarur nga burrat. Kjo tregon edhe nevojën për t'ju drejtuar grave me davetin islam, edukimin, reformën dhe udhëzimin, në një mënyrë specifike për ata. Ato nuk duhet të injorohen. Ishte kjo sebepe që Pejgamberi, salallahu alejhi ve sel-lem, ju drejtua grave në veçanti, menjëherë pasi ai ju ishte drejtuar burrave dhe që ai caktoi një ditë të veçantë të javës mbi të cilën ai i mësoi vetëm atyre.

Kur'ani na tregon ne që njeriu është përgjegjës për shtëpinë dhe familjen e tij: "O ju që besuat, ruane veten dhe familjen tuaj prej një zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë (zjarrin) e mbikëqyrin engjëjt të rreptë e të ashpër që nuk e kundërshtojnë All-llahun për asgjë që Ai i urdhëron dhe punojnë atë që janë të urdhëruara".[66:6]

Dhe Pejgamberi, salallahu alejhi ve sel-lem, salam ka thënë gjithashtu: "Njeriu është bariu i familjes dhe është i përgjegjës për ruajtjen e saj" [Buhari

dhe Muslimi]

Kjo me të vërtetë tregon nevojën për edukim dhe kujdesin për gratë. Në anën tjetër, ka shumë argumente nga Kur'ani dhe sunneti që dëshmojnë faktin që gratë janë gjithashtu të obliguara për të bërë davet:

Ka shumë vargje kur'anore që e obligojnë muslimanin dhe muslimanen për të bërë davet dhe për të urdhëruar për të mirë dhe për të ndaluar nga e keqja. Për shembull, Allahu ka thënë: "Nga ju le të jetë grup që thërret në atë që është e dobishme, urdhëron për punë të mbara dhe ndalon nga e keqja. Të tillët janë ata të shpëtuarit".[3:104]

Grave ju u është dejtuar me detyrën e davetit për shkak se Allahu sybhanë ua teala ka thënë: "O gratë e Pejgamberit, ju nuk jeni si asnjë grua tjetër, nëse keni kujdes e ruheni, andaj mos u llastoni në të folur e të lakmojë ai që ka sëmundje në zemrën e tij, po thuani fjalë të matura".[33:32]

Ibën Abbasi e kuptoi tekstin kura'nor për gratë e pejgamberit "thuani fjalë të matura" se ka kuptimin që ata duhet të urdhërojnë për të mirë dhe të ndalojnë nga e keqja. Kjo mund të merret si një thirrje e përgjithshme për të gjitha gratë muslimane. Allahu gjithashtu thotë: "Besimtarët dhe besimtare janë të dashur për njëri-tjetrin, urdhërojnë për të mirë, e ndalojnë nga e keqja, e falin namazin dhe japin zeqatin, respektojnë All-llahun dhe të dërguarin e Tij. Të tillët do t'i mëshirojë All-llahu. All-llahu është ngadhnyes, i urtë".[9:71]

Është e qartë në këtë vers që gratë janë të drejtura me këtë detyrë, tamam si burrat, kurdo herë që janë të afta të veprojnë kështu Pejgamberi, salallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Gruaja është një rojtare e shtëpisë së burrit të saj dhe fëmijëve dhe ajo është e përgjegjshme për ta". Një

rojtare këtu është një person i besuar me diçka që i është vënë në përgjegjësi, për ta lulëzuar dhe ruajtur atë.

Është një kohë që muslimanët të cilët thonë se i përkasin Sunnetit të rishikojnë çështjen e daveit midis grave dhe nga gratë. Ne duhet të përkujtojmë Hatixhen, Aishen, Sumejen dhe shumë gra muslimane përmes historisë sonë dhe çfarë ata bënë për islamin dhe mësuat nga ai. Ne duhet gjithashtu të kuptojmë që vetëm të folurit dhe emocionet janë të pavlefshme. Ne kemi

nevojë për të bërë diçka rreth situatës sonë të tanishme. Edukimi, përgatitja dhe kualifikimi i grave do të jetë çelësi i suksesit të ardhmes sonë. Përmes historisë, matësi i përdorur për të matur mirëqënien e cilës do shoqërie ka qenë kushtet e grave të saj. Le të përpiqemi tani për të përmirësuar kushtet e grave muslimane nga ana intelektuale, shpirtërore dhe emocionale duke i lejuar asaj për të përmbushur kështu aftësitë e dhëna nga Allahu dhe përgjegjësitë e bëra obligim mbi të.

Abdul Latif M. el-Hasan dhe Sumejah Bint Xhoan
Marrë nga revista: el-Xhumua
Përktheu: Ammar Ardit Kraja
4.2.2005

Dr. Salah Savi

Një prej dijetarëve të njohur bashkëkohor, thirrës i njohur dhe aktivist i suksesshëm në fushën e arsimit fetar dhe daveitit në Amerikën veriore, dr. Salah Es Savi...

Lindi më 9 nëntor të vitit 1954 në regjionin e Asjutit në Egjipt. Në nje familje me traditë fetare në të cilën gjithë fëmijët (tetë gjithsej) ishin hafizë të Kur'anit

Në kërkim të dijes:

Në moshën shtatëvjeçare përfundoi mësimin e Kur'anit përmendsh dhe fitoi vendin e parë në nivel shtetëror në garat e mbajtura në vitin 1962. Pasi që përfundoi shkollën fillore dhe atë të mesme u regjistrua në univerzitetin e Az'harit në të cilin diplomoi në fakultetin e sheriatit në vitin 1976 si i pari në grupin e tij.

Titullin e magjistratit dhe doktorit i fitoi në të njëjtin fakultet në vitin 1985.

Jeta e tij profesionale vijoi kështu:

Në vitin 1977 punoi si asistent në fakultetin e sheriatit.

Mes viteve 1981-1985 ligjeroi në univerzitetin Ummul kura në Meke.

Mes viteve 1985-1987 punoi në komisionin për mrekullitë shkencore në Kur'an dhe Sunnet pranë Rabitasë.

Prej vitit 1992 filloi punën e tij në shtetet e bashkuara të Amerikës ku është njëri prej inicuesve të hapjes të Univerzitetit të hapur Amerikan.

Sot është anëtar në Komisionin që tubon fukahatë (juristët të sheriatit) të Amerikës.

Gjatë jetës së tij të deritanishme i shkroi 34 libra nga të cilët do t'i veçojmë:

- Pyetjet e Amerikanëve rreth Islamit
- Bazat e Imanit
- Njohuritë esenciale për muslimanin
- Njohuritë esenciale për tregtarin
- Përpunimi i librit "Sherh El Akide Et Tahavije"
- Përpunimi i librit "Sarimul Meslul ala Shatim Er Resul"
- Debatimet me laikët
- Ndalesat dhe të drejtat e njeriut në hutben lamtumirëse
- Analizë e qetë e fetvasë që lejon kamatën
- Mbi zbatimin e Sheriatit
- Analizë e globalizmit
- Kështu flasin thirrësit
- Pozita e as'habëve në Kur'an
- Debatë rreth tesavufit etj.

Ka marrë pjesë në shumë konferenca, seminare të përgjithshme dhe të veçantë.

Punon në projektin me qëllim të afrimit të trashëgimisë shkencore duke shkurtuar, rifolmuluar dhe komentuar librat e vjetra.

Inicloi hapjen e "Univerzitetit të hapur" me qëllim të afrimit të dijes fetare pranë atyre që nuk kanë mundësi të studimit në mënyrën tradicionale.

Punoi në hapjen e Komisionit të fukahave të Amerikës që merret me hulumtime të veçanta për muslimanët që jetojnë në Amerikë, bën aftësimin e kuadrove për punë në xhami dhe qendrat islame.

All-llahun e lusim t'i japë tefik në punën e tij,
Amin

Përktheu: Talha Kurtishi / Alblislam, / 14.1.2005

Hafidh Abdul-Gani El-Makdesi

Emri i tij është Imam Hafidh Tekijudin Ebu Muhamed Abdul-Ganij ibën Abdul-Vahid ibën Ali El-Makdesi El-Xhumaili, pastaj Dimeshki, Salihi, Hanbeli.

Vendlindja

Ka lindur në Xhumail, Nablus në Palestinë, në vitin 544 h. dhe ka marrë mbiemrin sipas Bejtul-Makdisit për shkak të afërsisë me Xhumailin, vendlindjen e autorit. Është njohur si "Salihi " nga lagja sipas të cilës janë njohur familjet dhe banorët e vendit.

Nga jeta e tij

Prej vendlindjes emigron me familjen e tij në Damask. Që në vegjëli fillon të kërkojë dituri. Mëson te një nga familja e tij, te dijetari eminent Muhamed ibën Ahmed ibën Kudame El-Makdesi – Ebu Omer. Mëson edhe te dijetarë tjerë si te dijetari Muvafakudin Abdull-llah ibën Ahmed ibën Kudame. Pastaj ka mësuar të dijetarët e Damaskut. Nga ata mësoi fikh dhe lëndë tjera.

Shkoi nëpër shumë vende për të kërkuar dituri si në Bagdad, Aleksandri, Kudus, Egjipt, Haran, Mosul, Isfahan, Hemed-han dhe vende tjera.

Nuk ka humbur kohën kot, pa e shfrytëzuar, por e shfrytëzonte ate për dituri. Mësonte vet dhe i mësonte tjerët. Lexonte, shkruante, falej dhe bënte ibadet vazhdimisht.

Sprovat me të cilat u ballafaqua

Kjo është ligj i All-llahut në Tokë. Si gjithë dijetarët edhe Hafidh Abdul-Ganij u sprovua me sprovë pasi shfaqte të vërtetën. E kundërshtonin ate kundërshtarët e tij, adhuruesit e dynjasë, ekstremistët në të shtrembët dhe si dhe hasedxhinjët (ziliqarët). Ata që kishin ndryshuar edhe bazat e besimit. E detyronin të del nga çdo vend ku shkonte. Kështu i ndodhi në Isfahan, Mosul, Damask, Ba'lebek, Kairo e tjera. E dëbonin pa kurrfarë të drejte vetëm pse e thonte të drejtën dhe kishte besimin e të parëve të mirë— selefut salih.

Veprat

Veprat më kryesore të tij janë :

- El-Umde fil-Ahkam - fikh
- En-Nasiha fil-ed'ijetis-sahiha-libër i

lutjeve

- Menakibus-sahabe - vlerat e sahabëve
- Mihnetul-imam Ahmed - sprovë e Imam

Ahmedit

- Es-Sifat - cilësitë e All-llahut

Vdekja e tij

Ka vdekur në ditën e hën me 23 Rebiul-ewel të vitit 600 hixhri në moshën pesëdhjetë e gjashtë vjeçare në Egjipt, Kairo, ku edhe varoset. All-llahu e mëshiroftë.

Lavdatat e dijetarëve për te

Numër i madh i dijetarëve e kanë cilësuar me cilësi që tregojnë sa ka qenë i vendosur dhe i përpiktë në shkencën e Hadithit dhe për transmetuesit e tyre. Për ate se sa ka qenë i pastër në ndërgjegje dhe sa i fortë në besim. Sa zbatues dhe pasues i sunetit. Sa ka urdhëruar për punë të mira dhe sa ka ndaluar nga të këqijat. Dhe për ate se sa është zemruar kur janë shkelur ndalesat e All-llahut, për hir të All-llahut nuk friksohej nga qortimet e qortuesit. Poashtu e kanë

cilësuar ate me bujari, dhe si dorëdhënës, asket, jolakmues ndaj dynjasë dhe si njeri me ibadet të shumtë, All-llahu e mëshiroftë dhe e strehoftë në xhenetet e begatshme.

Shiko për biografinë e tij në: "Sijeru ealamin-nubela" 21 / 443, 456; "El-Bidaje ven-nihaje" të Hafidh ibën Kethir 13 / 46 – 48; Edh-dhejl ala tabekatil-hanabile" të Hafidh Ibën Rexheb 2 / 5 - 34; "Husnul-muhadere" të Hafidh Es-Sujuti 1 / 354 dhe "Shudhuratu –dheheb" 4 / 345 – 346.

Ali Shabani,
21.1.2005

Ebul Fet'h Esh Shehristani

Imam Ebul Fet'h Esh Shehristani, (Muhammed ibën Kerim esh Shehristani) njeriu të cilin autorët e me plotë të drejtë e quajnë historian i feve dhe kronikan i mendimeve të ndryshme që i përkasin lëmisë së akides. Si duket ai është historiani i parë i cili shkroi libër e në të cilin në mënyrë shkencore paraqiti historitë e feve të ndryshme. U përcaktua që postulatet e ndryshme të feve dhe shkollave apologjetike t'i shfaqë me fjalët e tyre, të nxjerruara prej librave burimore të çdo feje apo shkolle. Këtë e bëri në librin e tij më të njohur El Milel ven Nihal.

Quket Ebul Fet'h Muhammed ibën Abdul Kerim ibën Ahmed i linduri në Shehristan në kufi të Horosanit, në vitin 458 H. Në qytetin e lindjes jetoi dhe vdiq.

Duke kërkuar dije vizitoi Havarizmin,

Nejsaburin, Mekken dhe Bagdadin në të cilin qëndroi tre vjet.

Atje mësoi në medresenë Nidhamijje ku prej mësuesit të tij Ahmed El Havafi mësoi fikhun.

Bazat e fesë i mësoi tek Ebul Kasim El Ensari, hadithin prej Ali Ebul Hasen El Medainij. Dallohej me mendjeprehtësi dhe aftësi për t'i kuptuar gjërat.

Gjatë jetës së tij i ka shkruar këto libra:

- El Milel Ven Nihal - e cila për herë të parë u botua në vitin 1834 në Londër dhe është libër pa të cilin nuk mundet të paramendohet një bibliotekë islame. Në këtë libër ai flet për historitë e feve të ndryshme dhe shpalos qëndrimet e shkollave apologjetike Islame. (libri është i përkthyer edhe në persisht, latinisht, anglisht dhe gjermanisht si dhe ka

përjetuar përkthime të pjesërishme në gjuhën turke. Vërejtje të veçantë kanë tërhequr edhe pesë hyrjet (mukaddime) e librit në të cilat autori shpalos metodologjinë që ndjekë në librin e tij. Vlerësimi i Shejhul islam Ibën Tejmijje për këtë libër është se: "ata që kanë patur qasje në veprat e dijetarëve, në ato që kanë të bëjnë me mezhebet, e dijnë se Shehristani në shumë vende në veprën e tij ka përcjellë (transmetuar) fjalë të dobëta. Por sërrish ky është libër më i plotë

nga shumica e veprave të përpiluara në këtë temë si dhe më i miri në transmetime sh.r.)

- Nihajetul Ikdam fi ilmil Kelam- në të cilin paraqet qëndrimet e dijetarëve të Ilmul Kelamit (apologjetikës) deri në shekullin e gjashtë hixhrij.

- Musara'atul Felasife (el-Musara'a vel Mudara'a- në të cilin shpalos gabimet e filozofëve.

Vdiq në vitin 548 H në qytetin e tij Shehristan.

Talha Kurtishi

Redaktoi: Ramadan Ramadani

28.1.2005

Imam Muhammed ibën el Munkedir

Njëri prej imamëve që jetoi dhe veproi në kohën e bekuar që i përket gjeneratës së dytë pas as'habëve gjegjësisht në kohën e tabi'inëve.

Bashkëkohorët e tij e përshkruanin me këto fjalë: Ishte thesar i sinqeritetit, rreth tij tuboheshin të mirët...zotriu ynë që ushqente dhe ndihmonte të varfërit, qante kur në praninë e tij lexoheshin hadithet e të Dërguarit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Quhet Muhammed ibën El Munkedir ibën Abdullah ibën El Hedir ibën Abdul Uzza. Rrjedh prej fisit më të dalluar arab El Kurejsh. Lindi në vitet e para të dekadës së katërt pas hixhretit.

All-llahu, subhanehu ve teala, e nderoi atë duke ia mundësuar të mëson para nxënësve të të Dërguarit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, përfitoi

prej Aishes, Ebu Hurejres, Ibën Umerit, Xhabirit, Ibën Abbasit, Ibën Zubejrit, Enesit, Ebu Umames, All-llahu qoftë i kënaqur me të.

Fjalët e dijetarëve për të:

Sufjani thotë: Askush si Muhammedi nuk është më meritore (që me siguri) të thotë: I Dërguari i All-llahu ka thënë.

Ibën Hibbani dhe Ebu Hatimi thonin: Është i besueshëm (thikka)

Ebu Hatimi shton: Ishte prej lexuesve të dalluar të Kur'anit nuk i përmbante lotët kur lexohej hadithi i të Dërguarit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

Malik: Ishte zotëriu i lexuesve të Kur'anit.

Ebul Mi'sher: Zotëriu ynë që ushqente të varfërit dhe ishte vazhdimisht në praninë e të diturve.

Ja'kub El Fesevi: Arriti kulminacionin në precizitet, kujtesë, zuhd. Ishte autoritet i pamohueshëm.

Ibën Maxheshun: Takimi me Ibën Munkedirin më bën dobi ne fé.

Dhehebi: Imami, Hafidhi, Shejhul Islam.

Ibën Haxher: Besniku me virtyte të larta.

Imam Munkediri la gjurmën e tij në histori. Nga ky kolos i dijës përfituan shumë bartës të dijës që me plotë të drejtë konsiderohen prijës të fesë Islame. Nga mesi i tyre do t'i veçojmë:

Amër ibën Dinarin, Zuhriun, Hisham ibën Urve, Ebu Hazim El A'rexh, Musa ibën Ukbe, Jahja ibën Se'id El Ensariun, Ibën Xhurejxin, Ma'merin, Malikun, Shu'ben, të dy Sufjanët (Eth Theuriu dhe Ibën Ujejne), Euzaiu, Ebu Hanifen dhe shumë tjerë.

Malik: Rrallëherë Ibën Munkediri pyetej për ndonjë hadith e të mos qajë.

Kur qante fshihte fytyrën e tij dhe thoshte zjarri nuk do të djeg vendet ku kanë prekur lotet.

Thoshte: Disa net vëllau im Omeri falej në kohë që unë u bëja masazh këmbëve të nënës. Nuk kisha dashur që t'i ndërrojmë këto netë (duke

shpresuar se shpërblimi i bamirësisë ndaj nënës është i madh sikur shpërblimi për namazin e natës).

Thoshte: Sa ndihmë e madhe është pasuria për të devotshmin.

I dërgoi dyzet dinarë Safvan ibën Sulejmit duke e liruar (nga obligimet e dynjasë) për adhurim.

Kur u pyet: çfarë don nga bukuria e kësaj bote tha: T'u ndihmoj vëllezërve.

Thoshte: Ai që flet duhet të frikësohet nga hidhërimi i All-llahut, kurse ai që dëgjon duhet të shpreson mëshirën e All-llahut, subhanehu ve teala.

Fekihu është ndërmjtësuesi mes All-llahut dhe robërve të Tij pra le të kujdeset ai që e bën këtë gjë.

Në shtratin e vdekjes u frikësua. I thanë pse po frikësohesh? Tha më kujtohet ajeti: "E prej All-llahut do t'u prezentohet (lloji i dënimit), çka as nuk kanë mundur ta mendojnë." (Zumer, 47) e unë nuk e di se çfarë do të më prezenton All-llahu, subhanehu ve teala.

Vdiq në vitin 130 H ose sipas një mendimi edhe më pas.

Burimet:

Hiljetul Evlija, Sijer A'lam Nubela dhe Tehdhibut Tehdhib

Talha Kurtishi,
4.2.2005

Pyetje dhe përgjigje

Nr.-442:

Pyetje: Ç'është dispozita e agjërimit të ditës së Ashurasë?

Përgjigje: Kur Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, erdhi në Medine, vëreu jehuditë se agjëronin ditën e dhjetë të muajit Muharrem, ashtu që tha: “Unë kam më shumë të drejtë në Musaun alejhi selam sesa ju, e agjëroi këtë ditë dhe i urdhëroi të tjerët të agjërojnë”.

Poashtu në hadithin që e transmeton Ibën Abbasi, radijall-llahu anhu, dhe që është i vërtetë padyshim qëndron se Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem, e ka agjëruar ditën e Ashurasë dhe i ka urdhëruar të tjerët të agjërojnë.

Kur u pyet për vlerën e agjërimit të kësaj dite, tha: “Shpresoj që All-llahu me të, të na e falë vitin e kaluar”.

Mirëpo, më vonë urdhëroi që të kundërshtohen jehuditë duke e agjëruar këtë ditë dhe duke i shtuar një ditë para saj d.m.th. dita e nëntë, ose një ditë pas saj d.m.th. dita e njëmbëdhjetë.

Pra, më së miri është që të agjërohet kjo ditë duke ia bashkangjitur edhe një ditë para apo pas saj.

Bashkangjittja e ditës së nëntë është më sevap sesa e ditës së njëmbëdhjetë.

Andaj, duhet o vëlla që ta agjërosh ditën e Ashurasë dhe ditën para saj.

Muhammed Salih El-Uthejmin

Marrë nga libri: Shtyllat e fesë (pyetje dhe përgjigje), NuN, 2005.

Xhemati i namazit të xhumasë

Shejh Albani, rahimehull-Allah, duke sqaruar dobësinë e hadithit me numër 1204 në vargun e haditheve të dobëta, i cili është me këtë tekst:

"Xhumaja është obligim për secilin fshat që ka imam, edhe nëse nuk janë më shumë se katër, madje Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, tha edhe nëse janë vetëm tre njerëz".

Për këtë hadith tha: është meudu (i trilluar).

Pastaj mes tjerash e shkroi edhe këtë:

Dobi shkencore:

Dijetarët kanë mendime të ndryshme mbi

numrin e xhematlive për të përmbushur kushtin që namazi i xhumasë të jetë valid. Numri i mendimeve arrin deri në pesëmbëdhjetë mendime.

Imam Sheukaniu, rahimehull-Allah, në librin e tij "Sejlul-Xherrar", 1/298) thotë: "Asnjë mendim nuk ka argument me të cilin e argumenton mendimin e vet, përveç atyreve që thonë: se numri i xhematlive për xhuma është i njëjtë sa duhet të jetë edhe për namazin me xhemat".

Shejh Albani thotë: Ky mendim është i saktë, inshaAll-llahu teala".

Marrë nga "Vargu i haditheve të dobëta dhe të trilluara dhe ndikimi i tyre i keq në ummet", v.3 f.348-349.

Përktheu: Bekir Halimi

Muhammed Nasirud-din Albani,

31.12.2004

19. Modestia

Transmeton Ijad ibën Himari se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Allahu më shpalli mua: Bëhuni modest, mos mburreni njëri ndaj tjetrit as mos i bëni padrejtësi njëri tjetrit".

Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "E të jeshë modest ndaj besimtarëve që të pranuan ty". Dhe: "O ju që besuat! Kush largohet nga feja e vet (i bën dëm vetes) s'ka dyshim se All-llahu do të sjellë një popull që Ai e do atë (popull) dhe ata e duan Atë (Zotin), (një popull) që është modest e i butë ndaj besimtarëve, por i ashpër dhe i fortë ndaj mohuesve".

Në këtë hadith nxitemi për të qenë modest dhe të largohemi nga mendjemadhësia. Çdo i mençur obligohet që të jetë modest dhe të largohet nga mendjemadhësia. Edhe sikur të mos ishte e vërtetë se me modesti ngritet njeriu prapsepër do të obligohej të stoliset me modesti.

Modestia është dy lloje: njëra është e lavdëruar kurse tjetra e qortuar. Modesti e lavdëruar është: të mos fyesh robërit e Allahut dhe të mos nënvlerësosh ata. Modestia e qortuar është: modestia ndaj të pasurve për të arritur diçka nga pasuria e tyre. I mençuri duhet që të largohet nga modestia e qortuar në të gjitha rrastet, dhe të shoqëroj modestinë e lavdëruar në të gjitha aspektet.

Njerëzit më të mirë janë ata që janë modest megjith famën e tyre, asketët që kanë pasuri, të drejtë edhe pse kanë fuqi. Njeriu nuk e len modestinë vetëm nëse mendjemadhësia është rrënjësore në të. Çdonjëri i cili shtirret mendjemadh ndaj njerëzve është i dashuruar në vetevete, kurse pëlqimi i vetëvetes është zili ndaj mendjes se vet, nuk kam parë asnjë që është sillë me mendjemadhësi ndaj më të dobtëve përveç se Allahu e ka nënçmuar te më të ngriturit.

Thotë K'abi, radijall-llahu anhu: Allahu, subhanehu ve teala, kur ia jep robit të Tij një dhunti në këtë botë e ai falenderon Atë dhe bëhet modest, Allahu i jep edhe dobinë e asaj dhuntie në këtë botë dhe ia ngritë gradët në botën tjetër, e nëse i jep ndonjë dhunti, e ai nuk falenderon Allahun e as që bëhet modest Allahu e privon nga dobia e asaj dhuntie në këtë botë kurse në botën tjetër nëse Allahu don e fut në një shtresë të Xhehennemit për ta dënuar, ose ia falë.

Ibrahim ibën Esh'ath e pyeti Fudajlin se ç'është modestia? Ai u përgjigj: Modesti është ti nënshtrohesh të vërtetës dhe ti përkulesh asaj edhe nëse e dëgjon prej fëmiut po edhe nëse e dëgjon të vërtetën nga njeriu më injorant përsëri duhet ta pranosh.

Abdullah ibën Mubareku ka thënë: Kulmi i modestisë është të ulësh veten në pozitë të varfanjakut e t'ia bësh më dije se nuk je më me vlerë se ai pse je më i pasur dhe të ngritish veten në pozitë të pasanikut dhe t'ia bësh me dije se nuk është më me vlerë se ti pse është më i pasur.

Është pyetur Abdulmeliku: Cili prej njerëzve është më i mirë? Ka thënë: Modesti edhe pse ka pozitë të lartë, asketi edhe pse ka pasuri, ai që nuk dëshiron të ngritet mbi të tjerët.

Ibën Semmaku hyri te Harun Rashidi dhe i tha: o prijës i besimtarëve, pasha Allahun, modestia yte megjith pozitën e lartë që ke është më e lartë se sa vet pozita. Haruni i tha: Shumë fjalë të bukur the! Ai përsëri tha: “O prijës i besimtarëve! Njeriu të cilit Allahu, subhanehu ve teala, i ka dhënë bukuri, famë, pasuri dhe ruan nderin, u ndihmon të varfërve dhe është modest regjistrohet në Librin e Allahut prej njerëzve të veçantë të Tij.” Harun Rashidi urdhëroi ti sjellin ngjyrë dhe fletë e pastaj i regjistroi këto fjalë me dorën e tij.

Ahmed Muadh Hakkij

Përktheu: Agim Bekiri

(pjesë nga libri: katërdhjet hadithe mbi moralin)